

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7379 E diel 10 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Kështu mund të thuhet pas turit diplomatik dyditor në Bruksel të kryeministrit Rama dhe kryediplomatit Bushati në fillim të kësaj jave. Presidenti ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE
Negociatat, topi ende në fushën tonë!



Dje në "Deutsche Welle"
Një dërrimi vjen në mes të konfliktit për reformën e drejtësisë. Vërtet që Szydio i mbijetoi një votë mosbesimi të partisë liberale opozitare Platforma Qytetare ..
Vijon në faqen 22

Nga PAUL FLÜCKIGE
A do ta nxjerrë Moraviecki Poloninë nga izolimi?



INTERVISTE/ Lazër Stani tregon detajet ndryshe të përmbysjes

Ish-themeluesi: U propozua që PD të jetë motër me PPSH, si ndërhyri Berisha

“Në dhjetor më pushuan nga puna, më shpallën të vrarë në kufi. Çfarë i thanë Meksit në sallë”

Nga VALENTINA MADANI

Lazër Stani është dëshmitar i atyre ditëve të jashtëzakonshme të dhjetor '90, kur ëndrra e lirisë kishte ngritur në këmbë një popull të fërë. Ish- themeluesi i PD-së tregon për “Gazeta Shqiptare” momentet më kyçe...

Në faqen 8-9

ALEKSANDER NDOKA U QELUA ME 11 PLUMBA PARA SHTEPISË, FORMULARI I DEKRIMINALIZIMIT

EKZEKUTOHET VELLAI I ISH-DEPUTETIT NDOKA, DYSHIMET

S’kishte precedentë penalë, trupi u gjet në makinën “Mitsubishi” pas 6 orësh. Policia “blindon” Lezhën. Në “sitë”, konfliktet e djalit të tij



(Në foto) Viktima Aleksander Ndoka. Faksimile e formularit të dekriminalizimit të Aleksander Ndokës



Në faqen 2-3

INTERVISTA
Imami: Vetëm në rast vdekjeje e dorëheqjeje zgjidhet kryeprokuror i përkohshëm
Në faqen 4

DEBATET PER ZGJEDHJEN
Manja: Kryeprokurori i përkohshëm do t'i nënshtrohet vetingut, vjen nga sistemi
Në faqen 5

NDERTIME PA KRITER
Legalizime duke shkelur ligjin, KLSH: Ndjekje penale për Sarandën e Tropojën
Në faqen 7

FILMI I RI
Arbana, Xhepa e Tinka Kurti, kolosët rikthehen në kinema nga Ed Topi
Në faqen 12

INTERVISTA NDRYSHE

Veli Ajola më thotë se jam martuar me Tiranën, por e kam dashuri
Në faqen 11

MILOSAO Luljeta Lleshanaku për “Milosao”: Më tërheqin historitë e mbijetesës

Ali Pasha përdorte kodet shifrore për mesazhet

Irakli Koçollari: Në Arkiv janë dhjetëfish dokumente që e vërtetojnë

Nga IRAKLI KOÇOLLARI
Njeriu, sigurisht, ka pasur nevojë të komunikojë me gojë apo me shkrim, gjerësisht, publikisht, por po aq sa edhe të komunikojë veçmas individualisht. Nevojat e kanë bërë njeriun të flasë me zë të lartë dhe në tribuna të



hapura apo përmes mjeteve të komunikimit masiv (media, shtypit të shkruar, autoporlantëve, megafonëve, ...) por rethanat, nevojat dhe interesat e kanë bërë njeriun të flasë edhe në mënyrë selektive, private, me zë të ulët apo vesh më vesh. Por...

Suplement

VRASJA NE LEZHE HETIMET

Trupi i pajetë u gjet në makinën "Mitsubishi" pas 6 orësh. Policia "blindon" Lezhën

Ekzekutohet në një atentat mafioz vëllai i ish-deputetit Arben Ndoka

Aleksandër Ndoka u qëllua me 11 plumba kallashnikovi, në afërsi të vilës së tij 3-katëshe nga 2 persona

LEZHË

Tronditet Lezha! Vëllai i ish-deputetit të Partisë Socialiste, Arben Ndoka u ekzekutua mbrëmjen e së premtes, në afërsi të banesës së tij. Aleksandër Ndoka, anëtar i këshillit bashkiak të këtij qyteti, u qëllua për vdekje me breshëri kallashnikovi në një distancë jo më shumë se 2-5 metra. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Lezhës dhe bënë me dije se ngjarja e rëndë ku humbi jetën babai i katër fëmijëve ndodhi rreth orës 22:30 në lagjen "Nënë Tereza", ose e njohur ndryshe "Kodër Marlekaj". Mësohet se trupi i pajetë i 48-vjeçarit u gjet në automjetin e tij tip "Mitsubishi" me targë "AA 382 SE", rreth orës 04:25, pra 6 orë pas vrasjes në atentat. Ndërkaq, forca të shumta policore kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë nisur hetimin. Në ndihmë të bluve kanë shkuar edhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë të Shkodër. Policia dhe Prokuroria e Lezhës janë duke punuar intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore, blutë kanë shoqëruar dhe marrë në pyetje 8 persona. Sipas burimeve të mësipërme, 48-vjeçarit nuk ka pasur asnjë precedent penalë.

ATENTATI

Rreth orës 22:30, Aleksandër Ndoka ishte duke u kthyer nga lokali i tij "Apo-klipsi" me makinën tip "Mitsubishi" për në banesë. Në momentin që ai po priste të hapte porta për të parkuar automjetin, aty ku e linte gjithmonë dhe më pas t'i bashkoi familjes së tij, është vrarë në pritë. Sipas policisë, pikërisht në atë moment në lagjen "Nënë Tereza" nuk kishte drita. Ndërkaq, dy persona ende të paidentifikuar, të pajisur me armatim të rëndë tip kallashnikov qëlluan 14 herë në



Viktima
Aleksandër Ndoka

EMËRIMI

Aleksandër Ndoka edhe pse nuk e kishte marrë zyrtarisht emërimin, prej 2 muajsh e gjysmë ishte emëruar kryetar i IKMT në Shkodër. Fakti që paraqitet në punë gjatë kësaj kohe tregon që ai nuk ka pasur asnjë problem. Familjarët shprehin habinë për vrasjen, pasi ai nuk ka pasur precedentë kriminalë dhe i vetmi shqetësim ishte i biri. Familjarët mohojnë kategorikisht përfshirjen në ndonjë ngjarje.

drejtimit të tij, duke e lënë të vdekur në vend. Sipas bluve, por edhe skemës së prokurorisë të ndërtuar në vendin e ngjarjes, atentatorët kanë qenë të fshehur në disa banesa të rrënuara në pronësi të fqinj të Aleksandër Ndokës. Ata si duket kanë pasur dijeni se kur do të kthehej në shtëpi vëllai i ish-deputetit socialist dhe e kanë prituri deri në momentin kur është afruar në derën e vilës së tij 3-katëshe. Në momentin që dera vonohej të hapje, sepse ishte me pult, autorët

PRITA E ATENTATORËVE

Sipas bluve, por edhe skemës së prokurorisë të ndërtuar në vendin e ngjarjes, atentatorët kanë qenë të fshehur në disa banesa të rrënuara në pronësi të fqinj të Aleksandër Ndokës. Ata si duket kanë pasur dijeni se kur do të kthehej në shtëpi vëllai i ish-deputetit socialist dhe e kanë prituri deri në momentin kur ai është afruar në derën e vilës së tij 3-katëshe. Në momentin që dera vonohej të hapje, sepse ishte me pult, autorët kanë dalë nga ai rrethim dhe në një distancë të afërt kanë qëlluar për vdekje 48-vjeçarin.

disa minuta, autorët kanë dalë nga ky rrethim dhe në një distancë të afërt kanë filluar të qëllojnë në drejtim të automjetit dhe më pas janë afruar në vendin e parë të automjetit duke e qëlluar për vdekje babain e 4 fëmijëve.

POLICIA

Trupi i pajetë i 48-vjeçarit është pikasur vetëm në orën 4:25 nga forcat e policisë. Ka qenë një patrullë e policisë së Lezhës, duke qarkulluar në zonë. Policët kanë parë makinën me sinjal ndezur. Kanë dyshuar se ka qenë ndonjë

11

PLUMBA

Burime të sigurta nga policia e Lezhës dhe bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se Aleksandër Ndoka (baba i 4 fëmijëve) u qëllua për vdekje me 11 plumba kallashnikovi, çka tregon se shpëtimi për 48-vjeçarin ka qenë i pamundur. Mësohet se në vendin e ngjarjes janë gjetur 14 gëzhoja automatiku. Pas ngjarjes, policia dhe FNSH kanë "blinduar" Lezhën, ndërsa po vijojnë punën për identifikimin e kapjen e autorëve.

hajdut, ndaj dhe kanë marrë targën ku pas verifikimit ka rezultuar se i përkiste të ndjerit Aleksandër Ndoka. Menjëherë blutë kanë krehur të gjithë zonën për të bërë të mundur gjetjen dhe sekuestrimin e provave të tjera materiale. Gjithashtu, janë sekuestruar dhe pamjet filmike të kamerave të sigurisë, të vendosura nga objektet dhe biznese private. "Një grup i posaçëm hetimor me specializim të Hetimit të Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë dhe me Prokurorinë e Rrethit është duke punuar për këtë qëllim. Nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë të mbështetura edhe nga shërbimet FLO Shkodër, është krehur e gjithë zona për të bërë të mundur gjetjen dhe sekuestrimin e provave të tjera materiale, si dhe po administrohen të gjitha pamjet filmike të kamerave të sigurisë, të vendosura nga objektet dhe biznese private. Policia po analizon dhe përpunon me kujdes të gjitha provat materiale të administruara në vendngjarje si dhe në ambiente të tjera që



Banesa e familjes Ndoka

8

TË SHOQËRUAR

Vrasja në atentat e vëllait të ish-deputetit socialist ka alarmuar policinë, e cila pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore ka shoqëruar dhe marrë në pyetje 8 persona. Sipas policisë, ish-anëtari i Këshillit Bashkiak të Lezhës, pronar i një lokali dhe biznes duralumin, nuk ka qenë person me precedentë penalë.



Deputeti i PS-së,
Pjerin Ndreu

Vrasja e Aleksandër Ndokës, reagon deputeti Ndreu: U prehsh në paqe miku im!

TIRANË - Deputeti i Partisë Socialiste për qarkun e Lezhës, Pjerin Ndreu ka reaguar në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në këtë qytet, ku mbeti i vrarë me 11 plumba Aleksandër Ndoka, vëllai i ish-ligjvënësit Arben Ndoka. Në një mesazh në faqen e tij të "Facebook"-ut, Ndreu u shpreh ngushëllime familjarëve për humbjen. "Për Sandër Ndokën, për vdekjen e tij të parakohshme! Ngushëllime familjes! U prehsh në paqe miku im!", citohej në mesazhin e deputetit Pjerin Ndreu. Ndërkaq, kjo ngjarje ka tronditur banorët e Lezhës dhe jo vetëm. Forca të shumta policore, por edhe Prokuroria e Lezhës janë duke hetuar për identifikimin e arrestimin e atentatorëve, që i morën jetën babait të katër fëmijëve.

lidhen me të, nëpërmjet laboratorit shkencor dhe të gjitha potencialeve policore. Në vijim të veprimeve për zbulimin dhe dokumentimin e autorëve, deri tani janë shoqëruar 8 shtetas në D.V.P. Lezhë. Materialet i kaluan për ndjekje të mëtejshme

Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprat penale të parashikura nga nenet 78/278 të Kodit Penal "Vrasje me paramendim dhe mbajtje e armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Lezhës.



TIRANË - Vëllai i ish-deputetit të Partisë Socialiste, Arben Ndoka, që u ekzekutua mbrëmjen e së premtes në një atentat mafioz në Lezhë, nuk ka qenë asnjëherë i dënuar apo nën hetim. Megjithëse Aleksandër Noka ishte një emër i njohur, në formularin e dekriminalizimit të plotësuar si këshilltar bashkiak, ai rezultoi i padënuar dhe pa precedentë penalë. "Gazeta Shqiptare" ka siguruar formularin e plotësuar nga viktimia vitin e kaluar në kuadër të ligjit të dekriminalizimit. 48-vjeçari Ndoka, baba i katër fëmijëve (dy djem dhe dy vajza) ishte person i njohur në Lezhë. Ai kishte punuar në institucione të ndryshme lokale në këtë qytet. Aleksandër Ndoka kishte punuar më parë në Hipotekë. Më pas, (në vitin 2015), ai u zgjodh në 2015-ën anëtar i Këshillit Bashkiak të Lezhës. Ndërkaq, vëllai i viktimës, Arben Ndoka ishte deputet i PS-së, por nuk arriti të mbaronte mandatin për shkak të ligjit të kriminalizimit dhe nuk dihet nëse do merret dosja e tij nga autoritetet.

48-vjeçari Aleksandër Ndoka, pa precedentë penalë

Zbulohet formulari i dekriminalizimit i vëllait të ish-deputetit të PS-së së Lezhës

FORMULARI VETËDEKLARIM
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 130/2014 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZËJHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"
DATE: 04/04/2016

I. IDENTIFIKIM PERSONAL

A. Gërmëdhënia aktuale

EMËR	ALEKSANDËR
MOSHA	NDOKA
ATËSI	NDOKA
AMËSI	DILE
DATELINDJE	20 08 1969
VENDLINDJE	SHKODËR
VENDORINDJE	LEZHË
NR. ID	GD0000476

B. Gërmëdhënia në mbledhje

EMËR	
MOSHA	
ATËSI	
AMËSI	

Faksimile e formularit të dekriminalizimit të Aleksandër Ndokës

Në "sitë", konfliktet e djalit të Aleksandër Ndokës. Hetime edhe në pista të tjera për shkak të detyrës

Ngjarja në qytetin e Lezhës, autorët vrasës me pagesë

Sekuestrohet celulari i viktimës, policia: Dyshime për hakmarrje

LEZHË

Vrasja në atentat e këshilltarit bashkiak të Lezhës, Aleksandër Ndoka ka ngritur në këmbë policinë, e cila së bashku me prokurorinë po hetojnë në disa pista për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Mësohet se hetimet për ekzekutimin e vëllait të ish-deputetit socialist, Arben Ndoka po drejtohen nga shefi i Krimeve të Rënda në Policinë e Shtetit, Niko Brahimaj. Burime pranë grupit hetimor dje bënë me dije për "GSH" se bëhet fjalë për një krim të organizuar dhe dyshimet e para flasin për vrasës me pagesë, sepse kanë vepruar në mënyrë brutale dhe duke survejuar të gjitha lëvizjet e viktimës. Po të njëjtat burime pohuan se është sekuestruar celulari i viktimës për të parë thirrjet e fundit, ndërsa i është kërkuar ndihmë kompanisë celulare për zbrërtimin e listës së telefonatave të bëra 24 orët e fundit. Zbardhja e listës telefonike do të shërbejë për të zbuluar se kush e ka telefonuar Aleksandër Ndokën, nëse bëhet fjalë për një pritë dhe se cilët ishin këta persona. Nisur nga mënyra se si është kryer ekzekutimi, dyshohet që pista kryesore të jetë



48-vjeçari i vrasë, Aleksandër Ndoka



Djali i viktimës, Samuel Ndoka, i arrestuar nga policia

BERISHA
Për vëllain e deputetit Arben Ndoka, që u vra mbrëmjen e së premtes në një atentat mafioz pranë shtëpisë së tij, ka shkuar rreth një muaj më parë edhe ish-kryeministri Sali Berisha. Në një postim të datës 1 nëntor në faqen e tij në "Facebook", Berisha publikonte mesazhin e "qytetarit dixhital", i cili ndër të tjera denonconte edhe Aleksandër Ndokën, si kreun e INKU Shkodër (IKMT). Sipas këtij mesazhi, vëllai i ish-deputetit vendoste gjoba ndaj atyre që ndërtonin apo bënin ndonjë shtësi. I përfshirë në këtë aktivitet thotë oficeri i policisë Shkodër, ka qenë edhe shefi i komisariatit të këtij qyteti.

hakmarrja. Policia nuk ka dhënë detaje për vrasjen. Për shkak të ruajtjes së sekretit, grupi hetimor është shumë i rezervuar.
HETIMI
Paraprakisht, policia dy-

më parë në Hipotekë dhe së fundmi ishte emëruar kryetar i IKMT në Shkodër. Gjithsesi, zbardhja e kësaj ngjarjeje paraqet vështirësi, pasi ka shumë pak dëshmitarë dhe lagja ku ndodhi krimi e ku banonte viktimia ishte pa drita. Mësohet se familjarët e viktimës, bashkëshortja dhe fëmijët nuk kanë dëgjuar asnjë zhumë. Sipas policisë, ka gjasë që armët me të cilët u qëllua për vdekje 48-vjeçari të kenë qenë me silenciator. Ndërkaq, Aleksandër Ndoka ka qenë person pa asnjë precedent penalë (ai është akuzuar vetëm nga opozita). Prokuroria e Lezhës po verifikon të kaluarën e Aleksandër Ndokës dhe familjarëve të tij. I vetmi konflikt i tij i hapur ishte përfshirja e djalit, Samuel Ndoka në një incident para zgjedhjeve të qershorit të këtij viti në Shëngjin. Për këtë, Samuel Ndoka është arrestuar dhe po hetohet. Për momentin janë marrë dëshmitë e punonjësve të policisë, të cilët e kanë gjetur të pajetë viktimën. Pas ceremonisë mortore, prokuroria do të pyesë edhe familjarët e viktimës, të cilët konfirmuan se Aleksandri nuk ka shprehur asnjë shqetësim dhe shpesh kthehej vonë në shtëpi, pasi rrinte me sho-

qërinë në Lezhë, por edhe për shkak të punës në Shkodër.
ARRESTIMI I DJALIT TË VIKTIMËS
Aleksandër Ndoka rezultoi pa precedentë penalë, por konfliktet në familje i ka pasur djali i tij, Samuel Ndoka, i cili u përfshi në një sherr, që përfundoi në kanosje me armë zjarri ndaj një aktivisti të LSI në zgjedhjet e 25 qershorit në qarkun e Lezhës. Samuel Ndoka, 19 vjeç akuzohet se së bashku me kushëririn e parë, Danjan Ndoka dhe disa persona të tjerë, nën kërcënimin e armës kanë kanosur dhe dhunuar ditën e zgjedhjeve të 25 qershorit, aktivistin e LSI-së, Florjan Dushku. Samuel Ndoka u arrestua më datë 28 tetor të këtij viti, ndërsa u pranngosën edhe dy bashkëpunëtorë të tij. Por, ky nuk është konflikti i parë i Samuel Ndokës, që u arrestua në Tiranë me një pistoletë me 7 fishe, pasi është një emër i njohur për policinë. Samuel Ndoka së bashku me Klajdi Ndokën dhunuan edhe nënkryetarin e qarkut të Lezhës, Agustin Marku duke e goditur disa herë me grushtë dhe shqelma në një lokal në 20.02.2017. Nga ana e policisë së Lezhës po hetohet edhe kjo pistë për zbardhjen e vrasjes së 48-vjeçarit Ndoka.

KRYEPROKURORI REAGIMET

Ambasadori i SHBA-ve, mesazh për shqiptarët në ditën kundër korrupsionit

Lu: Në një shoqëri, korrupsioni përfundon kur njerëzit veprojnë

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu dha dje një mesazh për të gjithë shoqërinë shqiptare në ditën kundër korrupsionit. "Në një shoqëri, korrupsioni përfundon kur njerëzit e saj më në fund fillojnë të veprojnë", deklaroi dje ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu. Në ditën Ndërkombëtare kundër Korrupsionit, ambasadori amerikan, Lu përcolli këtë mesazh në një postim në faqen e ambasadës së SHBA-ve në "Facebook", ndërsa theksoi se, "shpesh kjo udhëhiqet nga të rinjtë". "Në një shoqëri, korrupsioni përfundon kur njerëzit e saj më në fund vendosin që kanë duruar boll dhe fillojnë të veprojnë. Shpesh kjo



udhëhiqet nga të rinjtë", shkroi ambasadori Lu, në rrjetin social "Facebook". Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Korrupsionit, e cila ishte dje, ambasada e SHBA në vendin tonë

ka shpërndarë një njoftim të rëndësishëm për qytetarët shqiptarë. Në profilin e saj në "Facebook", ambasada e SHBA ka shpallur fituesit për Shqipërinë të konkursit rajonal vjetor "Rinia për një

PETRI VASILI
"Ambasadori Lu ka të drejtë. Ndaj korrupsionit shkatërrues, që thanë palma dhe blen pisha, që gllabëron qindra miliona euro me koncesione, që asgjëson miliona euro të tjera duke shkullur e ngulur pllakat e rrugës e lyer fasada ka vetëm një rrugë: e keqja duhet ndalur sot, nesër është vonë. Të gjithë në këmbë kundër kryeministrit narkohajdut!", u shpreh dje Vasili.

shoqëri pa korrupsion". Duke publikuar emrat e fituesve, SHBA u uron atyre suksese në konkurrimin me fqinjët e tyre në Ballkan për çmimin e madh.



Gjatë një seance parlamentare

Një nga hartuesit e Kushtetutës: KLP nuk mblidhet për një anëtar

Imami: Kryeprokuror i përkohshëm, vetëm në rast vdekjeje ose dorëheqjeje

"PD ka të drejtë që nuk ulet në tryezë me PS"

Arben Imami, një nga hartuesit e Kushtetutës në vitin 1998, ka komentuar situatën politike në vend, ku kryefjala e debatit është zgjedhja e kryeprokurorit të ri. I ftuar në emisionin "Kjo javë" në "News 24", Imami theksoi se prokurori i ri mund të jetë i përkohshëm vetëm në rastet e fatkeqësive, ku ndërrohet, apo edhe kur jep dorëheqje. Mes të tjerash, ai theksoi se nuk mund të ketë dialog mes PD-së dhe mazhorancës lidhur me këtë fakt, pasi shkelet hapur Kushtetuta, ndonëse për këtë proces janë pro ambasadorët Lu dhe Vlahutin. "Unë do them një gjë, në fakt po e them për herë të parë. Po them qartazi se Kushtetuta nuk ka pushtarur së vepruarit sot. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka pushtarur së ekzistuar në momentin kur ky vend është qeverisur në një vit nga një qeveri e paligjshme, si ajo e Fatos Nanos, që qeveriste me zv.ministra. Që këtu parimet kanë funksionuar së pushuari dhe kanë lëvizur sipas parimeve politike. Më këtë ezaurova mbështetjen që ka dhënë Vlahutin dhe



Ish-ministri i Mbrojtjes, Arben Imami

Lu. Zgjedhjet e një prokurori të përkohshëm do kishim vetëm në raste vdekjeje apo dorëheqjeje. KLP-ja nuk mblidhet vetëm për një anëtar. Zgjidhja në këto momente është e pa-nevojshme dhe e paarsyeshme. E kanë demonstruar dhe provuar me arsyetim të mirë zoti Xhafa dhe Sollaku. Jam i së njëjtës mendje. Në këtë pikëpamje, PD ka të drejtë që nuk pranon të ulet në këtë tryezë. Nuk mund të ketë dialog për të shkelur Kushtetutën, edhe pse flasim ambasadorët Lu e Vlahutin", tha Imami.

LËVIZJA E DHJETORIT
Ish-ministri i Mbrojtjes, Arben Imami, ka folur në këtë intervistë edhe për 8 dhjetorin e vitit 1990, duke treguar se si ndihet në ditët e shtesë kur kujton lëvizjen studentore. Imami tha se është një hark kohor dhe një sërë ngjarjesh, që kanë paraprirë pluripartitizmin në Shqipëri. Arben Imami, pedagog në atë kohë, tha mbrëmë se lëvizja studentore e 8 dhjetorit është padyshim një ngjarje unike. "Është një nga ngjarjet më të rëndësishme për Shqipërinë. Nuk kam pasur as pikëpëetje, as tensione dhe as pre-

SPARTAK NGJELA
Avokati i njohur, Spartak Ngjela u shpreh dje se presioni i ambasadorëve Donald Lu e Romana Vlahutin kundër korrupsionit shqiptar duhet të jetë edhe më i madh. "Lu dhe Vlahutin duhet të jenë në lartësinë e presionit, më shumë ndaj Ramës se ndaj Saliut, se Saliu nuk ka gjë në dorë", tha Ngjela.

sione për t'iu bashkuar studentëve. Nuk e kam menduar gjatë, por u përfshiva, pasi nuk mund të mos e shprehja atë që mendoja në atë kohë", tregoi Imami. Ai ka rrëfyer edhe takimin me Ramiz Alinë, ndërsa tregon se pika kyçe ka qenë paradija e 11 dhjetorit. "Nga Universiteti i Arteve u zgjodh Blendi Gonxhe dhe unë për të marrë pjesë në takim. Fillimisht u bë një takim 3-4 orë, ku u diskutua se për çfarë do të flisnim në takimin me presidentin e kohës. Më pas i gjithë diskutimi ka qenë se çfarë partie do të bëjmë", rrëfën Imami.

Krimi

ENKELEJD ALIBEAJ

Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, u shpreh dje për mediat se kjo qeveri nuk jep garanci për të luftuar krimin, ndaj duhet që të krijohet një qeveri antimagjia. "2.5 tonë kanabis të dala nga porti i Durrësit ishin të përfshirë 3 policë, dy të Durrësit dhe 1 i Fierit. PD e ka denoncuar prej 4 vitesh kriminalizimin e policisë. Kjo qeveri nuk jep asnjë garanci se krimi të mund të luftohet", tha Alibeaj.

PËRURIMI

Gjonaj: Burgu i ri i Reçit, edhe për "peshqit e mëdhenj"

Burgu i ri i Reçit do të hapet në janar dhe ky institucion i vuajtjes së dënimit të sigurisë së lartë pritet të presë edhe "peshqit e mëdhenj" të reformës në drejtësi, nëse gjykata do të vendosë dënimin e tyre dhe sjelljen në këto mjedise. Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, e pranishme në përirimin e mjediseve të këtij burgu u shpreh se aty do të vuanë dënimin 760 të burgosur. "Ky burg do të jetë si të gjitha burgjet e tjera. Për sa kohë që do të ketë një seksion të sigurisë së lartë dhe një tjetër të sigurisë së zakonshme. Gjykata do të vendosë nëse do ta sjellë në Shkodër në seksion të sigurisë së lartë, apo në seksion të sigurisë së zakonshme", tha ministria. Ky burg do të shërbejë në të njëjtën kohë për të shfryrë institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit, që janë të mbipoplluara me të burgosur. Ndërsa në të do të vendosen edhe të ekstraduarit e dënuar për vepra të rënda. Gjonaj u kujdes të saktësojë se lidhur me kriteret e punësimit të administratës, ato do të jenë rigorozë dhe që nuk kanë të bëjnë aspak me të shkuarën, kur flitej për ndërhyrje politike.



Mazhoranca u bën thirrje prokurorëve të kandidojnë, PD e cilëson "paradoks"

Manja: Kryeprokurori i përkohshëm do t'i nënshtrohet vetingut, vjen nga sistemi

Bylykbashi: Vetingu na doli 'rrjetë për peshq të vegjël'

Darina Tanushi

Lista me kandidatët për postin e Prokurorit të Përkohshëm, që do të zëvendësojë Adriatik Lallën do të bëhet zyrtare të martën, ndërsa menjëherë do të caktohet edhe data e dëgjësës së tyre në Kuvend.

Kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, u shpreh dje për mediat pas aktivitetit "Toga e artë" se shpreson të ketë shumë kandidatë për këtë post. "Nuk e di nëse deri tani janë paraqitur kandidatët, por shpresoj që të ketë shumë. Kandidatët që plotësojnë kriteret të paraqesin interesin e tyre për kryeprokuror të përkohshëm deri më datë 12 dhjetor. Afati për paraqitjen e dokumenteve dhe interesit është i mjaftueshëm", është shprehur Manja. Sipas këtij të fundit, vetingu nuk përbën problem, pasi ai që do të zgjidhet, do t'u nënshtrohet të gjitha proceseve të tjera. Kështu, Manja sqaroi se edhe kryeprokurori që do të zgjidhet do t'i nënshtrohet procesit si gjithë të tjerët. "Do t'u bëj një thirrje të gjithë profesionistëve të sistemit, pra prokurorëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj të bëhen pjesë e kësaj gare. Afati skadon më 12 dhjetor në orën 18:00. Ne do të bëjmë publike listën e kandidatëve për këtë detyrë dhe menjëherë do të caktojmë datën dhe orën e seancës dëgjimore për të gjithë kandidatët. Komisioni ka dy ditë të tjera kohë për të bërë vlerësimin e kriterëve për secilin kandidat. Sigurisht, edhe kryeprokurori i përkohshëm do t'i nënshtrohet me përparësi vetingut, njësoj si kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë", theksoi Manja. Ai deklaroi se Prokurori i Përkohshëm i përkohshëm do të jetë ushtruesi i detyrës deri në krijimin e KLP-së, si organi i ngarkuar nga Kushtetuta për të bërë zgjedhjen e prokurorit të ri. "Pra, do jetë prokuror i sistemit. Pastaj duhet të ketë 15 vjetë eksperiencë si prokuror; të ketë kryer Shkollën e Magjistraturës, ose të ketë gradë shkencore në Drejtësi", ka thënë Manja. Ai ka saktësuar se dy kriteret e fundit kandidatit nuk duhet t'i ketë



Kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja



Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi

të dyja njëkohësisht. "Duhet të ketë 15 vjetë punë dhe shkollën, ose 15 vjetë punë dhe gradën. Sistemi ynë ka të tillë prokurorë dhe unë jam besimplotë se do të kemi", tha Manja.

OPOZITA

Nga ana e tij, deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi në një postim në "FB" u shpreh për atë që ai e quajti paradokset e Ramës me reformën në drejtësi. "Ligji para?shikon që Prokurori i

Përgjithshëm në detyrë e humbet vendin e punës nëse nuk kalon vetingun. Por ama, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm mund të filloka punë pa bërë veting (sipas Ramës dhe korit që i vjen pas)", u shpreh Bylykbashi. "Prokurori i Përgjithshëm i Përhershëm duhet të zgjidhet pasi kalon vetingun dhe, edhe pse është më i sigurt nga ana e integritetit, duhet zgjedhur me 84 vota (shumicë e cilësuar 3/5

që të mos e kapë kryeministri. Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm, i cili sipas Ramës zgjidhet pa bërë veting, pra nuk ka garanci për integritetin e tij, mund t'u zgjidhka me vetëm 36 votat e kryeministrit (shumicë e thjeshtë). Pra, e kap dhe fut në xhep kryeministri", tha Bylykbashi. "Pasi ua lodhën kokën më shumë se dy vjet me këtë vetingun, na doli që vetingu genka 'rrjetë për peshq të vegjël'", tha ai.

DEPUTETI I PD

"Pasi ua lodhën kokën më shumë se dy vjet me këtë vetingun, na doli që vetingu genka 'rrjetë për peshq të vegjël'. Për të mëdhenjtë nuk bëka. Paradokset e sharlatanizmit!", deklaroi dje deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, duke ironizuar qëndrimin e Partisë Socialiste.



Taulant Balla

Kreu i grupit të PS-së: Ish-kryeministri mori rryshfet

Balla: Skandali i "Rapiscan", prokuroria të hetojë Berishën

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla u shpreh dje se skandali i korrupsionit të kompanisë "Rapiscan", ku përfshihet ish-kryeministri Sali Berisha bën me turp edhe Shqipërinë. Përmes një statusi në "Facebook", Balla ka cituar agjencinë e lajmeve "Bloomberg", që sipas tij ka zbardhur skemën e rryshfetit dhe përgjegjësinë bie mbi ish-kryetarin e PD. "Investigimi i 'Bloomberg' ka zbardhur skemën e rryshfetit. "OSI Systems/Rapiscan", me qendër në Kaliforni ka marrë nga Sali Berisha një kontratë prej 250 milionë dollarësh dhe vetëm disa muaj më pas ka shitur 49% të aksioneve tek një kompani shqiptare fantazmë. Vlera e aksioneve prej 122.5 milionë dollarësh u shit tek kompania e lidhur me Sali Berishën për vetëm 4 dollarë", ka thënë Balla. Sipas tij, provat janë mbi tryezën e prokurorisë prej vitit 2013 dhe ka shtuar se pret që prokuroria të fillojë të bëjë detyrën e saj. "Sipas punonjëseve të 'OSI Systems' të cituar, gjysma e 250 milionë dollarëve të kontratës së lidhur midis shtetit shqiptar dhe kompanisë amerikane, iu kalua në formë rryshfeti ish-kryeministrit të Shqipërisë deri në vitin 2013. Sali Berisha dhe të afërmet të tij. Provat janë mbi tryezën e Prokurorisë prej vitit 2013. Tashmë, ato po bëjnë edhe xhiron e botës, duke dëmtuar rëndë imazhin ndërkombëtar të vendit. Pas këtij denoncimi të ardhur nga SHBA, presim që prokuroria të fillojë të bëjë detyrën e saj", tha Balla.

Vishaj: Lallës i mbaroi mandati, çdo veprim i tij i paligjshëm

Vasilika Hysi: Zbatimi i reformës në drejtësi varet edhe nga avokatët

Avokatët janë shprehur edhe se zbatimi i reformës në drejtësi do t'i rikthejë dinjitetin avokatisë. Në një aktivitet të Avokatëve të Shqipërisë, në të cilin mori pjesë edhe nënkryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi, kreu i shoqatës së avokatëve penalistë, Ardian Visha komentoi edhe situatën e kryeprokurorit duke theksuar se Llalla duhet të largohet, pasi mandati i ka përfunduar. "Ka gjyqtarë të Gjykatës së Lartë e rrethëve, apo prokurori i përgjithshëm me mandati të mbaruar dhe rrinë në detyrë. Çdo veprim i tyre është i paligjshëm me mandati të mbaruar", deklaroi ai. Ndërsa nënkryetarja e Kuvendit, Hysi shtoi se zbatimi i reformës varet shumë edhe nga puna e avokatëve. "Nga ky takim, unë, jo vetëm si ligjberëse, por edhe si kolege dhe mike



Nënkryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi

me shumë prej jush, ju inkurajoj për një angazhim maksimal në detyrën tuaj në mbrojtje të të drejtave të njeriut në sistemin e drejtësisë penale, por edhe në reformimin e këtij sistemi dhe mes tij edhe të vetë shërimit të avokatisë", u shpreh Hysi. Ajo u bëri thirrje avokatëve të reflektojnë se çfarë duhet të bëjnë më mirë për të mbrojtur të drejtat e palëve në kontakt me

drejtësinë, por edhe për të luftuar korrupsionin në radhët e avokatëve dhe në sistemin e drejtësisë. "Të gjithë biem dakord që një sistem drejtësie i mirëorganizuar, i pastër nga korrupsioni dhe paafësia është garanci për një funksionim më të mirë të shtetit të së drejtës dhe luftimit të korrupsionit në të gjitha nivelet e shoqërisë, përfshirë edhe politiken", u shpreh Hysi.

Ish-kryeministri takon sekretarin e jashtëm të EPP

Berisha: Rama kërkon të emërojë narko-prokurorin e këtij shteti



Ish-kryeministri Sali Berisha, dje në një takim sekretarin për marrëdhëniet me jashtë të EPP, Patrick Voller

Ish-kryeministri Sali Berisha priti dje në një takim sekretarin për marrëdhëniet me jashtë të EPP, Patrick Voller; drejtorin për Ballkanin Perëndimor dhe Europën Juglindore të fondacionit "Konrad Adenauer", Florian Fyerebaran dhe zotin Valter Gloss, përfaqësues për Shqipërinë i këtij fondacioni. Në një postim në rrjetin social "Facebook", Berisha tha se u shprehu atyre "kënaqësinë që ata kanë pranuar ftesën e Forumit Rinor të PD-së për të përshëndetur dhe për t'u bërë pjesë e aktivitetit të organizuar me rastin e 8 dhjetorit, Ditës së Rinisë, ditës kur studentët liberatorë, në një përballje epike me

ÇËSHËTJA "TAHIRI"

Ish-kryeministri denoncoi dje faktin se ka pasur një takim misterioz 4-orësh mes Saimir Tahirit dhe kreut të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Këtë Berisha e ka mësuar prej qytetarëve që i kanë shkruar në rrjetin social, që sipas tyre biseda është përqendruar në problemet e përgjimeve.

"Konrad Adenauer!", tha Berisha. "Me zotin Voller diskutuam gjerësisht mbi situatën në vend. Theksova se një nga problemet më madhore në vendin tonë është kryeministri dhe qeveria e kriminalizuar, që ka ndër-tuar një narko-shtet. Ndërsa tani po kërkon të emërojë me narko-deputetët e tij edhe narko-prokurorin e këtij shteti. Theksova se përballë një qeverie të kapur nga droga, krimi dhe korrupsioni është e nevojshme

diktaturën staliniste, hapën dyert e lirisë për shqiptarët". "Gjithashtu, i shpreha zotit Voller falënderimet për EPP, grupin e saj parlamentar në Parlamentin Europian, presidentin Josef Daul për mbështetjen e madhe që i japin Partisë Demokratike dhe vendit tonë në tërësi, si dhe grupit parlamentar të Bundestagut dhe fondacionit

ndihma dhe mbështetja e EPP, partive simotra, CDU-së dhe fondacionit "Konrad Adenauer". Një shtet i kapur nga droga dhe krimi është kërcënim për gjithë Europën", u shpreh Berisha. Sipas tij, në takim u diskutua mbi domosdoshmërinë dhe për përpjekjet e Partisë Demokratike për kapërcimin e problemeve pasqjehore dhe qëndrimin e saj si shpresë e një opozite të fortë kundër regjimit të narko-shtetit në Shqipëri.

Plani i turizmit për Shkodrën, Klosi: Në 2031 do vijnë 600 mijë vizitorë

Bushati në Pukë: Do ndërtojmë një administratë pa dallime politike

Spiropali: T'i japim fund sistemit që nëpërkëmb qytetarët

Darina Tanushi

Qeveria mbledhi dje Këshillin Kombëtar të Territorit në Shkodër, ku u prezantua plani i turizmit për Alpet shqiptare dhe paketa e projekteve për Shkodrën turistike. Në fjalën e saj gjatë mbledhjes, zv.kryeministrja Senida Mesi tha se përmes nismave të tilla synohet ndërtimi i një pasaporte me investimet që po bëhen dhe ato që mbeten plane, duke dhënë një pasqyrë të projekteve të planifikuara dhe atyre në zhvillim. Duke saktësuar se është një fond prej 75 milionë eurosh, i akorduar nga qeveria shqiptare, por edhe investitorët e huaj për realizimin e këtyre projekteve territoriale, zv.kryeministrja Mesi listoi disa prej më të rëndësishmeve për qarkun e Shkodrës. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, prezantoi objektiva ambiciozë, duke e cilësuar masterplanin e Alpeve, si një epokë për ta shndërruar atë në një pol të zhvilluar turistik. "Përfitimt ekonomik që pritet të realizohet i kap shifra sipas kalkulimeve në plot 980 mln euro. Nëse në 2016-ën kemi pasur 67 mijë turistë që kanë vizituar Alpet, presim që kjo shifër të shkojë në 102 mijë në 4-5 vjet. Për të shkruar drejt vitit 2031 në plot 600 mijë turistë", tha ministri Klosi.

PLATFORMA

Ndërkohë, pasi ka lënë Shkodrën, ministrat socialistë prezantuan platformën bashkëqeverisëse në qytetin e Pukës. I pranishëm në ak-



Ministri Ditmir Bushati në Pukë

SENIDA MESI

Pas prezantimit të programit të qeverisë në Shkodër, zv.kryeministrja Senida Mesi ka reaguar në lidhje me protestën e organizuar në qytetin e Shkodrës ndaj kryeministrit Rama. "Shkodra nuk është e dhunës. Shkodra nuk është ajo që pret kryeministrin Rama me thirrjet 'Ik'. Kjo nuk është Shkodra. Shkodra është kjo që paraqitet me anë të kësaj ekspozitë", - tha Mesi.

Të rinjtë e FRPD e presin me protesta, Rama ngre dy gishtat

Kryeministri Edi Rama është pritur me protesta nga të rinjtë e Forumit Rinor të Partisë Demokratike në Shkodër. Teksa po hynte në sallën e kinemasë së qytetit ku po zhvillohej mbledhja e Këshillit Kombëtar të Territorit për projektet e qytetit verior, Rama bëri gjestin e zakonshëm përpara të rinjve, duke ngritur dy gishtat lart. Të rinjtë shpalosën parulla si "Qeveria e drogës", "Qeveri e plehrave" etj., duke kërkuar largimin e tij. Ata vijuan të protestojnë edhe pas hyrjes së Rames, ndërsa e akuzuan qeverinë e tij si të kriminalizuar. Protesta zgjati për disa minuta dhe u monitorua nga policia e Shkodrës, forcat 'Shqiponja' dhe FNSH. Pas sheshit përpara kinemasë, të rinjtë në këmbë iu drejtuan selisë blu, duke mos munguar thirrjet: "Rama ik". Ndërkohë pasdite, ish-kryeministri Berisha denoncoi faktin se të rinjtë u dhunuan nga policia.



tivit ishte dhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, i cili ftoi qytetarët të bëhen pjesë e kësaj platforme për të përmirësuar cilësinë e shërbimit. "Platforma për bashkëqeverisje me njerëzit është vetëm jetësim i mbështetjes popullore, që kemi marrë në zgjedhjet e qershorit. Të ndërtojmë një administratë pa asnjë dallim politik, pavarësisht nëse kanë votuar apo jo për ne. Në këtë platformë do kemi mundësi të shikoni tmerret, gabimet dhe të përmirësoni cilësinë e shërbimit", deklaroi Bushati. Ndërsa zv.kryeministrja Mesi i ftoi puktanët të adresojnë të gjitha problematikat që kanë. Deputetja e Partisë Socialiste, njehershëdh edhe koordinatoresha kombëtare e bashkëqeverisjes, Spiropali, iu tha qytetarëve se duhet të bashkohet për t'i dhënë fund këtij sistemi, ku qytetari i ndershëm nëpërkëmbet. "T'i japim fund këtij sistemi, ku qytetari i ndershëm ndjehet i nëpërkëmbur", tha Spiropali.

DEPUTETJA E PD

Tabaku: Qeveria ka vjedhur 2.8 mld euro, janë faktuar nga raporti i KLSH

Deputetja e PD, Jorida Tabaku sulmoi dje qeverinë, e cila sipas saj po lufton korrupsionin përmes fasadave dhe vullnetit politik për të mos ndëshkuar fajtorët. Tabaku shkroi në "Facebook" se janë 2.8 miliardë euro vjedhje të faktuara nga KLSH, që qeveria ka kryer gjatë gjithë qeverisjes. Sipas saj, lufta ndaj korrupsionit kërkon vullnet politik, që qartësisht kjo qeveri nuk e ka, kërkon që të jetë e para në rend të ditës, kërkon shembuj dhe transparencë. "Një qeveri e korrupsionit lufton korrupsionin përmes fasadave dhe vullnetit politik për të mos ndëshkuar fajtorët. Janë 2.8 mld euro vjedhje të faktuara nga KLSH, që qeveria ka kryer gjatë gjithë qeverisjes. Lufta ndaj korrupsionit kërkon vullnet politik e qartësisht kjo qeveri nuk e ka. Lufta ndaj korrupsionit kërkon që të jetë e para në rend të ditës, kërkon shembuj, kërkon transparencë. Pas çdo tenderi, çdo koncesioni, pas çdo emërimi në administratë e pas çdo ligji që miraton kjo qeveri ka klientelizëm. Fatqëqësisht kjo qeveri dështoi të punojë për shumicën, por punoi thjesht për një grusht njerëzish", shkruan Tabaku.

PBDNJ

Vangjel Dule: Kryeministri nuk ka vullnet të mbrojë pakicat kombëtare

Vangjel Dule akuzoi dje kreun e qeverisë se nuk ka vullnet politik për të mbrojtur pakicat kombëtare. Nga një tryezë ku u atakua ligji për mbrojtjen e pakicave, i miratuar vetëm një muaj më parë nga shumica në pushtet, kreu i PBDNJ-së tha se ai ligj nuk zgjidh problemin e kombësisë, një term që Gjykata Kushtetuese e ka shfuqizuar. "De facto privuan qytetarët në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë nga e drejta e vetëdeklarimit", tha Dule. Bashkë me kreun e PBDNJ-së është bërë dhe partia e minoritetit etnik grek për të ardhmen MEGA, e cila nuk kurseu as pozitën dhe as opozitën, si forca të unifikuara për të mos respektuar të drejtat e minoriteteve. "Ky ligj nuk mund të konsiderohet i denjë për të shprehur të plotë kuadrin e të drejtave dhe mbi të gjitha nuk u jep garancitë e duhura minoriteteve që t'i gëzojnë dhe t'i lëvrojnë ato, ashtu siç e kërkojnë aktet ndërkombëtare për minoritetet etnike". Ligji i miratuar në parlament është në kundërshtim me nenin tre të konventës në kuadër të Këshillit të Europës, e cila është ratifikuar nga parlamenti ynë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit çon në prokurori ish-drejtesit e ALUIZNI-t Sarandë

Legalizime në shkelje të ligjit, në Sarandë dhe Tropojë

KLSH: Morën leje 7 ndërtime pa leje në Butrint

Ornela Manjani

Legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonën arkeologjike të Butrintit, pranë rrugës kryesore, pranë vijës bregdetare e pranë lumenjve ka sjellë kallëzimin në prokurori të ish-drejtorit, dy ish-përgjegjësve dhe dy specialistëve të ALUIZNI-t Sarandë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili ka audituar aktivitetin e këtij institucioni gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit gjeti se për 45 objekte të ndërtuara në zonën historike, turistike dhe arkeologjike A, si dhe për 97 objekte të ndërtuara në zonën e mbrojtjes mjedisore "A", Parku Kombëtar i Butrintit, janë kryer shkelje gjatë legalizimit. Drejtorja e ALUIZNI-t Sarandë nuk ka administruar dokumentacionin shkresor për skualifikimin ose jo. Ndërkohë në +1,853 dosje të tjera objekte janë rikthyer në arkivë pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit. Sipas raportit të KLSH-së, mësohet se në 9 raste rezultoi se janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet. Ndërsa, në 17 raste të tjera janë pajisur me leje legalizimi objekte të ndërtuara brenda zonës së mbrojtjes mjedisore "A", Parku kombëtar i Butrintit. Po ashtu, zyrtarët e ALUIZNI-t janë përgjegjës edhe për mosarkëtimin e taksës së infrastrukturës me një vlerë prej rreth 500 mijë dollarësh.



Butrinti

SHKELJET TEK ALUIZNI TROPOJË

- Në 1 rast për pagesën e vlerës prej 2,000,000 lekë për 34 qytetarë, procedura të kryera me dokumente fotokopje, listë përfituesish të pamiruar në këshillin e Komunës, pa urdhër titullar për realizimin e transaksionit si dhe pa mandat pagese të arkës, ku të kenë nënshkruar punonjësit e njësisë dhe personat përfitues të vlerës së mësipërme, duke mos u dokumentuar përfitimin e shumave nga personat përkatës.
- Në 5 raste janë kryer pagesa në vlerën totale 1,985,171 lekë për blerje mallrash dhe kryerje punimesh për mirëmbajtje, blerje fiktive, pra e pakryer, pasi dokumentet financiare urdhëruese dhe vërtetuese, mbështetëse të praktikës nuk argumentojnë nevojën e kryerjes së punimeve dhe kryerjen e tyre.
- Në 12 raste janë kryer pagesa në vlerën totale 2,068,000 lekë për blerje me vlerë të vogla për kryerje punimesh e mirëmbajtjesh, blerje fiktive, pasi nuk vërtetohet me dokumentacion nevoja e kryerjes së punimeve, arsyeja etj., dhe nuk dokumentohet kryerja e tyre.
- Për 3 raste ka pasur moszbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, të cilat përmbajnë detyrime për arkëtime vlerash financiare në masën prej 6,493,043 lekë.

SHKELJET TEK ALUIZNI SARANDË

- Në 10 raste për sipërfaqen 15216 m² është arkëtuar më pak në shumën prej 9.696 milionë lekë.
- Në 940 raste janë kryer shkelje në marrjen e vendimeve, duke mos kërkuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, në vlerën prej 38.228 milionë lekë.
- Për 45 objekte të ndërtuara në zonën historike, turistike dhe arkeologjike A, si dhe për 97 objekte të ndërtuara në zonën e mbrojtjes mjedisore "A", Parku Kombëtar i Butrintit, Drejtorja e ALUIZNI-t Sarandë nuk ka administruar dokumentacionin shkresor për skualifikimin ose jo.
- 1,853 dosje objekte janë rikthyer në arkivë, pa u dokumentuar mbi përfundimin apo jo të procedurave të terrenit dhe dokumenteve, pa u dokumentuar arsyet e rikthimit në arkivë dhe pa u selektuar më parë si subjekte që duheshin skualifikuar apo jo.
- Në 49 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Në 9 raste janë konstatuar shkelje për sipërfaqen prej 2674 m² rezultoi se sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Sarandë.
- Në 3 raste, për ndërtimit pa leje me adresë Borsh, Drejtorja e ALUIZNI-t Sarandë ka miratuar lejet e legalizimit për këto objekte, ndërkohë që për zonën e Borshit, si pjesë e vijës bregdetare nuk lejohet legalizimi i objekteve.
- Në 9 raste rezultoi se janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet. Rezultoni se objektet ndodhen në një distancë prej buzës së detit më pak se 100 metra.
- Në 17 raste janë pajisur me leje legalizimi objekte të ndërtuara brenda zonës së mbrojtjes mjedisore "A" Parku kombëtar i Butrintit, miratuar me VKM nr. 693, datë 10.11.2005.
- Në 1 rast është miratuar leje legalizimi në Zonën "B" Muzeale me nr. 1040149, datë 31.08.2016, "Godinë e kombinuar 4 kate", me adresë lagje nr. 3 Sarandë, ZK nr. 8641.
- Në 14 raste për sipërfaqen totale prej 430 m² ka rezultuar se ka mospërfutje të sipërfaqeve të katit përderis me sipërfaqen për banim dhe janë miratuar leje legalizimi me mospërfutje të sipërfaqeve të miratuara me VKM.

AUDITI

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditim edhe në zyrën e ALUIZNI-t në Bajram Curri dhe ka dërguar për ndjekje penale edhe ish-kryetarin, përgjegjës të Financës dhe një specialist të Komunës dhe një specialist të Tropojës. Gjatë auditimit të kësaj komune, KLSH ka konstatuar shkelje në fushën e prokurimit publik dhe pagesa të paargumentuara e të pajustificuara me dokumentacion, të cilat i kanë shkakuar një dëm ekonomik të konsiderueshëm prej 12.5 milionë lekë financave të ish-komunës. "Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të tij të auditimit nr. 495/1, datë 16.5.2017, ka përfunduar auditimin në Bashkinë Tropojë dhe Njësitë Administrative ish-Komunat Margegaj, Tropojë Fshat, Bujan, Llugaj, Fierzë, Bytyç e Lekbibaj për veprimtarinë nga data 01.07.2014 deri më 31.12.2016 për Bashkinë Tropojë dhe nga data 01.01.2013 deri më 31.07.2015 për 7-ish komunat për periudhën 01.01.2013 deri më 31.7.2015, me objekt auditimi: "Për zbatimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare" ku ka konstatuar 21 shkelje".

INSTAT: Rritet konsumi i kafesë, importohen 61 tonë më shumë

Rritja e nivelit të importit të kafesë mund të shpjegojë faktin se shqiptarët po e konsumojnë më shumë këtë produkt. Ndërkohë, kafeja është një ndër produktet kryesore që importohet dhe tatonet me akcizë. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për periudhën 10-mujore niveli i importit të kafesë arriti në 6 980 tonë, ku vetëm gjatë muajit tetor rezultoi të kenë hyrë në vendin tonë 781 tonë kafe. Sipas të dhënave nga doganat, kjo masë importi e këtij produkti është 61 tonë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Specialistët e doganave, për të analizuar produktin e kafesë përdorin analizën e konsumit, që lidhet direkt me pagesën e akcizës në momentin e hedhjes në qarkullim, kjo nga importi ose nga daljet e magazinave fiskale. Po të analizojmë të dhënat, rezultoni që konsumi i këtij produkti përgjatë muajve të parë të këtij viti ka pasur luhajtje me ulje-ngritje, çka bëri që të nxiteshin debate publike mbi procedurat dhe nivelin e zhdoganimit të këtij produkti. Ndërkohë që disa muaj më parë administrata doganore njoftoi gjithashtu kompanitë për ndryshimet e çmimeve të kafesë në tregjet ndërkombëtare, ku sipas tyre, çmimet e bursës për produktin e kafes, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2016 kanë qenë më të larta, sidomos në muajt e parë të vitit. Në Shqipëri importohen disa lloj kafesh, si kafe e pjekur, e papjekur, e dekafeinuuar etj.



Ministri inspekton Drejtorinë e Targave dhe Patentave në Shkodër

Gjikhuri: Reformë dhe filtër sa më rigoroz për marrjen e patentave

Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjikhuri inspektoi dhe zyrat e Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor në Shkodër. Pasi u njoh me mjediset e punës dhe sportelet e shërbimit për qytetarët, ministri u ndal tek reforma e prishme në këtë sektor problematik. "Jo më kot jemi këtu tek Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit në Shkodër, pasi duam të japim mesazhin që ky është një element shumë i rëndësishëm i qeverisjes shqiptare në fushën e transportit, përtej përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjes së sigurisë rrugore, ku siç e dini, u hoqën qindra e qindra tabela të vendosura në mënyrë të paligjshme në akset rrugore. Një element tjetër i rëndësishëm është sjellja e drejtuesve të automjeteve", u shpreh Gjikhuri.



Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjikhuri, dhe zyrat e Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor në Shkodër

Sipas tij, është shumë i rëndësishëm një filtër sa më mirë për marrjen e patentave, që ai që e merr këtë dokument të ketë të gjitha njohuritë që përcakton ligji. "Reforma do të përqendrohet tek integriteti i këtij shërbimi, për të luftuar korrupsionin masiv për të cilin fatkeqësisht ky institucion e ka pasur reputacionin. Nga ana tjetër, krahas lehtësimit të shërbimeve përmes sistemeve online do të përmirësohet puna për integritetin e procesimit të çdo kërkesë në këtë shërbim. E gjithë kjo strukturë do të nënshtruhet një reforme të thellë, e cila do të synojë elementet e sigurisë rrugore. Qeveria do të investojë nga ana materiale, pra investimi nuk do të mungojë, por mbi të gjitha sjellja e drejtuesve të automjeteve varet shumë nga integriteti i shërbimit të kësaj drejtorie", nënvizoi Gjikhuri.

THEMELIMI I PD RREFIMI

Ish-themeluesi i PD: Në dhjetor më pushuan nga puna, më shpallën të vrarë në kufi

Stani: U propozua që PD të jetë motër me PPSH, si ndërhyri Berisha

"Dikush në sallë i tha Meksit: S'duam pleq në parti"

Valentina Madani

Lazër Stani është dëshmitar i atyre ditëve të jashtëzakonshme të dhjetor '90, kur ëndrra e lirisë kishte ngritur në këmbë një popull të tërë. Ish-themeluesi i PD-së tregon për "Gazeta Shqiptare" momentet më kyçe të lëvizjes së dhjetorit '90 dhe debatet që e shoqëruan themelimin e PD-së. Një ndër firmëtarët e parë të partisë së parë opozitare tregon me detaje se si krerët e lëvizjes ishin të pasigurt në vendimin për krijimin e PD-së, ndërkohë që mes tyre kishte debate, deri dhe propozime që PD të ishte parti motër me PPSH-në. Por, sipas Stanit, ndërhyrja e Sali Berishës se kurrë nuk do të ndodhë një gjë e tillë bëri që salla në kinoklubin e Qytetit Studenti të shpërthejë në brohorima e duartrokitje.

Z.Stani, cila ishte situata me fillimin e lëvizjes së dhjetorit?

Ai dhjetor i vitit 1990, që më pas do të hyjë në histori, pikërisht prej Lëvizjes së Dhjetorit, e gjeti Shqipërinë në një muzg të llahtarshëm. Shqiptarët, që kishin pritur pesë vite me shpresë se diçka do të ndryshonte pas vdekjes së diktatorit, tashmë e ndjenin se thika u kishte shkuar në asht, e kuptonin se u kishte mbetur vetëm një mundësi zgjedhëje: ose të ngriheshin e të përmbynin diktaturën, ose të shuheshin ngadalë në sketërrën e urisë, varfërisë së skajshme dhe shtypjes mizore. "Kështjella e socializmit", siç e quanin atëherë me mburrje Shqipërinë komuniste, ishte gërryer nga themelet, muret i ishin brejtur. Mbahej në këmbë si një fantazmë, duke ngjallur ende tmerr dhe frikë, ushqejte vetëm me panikun dhe kujtesën e llahtarshme të terrorit 45-vjeçar. Asgjë nuk funksiononte më: industria kishte falimentuar, bujqësia ishte shterpëzuar, tregu ishte paralizuar, shtoret ishin zbratur. Uria ishte ulur këmbëkryq në çdo vatrë, në çdo familje shqiptare. Diktaturat lindore kishin rënë njëra pas tjetrës nëpërmjet një revolucioni të butë, të kadifentë, ndonjëherë edhe me dhunë e përgjakje si në Rumani, ku diktatori me të shoqen u ekzekutuan, por kasta komuniste shqiptare përpigje të justifikohje, deklarohje se Shqipëria nuk është as Lindje as Perëndim, se nuk kishte dështuar socializmi, po revizionizmi, se përmbyset në Europën Lindore ishin pasojë e tradhtisë që i bënte Marksizëm-Leninizmit udhëheqjet e këtyre vendeve. Me këto arsytetime idiote, që nuk i besonin as vetë udhëheqësit komuniste shqiptarë përpigeshin të fitonin kohë, të shpëtonin atë që mund të shpëtonin, ndërkohë që përdornin edhe dhunën e kërcënimit. Shenjat e para të pakënaqësisë ishin dhënë që në fillim të vitit me protestën e qytetarëve të Kavajës, me përpjekjen e qytetarëve të Shkodrës për rrëzimin e monumentit të Stalinit, me protestën e Rrugës së Kavajës dhe hyrjen më pas të mijëra qytetarëve në ambasadat e akredituara në Tiranë. Pas largimit të imponuar të më shumë se pesë mijë qytetarëve



Ish-themeluesi i PD-së, Lazer Stani

kurajozë nga vendi, udhëheqësit komunistë organizuan një miting të shëmtuar në sheshin "Skënderbej", ku njëqind mijë njerëz u nxorën më dhunë në shesh për të dëshmuar unitetin parti-popull dhe ku u deklaruan kërcënime të tmerrshme si "Pushtetin e kemi fituar me gjak dhe pa gjak nuk e lëshojmë". Udhëheqësi i rinisë komuniste i asaj kohë deklaroi nga tribuna vargjet e Vaso Pashës: "Asht toka jonë T'parët na e kanë lanë Kush mos ta preki Se vdesim t'anë".

Sikur toka shqiptare të ishte tokë e komunistëve që prej zanafillës.

Kundër kësaj filozofie dhe propagande të vdekjes, që paralajmëronte përgjakjen e Shqipërisë në një luftë civile, nëse tentohej përmbyrja e diktaturës, që ngritur me forcë shkrimtari Ismail Kadare në një shkrim të botuar në atë kohë, ndërkohë që intelektualë të tjerë të njohur si Sali Berisha, Ylli Popa etj., botuan shkrime që binin në kundërshtim të hapur me vijën e partisë, shokuan burokracinë komuniste dhe ngjallën një shpresë të vogull të qytetarët. Megjithatë, diktatura vazhdon të tregonte dhembtë ndaj çdo tentative për t'u organizuar, për të krijuar organizata, ose lëvizje kundër regjimit. Megjithëse flitej për reforma e liberalizim, prapë qytetarët merreshin në polici e rriheshin barbarisht, nëse kërkonin një pasaportë për jashtë, që formalisht regjimi ua kishte lejuar, të rinjtë vriteshin në kufi, edhe pse kalimi i kufirit nuk cilësohej më në ligj tradhti kombëtare. Në qarqe të ndryshme, kryesisht në qarqe intelektuale të Tiranës, diskutoheshin në fshtësi për fundin e regjimit, por pyetja se si do të përmbysej, gjithnjë mbetej pa përgjigje.

LAJMI

"Prej tre muajsh, i përjashtuar nga puna, madje i shpallur edhe i vrarë në kufi, së bashku me time shoqe, prisja me shpresë se diçka do të ndodhte, duke ndjekur me vëmendje çdo lajm që mbërrinte deri aty nëpërmjet valëve të radios nga stacione të ndryshme transmetimi".



Protesta e studentëve në dhjetor 1990

e 8 dhjetorit po ndiqja në dhomën time "Zërin e Amerikës", kur u dha lajmi për protestat e studentëve dhe u transmetua një intervistë me Azem Hajdarin, një emër krejt i panjohur në atë kohë për mua. Zbrita poshtë në dhomën e ndenjes dhe nëna, duke më parë krejtësisht të ndryshuar, e kuptoi menjëherë se diçka e rëndësishme kishte ndodhur. U thashë se në Tiranë studentët ishin ngritur në protesta. "Nesër në mëngjes do të shkoj në Tiranë", shtova pa iu drejtuar askut. Mbretëroi një heshtje e thellë. Nëna ime me kryet të kthyer mënjanë, nuk po i mbante dot lotët, babai thithte i menduar cigaren, pa thënë as shko, as rri. Të nesërmen sa zbardhi drita u nisa për në Shkodër. Po atë ditë mora trenin e mbrëmjes që vinte nga Shkodra në Tiranë. Kur mbërrita unë, Qyteti Studenti ziente. Protestat vazhdonin. Po ashtu vazhdonin edhe përpjekjet për ta shuar Lëvizjen Studentore. Të nesërmen i takova pothuajse të gjithë protagonistet e kësaj lëvizjeje: Azem Hajdarin, Eduard Selamin me të cilin njihesha qysh më parë, Arben Imamini, Gramoz Pashkon dhe plot miq e të njohur të tjerë, që tashmë i ishin bashkuar kësaj lëvizjeje. Nga të gjithë ato debate pafund, herë-herë naive e pa sens politik, ajo që më bëri optimist ishte vendosmëria e studentëve për të mos u tërhequr, ndërsa thirrjet "Liri Demokraci" dhe "E duam Shqipërimë si gjithë Europa" dëgjohehin gjithandej. Kërkesat politike të studentëve tashmë ishin qartësuar: "Duam pluralizëm politik". Pa shpalljen e pluralizmit, protestat studentore nuk do të ndalnin. Ndërkohë që këmbëngulë në këtë kërkesë politike, idetë për krijimin e një partie politike qarkullonin gjithandej, flitej për krijimin e një partie të studentëve, një partie të studentëve dhe intelektualëve, ndërkohë që mbështetja e intelektualëve dhe qytetarëve të Tiranës për studentët protestues rritej nga ora në orë. Nga ana tjetër, regjimi vazhdonte me gjuhën e kërcënimeve dhe të propagandës, përpigje me çdo mjet të izolonte dhe neutralizonte lëvizjen studentore.

Çfarë kujtoni nga ato ditë?

Vetëm njëherë në jetë mund t'i takojë njëriut të jetojë midis ngjarjeve të tilla të jashtëzakonshme, ose edhe kurrë. Unë pata fatin të isha dëshmitar i atyre ditëve të jashtëzakonshme, kur ëndrra e lirisë kishte ngritur në këmbë një popull të tërë. Të gjithë ishim si të dehur nga kjo ëndërr: Mblidheshim të dhoma që ishte shëndërruar në shtabin e lëvizjes, bisedonim me zjarr, shprehej vendosmëria për të vazhduar, merreshin e jepeshin lajme të ndryshme, shpesh kërcënuese, formulohehin ide, bëheshin propozime nga më të ndryshmet. Shpesh protagonistët e lëvizjes me mungesën e plotë të për-

FIRMOSJA

"Kam qenë ndër të parët që kam firmosur në atë listë të themeluesve, pa asnjë mëdyshje, pavarësisht se patí edhe hezitime, pasiguri; disa nguruan të nënshkruajnë. Askush nuk ishte i sigurt për të ardhmen në sfidën përballë një diktature, që i kishte duart të lypa me gjak", tha z.Stani.

minë e tij të madhe. E kisha festuar atë natë, që e mora vesh ikjen e Kadaresë me bindjen se arratisja e tij do të shërbente si një kampanë për zgjimin e shqiptarëve. Por shpresa herë zgjohej e herë venitej, kur e kur dukej se asgjë nuk do t'i zgjonte shqiptarët nga gjumi i madh vdekjeprurës. Edhe mbrëmjen



← vojës politike më krijonin pasiguri, por gjithësesi u binda se pas këtyre protestave, Shqipëria nuk do të ishte më kurrë ajo që kishte qenë për 45 vite, një ferr i vërtetë për shqiptarët. Kjo bëri që të vihesh me mish e më shpirt në mbështetje të lëvizjes. E kisha të qartë se, nëse fitoheshin liritë politike, pra nëse fitohej pluralizmi politik, diktatura do të merrte fund. Asgjë më nuk do të mund ta mbante atë në këmbë. Mbjaj mend se sa shumë gëzoheshim kur shikonim se çdo orë shtoheshin numri i qytetarëve të Tiranës, që vinin në Qytetin Studenti në mbështetje të studentëve. Mes tyre edhe shumë prej miqve e të njohurve të mi, shkrimtarë, poetë,

lëvizjeje. Në kthesa të mëdha historike, roli i individëve të veçantë është përcaktues. Këtë rol përcaktues në fatin e lëvizjes së dhjetorit dhe në krijimin e Partisë Demokratike, padyshim që e ka luajtur Sali Berisha. Kjo nuk do të thotë se zbehët roli i protagonistëve të tjerë si Azem Hajdari, Aleksandër Meksi, Gramoz Pashko, Eduard Selami, Arben Imami dhe shumë të tjerë, por Berisha ishte lideri i duhur; që do ta shndërronte lëvizjen e dhjetorit në lëvizje të fuqishme politike, që sfidoi diktaturën dhe e mposhti atë. Në atë dhomë të Godinës 15, që shërbente edhe si qendër e grupit organizator të lëvizjes studentore, takova për herë të parë Berishën, së



gazetarë, aktorë, intelektualë të profesioneve të ndryshme, profesorë të universiteteve. Pothuajse e gjithë elita e vendit, aq elitë sa mund të krijohet nën një regjim diktatorial, u bashkua me studentët.

Si u njohët me Z. Berisha dhe drejtues të tjerë të lëvizjes?

Me zotin Berisha, deri me në ato ditë dhjetori kisha vetëm një njohje virtuale, e njijha prej shkrimeve të botuara në gazeta dhe famës që qarkullonte rreth emrit të tij si mjek dhe intelektual. Një miku im më kishte folur, duke ma përshkruar me nota të jashtëzakonshme, si një personalitet që i tejkalonte kufijtë e Shqipërisë, si një personalitet shkencor dhe intelektual evropian. Ardhja e Berishës në Qytetin Studenti dhe bashkimi i tij me studentët më krijoi sigurinë se Lëvizja Studentore po shndërrohej në një lëvizje të fuqishme dhe serioze politike. Berisha shquante midis gjithë protagonistëve të lëvizjes për tiparet e tij prej lideri të padiskutueshëm, me autoritet, i kompletuar, vizionar; i saktë në ato që thoshte, i qartë në projektin politik që po formësohej brenda kësaj

bashku me protagonistët e parë të lëvizjes, pikërisht kur po diskutohej për emrin e partisë së parë opozitare pas 45 viteve diktaturë. Nuk mund të them se erdhi në ndonjë njohje me z. Berisha. Njohja erdhi në muajt e mëvonshëm, për shkak të angazhimeve në Partinë Demokratike.

Si u arrit deri tek themelimi i PD-së dhe kush lshin pro dhe kundër për krijimin e saj?

Ka pasur debate, por jo kundërshtime të dukshme për krijimin e partisë së parë opozitare. Debate që vinin nga mungesa e qartësisë politike, nga frika, ose edhe nga provokimet që vinin nga kupola e diktaturës, që rekomandonin krijimin e një partie studentësh, të izoluar nga qytetarët, nga intelektualët, nga mbështetja mbarë popullore, një farë strukture të ngjashme me organizatat që Partia e Punës mbante nën kontroll. Por, intelektualët që u bashkuan me studentët dhe vetë studentët kërkonin një parti të fuqishme opozitare, që do të shkallmonte diktaturën. Pikërisht kjo ishte ideja mbizotëruese, që solli aktin e kr-

PROPOZIMI

"PD do të jetë parti motër me Partinë e Punës. Atë çast ndërhyri ashpër Berisha: 'Partia Demokratike nuk do të jetë kurrë një parti motër me Partinë e Punës. PD do të jetë parti e fuqishme opozitare'. Fjalët e Berishës humbën midis duartrokitjeve të forta, brohoritave, fishkëllimave", shprehet z. Lazer Stani.

ijimit të PD-së. Pas marrjes së vendimit për krijimin e partisë dhe dakordësisë për emrin nga grupi organizator, u procedua menjëherë me hartimin e programit, formulimin e listave dhe mbledhjen e nënshkrimeve. Kam qenë ndër të parët që kam firmosur në atë listë të themeluesve, pa asnjë mëdyshje, pavarësisht se pati edhe hezitime, pasiguri, disa nguruan të nënshkruajnë. Askush nuk ishte i sigurt për të ardhmen në sfidën përballë një diktature, që i kishte duart të lyera me gjak. Kjo është e shpjegueshme. Natyrisht, listat i firmosën intelektualët dhe profesorët që ato ditë u ishin bashkuar studentëve, por edhe qindra studentë. Ndërsa plotësoheshin listat me nënshkrime, kishte edhe ndonjë skenë komike. Dikush tha se duhej të gjenim edhe disa firma punëtorësh që partia të mos dukej intelektualiste dhe askush nuk e kundërshtoi. Atëherë u nxitua të mblidheshin disa firma elektricitistësh, punëtorësh, minatorësh. Intelektualizmi ende shihej si një tipar borgjez, reaksionar. Gjithësesi, listat me firmat e nevojshme u mblodhën brenda ditës. Dokumentet për krijimin e partisë, kërkesa, programi dhe firmat e nënshkruesve u depozituan në Ministrinë e Drejtësisë. Pasdita e dymbëdhjetë dhjetorit ka qenë dita më e gëzuar e jetës sime. Ishim mblodhur në sallën e kinoklubit të Qytetit Studenti dhe po prisim përgjigjen. Ardhja e lajmit për miratimin e Partisë Demokratike u shoqërua me një entuziazëm të jashtëzakonshëm në sallë. Shpërthyen brohorimat, njerëzit i kishin sytë të mbushur me lot. Mes atij entuziazmi shpërthyes e merr fjalën Aleksandër Meksi. Dikush e ndërpreu nga salla: "Nuk duam pleq

ALEKSANDËR MEKSI

"Ardhja e lajmit për miratimin e PD u shoqërua me një entuziazëm të jashtëzakonshëm në sallë. Shpërthyen brohorimat, njerëzit i kishin sytë të mbushur me lot. Mes atij entuziazmi shpërthyes e merr fjalën Aleksandër Meksi. Dikush e ndërpreu nga salla: Nuk duam pleq në parti", tha ish-themeluesi i PD-së.

në parti". Salla reagoi ashpër, duke e quajtur madje edhe provokator. Po fundja ç'faj kishte i shkretë. Socializmi i plakte shpejt njerëzit. Burrat mbi 50 vjeç konsideroheshin tashmë pleq. U ngrit një tjetër, (nuk po ia përmend emrin se nuk rron më) e tha se akti i krijimit të PD-së nuk duhet pritur me shqetësim. Partia Demokratike do të jetë parti motër me Partinë e Punës. Atë çast ndërhyri ashpër Berisha: "Partia Demokratike nuk do të jetë kurrë një parti motër me Partinë e Punës. Partia Demokratike do të jetë parti e fuqishme opozitare". Fjalët e Berishës humbën midis duartrokitjeve të forta, brohoritave, fishkëllimave. Atë ditë të parë u projektua edhe aksioni i fuqishëm opozitar i kësaj partie, që më 22 mars të vitit 1992, përmbysi përfundimisht diktaturën.

A ka enigma themelimi i Partisë Demokratike?

Në shqiptarët jemi shumë të dashuruar pas teorieve konspirative. Shumica e këtyre teorieve janë krijuar për të dëmtuar imazhin e Berishës, për të zbehur rolin e tij në lidhshpinë e PD-së dhe në përmbysjen e diktaturës, duke e futur përfundimisht Shqipërinë

në rrugën e lirisë dhe të demokracisë. Është aluduar, se Berishën e sollën me porosi nga lart që të mbante nën kontroll lëvizjen opozitare. Tashmë kjo "enigmë" është sqaruar, Berishës mund t'i jetë kërkuar që të ndërmetësojë të studentët, por ai bëri pikërisht të kundërtën, nxitoi studentët drejt kërkesave të mirëfillta politike, siç është pluralizmi politik. A mund ta mendoni ju Berishën me një njeri mbi krye, me një njeri që i jep urdhra? Unë që kam bashkëpunuar shumë vite me Berishën kryetar të PD-së dhe me Berishën president, them me plot gojë: kurrë e kurrës. Berisha është nga ata njerëz që lindin për të qenë i parë, kurrë jo i dytë. Pikërisht për këtë them se nuk ka enigma në themelimin e PD-së, ka vetëm një shpirt të fuqishëm opozitar të studentëve dhe të intelektualëve që u bashkuan me ta, që papritmas u zgjua nga letargjia.

Në çfarë gjendje ishte PD-ja pas krijimit të saj? Për cilat arsye u përcësua me pas PD dhe përse kaq i vështirë bashkimi i saj?

Them se PD që në ditët e para pas krijimit ishte në një gjendje fantastike. Qindra njerëz i bashkoheshin çdo ditë, mbështetja për partinë opozitare rritej orë pas ore, pavarësisht situatës së vështirë politike, kërcënimeve të vazhdueshme, provokimeve, anti-mitingjeve të enveristëve. Në vitin e parë u larguan ata njerëz që e menduan PD-në një parti motër të Partisë së Punës, jo një parti opozitare, që po përgatitej të merrte pushtetin. PD-ja ishte shndërruar në partinë e shpresës të shqiptarëve. Pothuajse krejt elita krijuese dhe intelektuale e vendit e mbështeste fuqishëm PD-në, pa folur për mbështetjen e gjerë popullore nga jugu në veri. Përçarjet erdhën më vonë dhe mendoj jo për arsye parimore, po nga mospërbushja e egove për pushtet. Edhe sot ndarjet frymëzohen po nga këto ego, jo nga parime dhe ide politike. Shumë nga kritikët e sotëm kanë qenë në pozita drejtuese në PD dhe në qeverisje dhe sa kohë gëzonin mandatet, në shumicën e rasteve të dhuruar dhe të pamericuar, nuk mbrojtën asnjë nga këto parime politike për të cilat flasin, nuk shprehën asnjë ide politike, për të cilën do të mund të mbaheshin mend. Opozitarizmi i opozitës, për llogaritë të pushtetit ose jo, është i papranueshëm në çdo kohë. Nuk dëmtohet kështu lideri i opozitës, apo struktura e lartë drejtuese, por në radhë të parë anëtarët e thjeshtë të partisë, demokratët që prej njëzet e shtatë vitesh kontribuojnë për këtë parti pa përfituar asgjë dhe sot kur femija, nipi ose mbesa iu kërkoi një akullorë në rrugë sikletosen, ndihen në faj, iu dhemb shpirti se e kanë të vështirë të plotësojnë një dëshirë kaq të thjeshtë një femije, për të mos folur pastaj për qindra vështirësitë me të cilat ata e përballojnë jetën e përditshme. Nuk e shikoj çështjen e bashkimit të PD si kthim në oborrin e saj të dhjetë apo pesëmbëdhjetë personave. PD, së pari duhet të bashkohet me anëtarësinë e saj, të shndërrohet në shpresë për demokratët, në shpresë dhe zë përfaqësues për të gjithë ata qytetarë që ndihen të braktisur, të keqtrajtuar dhe të nëpërkëmbur nga kjo qeveri. Dhe këtu përfshihen shumica absolute e shqiptarëve. Kjo, mendoj unë, është rruga e ringritjes së fuqishme të PD-së dhe opozitës.

25 vite nga themelimi i PD, a e fituan demokratët betejën ndaj së keqes?

Të gjitha ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur në këtë vend gjatë këtyre 27 viteve janë meritë të padiskutueshme e Partisë Demokratike. Por beteja me të keqen, beteja me padrejtësitë, varfërinë, pushtetet e dhunshme, të korruptuara, beteja për një jetë më të mirë e më të denjë për qytetarët është e përhershme. Sot më shumë se kurrë Shqipëria ka nevojë për një politikë me frytëz njerëzore, për një politikë humane që ka në qendër të vet njeriun, zhvillimin dhe mirëqenien e tij. E majta nuk e ka për traditë humanizmin. Aq më pak e majta shqiptare, që ka një traditë të dhunshme. Afrimi i programit të PD-së me atë të kristian-demokratëve gjermanë, për mua shënon në stad të ri për këtë forcë politike. Unë besoj se PD ta fitojë edhe këtë betejë të radhës për të bërë Shqipërinë, së paku, një vend të jetueshëm për qytetarët e saj.

Shoku i Klevis Sulës: U afrua për të ndihmuar një njeri, ai e qëlloi

Vrasja e të riut shqiptar në Islandë, asnjë detaj nga policia

Mesazhi prekës i motrës: Akoma po të pres vëlla

A snjë shpjegim nga policia islandeze për vrasjen me thikë të 21-vjeçarit Klevis Sula. I vetmi detaj është dhënë nga miku i viktimës, sipas së cilit, ai shkoi të ndihmonte një endacak, i cili ishte i pirë e po tymoste e pasi e pyeti nëse kishte nevojë për ndihmë, u qëllua në mënyrë fatale nga 'endacaku'. Mes shumë mesazheve prekëse që i dedikohen Klevis Sulës, 21-vjeçarit që humbi jetën në Islandë, pasi u plagos me thikë, edhe motra e tij ka bërë një dedikim. Ajo shkruan se ai e 'gënjeu', duke i thënë se do vinte shumë shpejt në Shqipëri. Lajmi i ndarjes nga jeta të 21-vjeçarit nga Skrapari u publikua edhe në faqen zyrtare të policisë islandeze dhe në shumë media të Islandës ngjarja tërhoqi vëmendjen e opinionit publik.

MESAZHI I MOTRËS

Ti ishe engjëlli më i bukur këtu në tokë, por Zoti nuk të la mes nesh, të vendosi flatrat e të mori pranë vetes! Po si mundem unë, ne, të të themi ty lamtumirë?! A do mundem ndonjëherë të harroj vëllain tim të madh... se ti kështu më thoshe gjithmonë. Ma kujtoje gjithmonë që unë s'kisha vetëm një vëlla po kisha dy, së të kisha ty. A do mundem unë, ne, të harrojmë kujtimet me ty? A do jemi ne të njëjtët pa ty? A



Viktima Klevis Sula

do mund të qëndrojnë më në këmbë këto male të lartë nga dhimbja jonë e madhe? Unë, ne, të gjithë po të prisnim, se na the që do vije. Na gënjeve! Ne prapë po të presim, po kush? Kush nga ne e dinte se do të vije kështu siç po vjen, si një furtunë që mbasi

mbaron, ka shkatërruar shumë gjëra, shumë ëndrra, shumë plane... Ti prapë do vish e do ikësh përsëri... për herë të fundit! Të ketë vallë fund? Joo, joo nuk ka se po të kishte, ti me gjithë qenien tënde duhej të ishe këtu me ne, pranë nesh, pranë të

gjithëve, jo të shndërrohesh në një vegim, në një kujtim dhe në një dhimbje të përhershme! Sot bashkë me zemrën tënde është vrarë edhe zemra e një motre, është vrarë zemra e një vëllai, e një nëne, janë varur koka nga pikëllimi dhe lotët s'do

Ti ishe engjëlli më i bukur këtu në tokë, por Zoti nuk të la mes nesh, të vendosi flatrat e të mori pranë vetes! Po si mundem unë, ne, të të themi ty lamtumirë?! A do mundem ndonjëherë të harroj vëllain tim të madh... se ti kështu më thoshe gjithmonë.

t'i ndalë as përdimi dhe as agimi i shumë ditëve që do të vijnë... Unë akoma po të pres vëlla, do të të pres dhe do të të përcjell përsëri, pastaj e ke radhën ti të më presësh mua, te na presësh ne, se një ditë do të jemi pranë teje...


FIER



Përplasen dy makina, plagoset nëna dhe djali i porsalindur

Dy persona kanë mbetur të plagosur pas një aksidenti automobilistik në Fier. Ngjarja ndodhi në lagjen "Sheq i Vogël" të këtij qyteti, ku automjeti tip "Benz" është përplasur me një tjetër mjet e për pasojë u plagosën dy persona, nëna dhe djali i saj i porsalindur. "Në datën 09.12.2017, në orën 16:50, në lagjen 'Sheq i Vogël' është përplasur mjeti tip 'Benz' me drejtues shtetasin A.K., 45 vjeç, banues në Fier, me mjetin tip 'Benz' me drejtues shtetasin L.T., banues në Fier. Si pasojë e përplasjes është aksidentuar bashkëshortja e shtetasit L.T., shtetasja L.T., 23 vjeçe dhe djali i tyre disaditësh, të cilët ndodhën në Spitalin Rajonal Fier nën kujdesin e mjekëve.

POLICIA ITALIANE



Kokainë, marijuanë dhe euro në banesë, arrestohet trafikanti shqiptar

ITALI - Policia italiane arrestoi një 55-vjeçar shqiptar, pasi akuzohet për shpërndarje të lëndëve narkotike. "La stampa" shkruan se shqiptari, identiteti i të cilit nuk dihet, u arrestua në zonën e Albas. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij në Fossano, atij iu gjetën 2.5 kg marijuanë dhe 1.5 kg kokainë. Mediat italiane raportojnë mes të tjerash se shqiptarit iu gjetën dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale edhe 4500 euro, që dyshohet se vinin nga shitja e drogës. Po ashtu, bëhet e ditur se 55-vjeçari prej kohësh ishte vënë në ndjekje të policisë. Tashmë ai ndodhet në burgun e Cuneos në pritje të masës së sigurisë.

Iu gjet drogë dhe fishekë, përfundon në pranga 57-vjeçari

DURRËS - Një 57-vjeçar nga Durrësi ka përfunduar në pranga, pasi u kap me një sasi lëndësh narkotike si dhe fishekë. Burime zyrtare nga policia e qytetit bregdetar bënë me dije se është arrestuar Gjon Brahe, banues në fshatin Bizë të Ishmit. "Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në vijim të punës së tyre për parandalimin e rasteve të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, të premtën kanë goditur një tjetër rast. Është arrestuar në flagrancë shtetasi Gjon Brahe, 57 vjeç. Në bazë të informacioneve të siguruar nga strukturat policore, më datë 08.12.2017 gjatë kontrollit të ushtruar në fshatin Bizë u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provave materiale një sasi prej 3.134 kg lëndë narkotike e dyshuar e llojit kanabis sativa dhe 156 copë fishekë të kalibrit 7.62 mm. Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se sendet e mësipërme të sekuestruara i përkasin shtetasit të arrestuar. Materiali i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Durrësit.



"Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në vijim të punës së tyre për parandalimin e rasteve të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, të premtën kanë goditur një tjetër rast.



Aplikim për të përfutur Statusin e Naftëtarit

Njoftohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njërit prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/ ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.

INTERVISTA/ Rrëfimi ndryshe i kryetarit të bashkisë: Kryeqyteti është dashuria ime

Veliaj: Ajola më thotë se jam martuar me Tiranën

“Me stafin tim jam shumë i rreptë dhe shumë kërkues”

Fjodora Fjora

Kur flasim për trende, kur flasim për atmosferë festash, kur flasim për dekor e ku ka më mirë se sa qyteti, dritat e të cilat i ndezëm pak ditë më parë. I ftuar nderi në emisionin "Chic" të gazetares Fjodora Fjora në "News 24", ishte kryetari i Bashkisë së Tiranës, zoti Erion Veliaj, apo Erioni miku i të gjithëve. Në një intervistë ndryshe Veliaj foli për Krishtlindjen, për atmosferën e tyre, për vitet që ka jetuar në SHBA dhe ndikimet që ka prej atij vendi, pikërisht në festën e madhe. Sa ka ndikuar jeta e kryebashkiakut në atë që mund të quhet Krishtlindje në kryeqytetin që ai drejton. Ai na tregoi një ditë të tëra nga fillimi deri në fund, se si fillon dhe mbaron dita e një kryebashkiaku.

Si nis dita jote?

Nisja herët në mëngjes të jep mundësi që të mbarosh disa gjëra. Tiranë zyrtare zgjohet në orën 8:00, shkon në orën 9:00. Por duke i ditur ritmin, duhet të dalësh pak më përpara që t'i vesh gjërat në vijë përpara se njerëzit të fillojnë me kërkesat. Ai dyorëshi në mëngjes 06:30-07:00 deri në 09:00 kur nuk ka këmbë njeriu është momenti për të lexuar pak edhe shtypin botëror, për t'u informuar çfarë po ndodh dhe për të lënë porositi e tua për gjërat që do të arrijsh atë ditë. Në momentin që e vë ditën para, nuk të vë dita ty.

Në zyrë jam shumë pak kohë, kryesisht për të pritur delegacionet, ose tani që janë festat e fundvitit, që vijnë ekskursionet të shkollave, gjëra të kësaj natyre. Një dyorësh më kap në zyrë, kjo puna burokratike. Në fund të ditës para se të shkoj në shtëpi, 22-23 është ora kur duhet të firmos një pafundësi letrash.

Sa gjumë fle?

Kjo është si një njeri që ka rënë në dashuri, i cili nuk di sa është ora. Ai mezi pret të zgjohet në mëngjes që të merret me dashurinë e vet. Kjo është dashuria ime, me këtë zgjohem në mëngjes, me këtë fle dhe Ajola ma ka pranuar. Kjo është një kohë, një vëmendje dhe një dashuri që duhet ndarë me qytetin dhe bashkinë. Ajo ndonjëherë thotë 'jam martuar me Tiranën'.

Cili është rituali i mëngjesit?

Kur zgjohem nuk pi kafe, pi vetëm ndonjëherë për të shoqëruar ndonjë, uljen në kafe e kam vdekje, nuk ulem. Nuk i paragjykoj ata që e bëjnë, por mua nuk më pëlqen. Nëse ngrihem shumë herë dhe kur ka diell i fus një vrap të vogël nga liqeni. Pas maratonës, vrapin e bëj në darkë. Në mëngjes thjesht vij në zyrë dhe u jap dum gjëra, nis punën. Kjo gjë më karikon, më jep energji, është si një lloj droge. Jeta e një njeriu që merret me gjëra publike është pak e vështirë, të takon të pickosh ndonjë gjë, do bësh gëzuar dhe po të mos jesh i disiplinuar, do bëhesh si kacak. Dhe kur kam qenë të 'Mjaff'



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj në emisionin "Chic" në "News 24"

i thosha: "O Zot, mos u bëftë njeriu politikan që fryhet". Një njeri që nuk disiplinon dot peshën e vet, çfarë do t'i bëjë popullit. Kështu që mundohem ta kem këtë disiplinë.

Kam dëgjuar që shkoni jashtëzakonisht vonë në shtëpi?

Po nuk të del dita, vetëm koha fizike për të bërë takime... Bashkia ka mbi 60 drejtori dhe agjencitë, sikur një minutë të flasësh me ta, të ikën pjesa më e madhe e kohës. Tiranë është kryeqendra e vetme e Shqipërisë, sot psh., ishte ish-presidentja e Kosovës, disa kryetar bashkish të rajonit, disa delegacione që vijnë, pra minimalisht vetëm koha fizike që si titullar që përfaqësoj qytetin duhet të jem prezent me sjell në zyrë, në të kundërt unë do isha rrugëve.

A nuk do të thotë kjo një mungesë karshi asaj që duhet të ishte pjesa familjare, domethënë të shohim me njerëzit e tu?

Mamaja ime bën batuta 'më shumë të shohim në televizor', 'sa je dobësuar e shëndosh', varet nga televizioni që të nxjerr. E kalon me humor për të thënë mos ka ardhur koha të vish fizikisht të shohim. Ndërsa me Ajolën mundohem që të koordinohem, psh në qoftë se më bie rruga në ndonjë vend që është ajo, por mundohemi që eventet e darkës t'i bëjmë bashkë. Në pamundësi për të shkuar në disa vende, çoj një nënkryetar bashkie, kur më mbarojnë ata, çoj Ajolën dhe më jep një dorë.

Një atmosferë festive i jep një qyteti një dëshirë për të jetuar për të shikuar festat?

Qyteti është si shtëpia jonë e madhe, është pak si stolisja e shtëpisë dhe pavarësisht vështirësive, njerëzit duan një lajm të mirë, një energji pozitive, e duan diçka që t'u jep shpresë. Unë mendoj që roli i kryetarit të bashkisë nuk është roli i komunales dhe të jetë përgjegjës për gjëra të infrastrukturës, por është edhe tifozin numër një i qytetit. Në qoftë se tifozin numër një është depresiv, nuk ka pikë entuziazmi, atëherë çfarë do të bëjë skuadra. Unë e marr shumë seriozisht të qenit kryetifoz i qytetit. Këtë e bëj jashtë, kur duhet të prezantoj qytete dhe them Tiranë është qyteti më i mirë në botë, ka edhe të tjerë, por unë nuk njoh, atë njoh. Në qoftë se ti mendon

mirë dhe pozitivisht, qëllon që të gjithë gjërat e mira të ndodhin.

Ke një ndikim të themi nga Amerika?

Jam rritur atje, sigurisht që kam. Të gjithë jemi rritur në një familje modeste, kemi pasur Vitin e Ri. Ndonjëherë u them njerëzve mos më ngatërroini me çunin e mirë që shihni në televizion, unë e di çfarë nuk funksionon, e di saktësisht ku sabotohet ky qytet.

Punës mangët nuk ia kë lënë, por edhe të treguarit e punës e ke kthyer në një lloj misioni me vetë për t'ua treguar njerëzve?

Nuk e besoj që njerëzit kanë nevojë për një dozë konstante jo vetëm informacioni, por edhe optimizmi. Jam i vetëdijshëm që 200 pemë të mbjella te Liqeni i Thatë, dikujt në Shkozë as nuk i hyjnë në punë, ama i jep shpresë dhe thotë se është vetëm çështje kohe që po vazhduan me këtë ritëm, do të vijnë edhe tek lagjia ime. Ky pylli orbital do e bëjë xhiron. Parimi që ditën e parë që kam qenë në Bashkinë e Tiranës është se që kjo bashki është një 'pulë' e madhe dhe çdo ditë duhet të bëjë një vezë. Në 1000 mijë ditë që kemi qenë në bashki, kjo 'pulë' ka bërë një vezë përditë, disa herë edhe më shumë. Në qoftë se çdo ditë ka nga pak progres, për disa njerëz është e prekshe mundohet aty, për dikë tjetër është shpresë, është vetëm çështje kohe sa të vijë edhe radha ime.

Në të gjithë këtë dekor u ke besuar vetëm asistentëve të tu, apo ke edhe ndonjë prejke që mund të quhet shija jote personale në arredimin e Tiranës?

Kam një skuadër dhe mundohem që mos të mikromenaxhoj, sigurisht për disa gjëra duhet të marrësh ndonjë vendim, një sy i mprehtë që sheh punë publike gjithë ditën vë re cene të vogla, por për disa gjëra që kanë më shumë dije dhe shije se ti, duhet t'ua besosh atyre. Kam dy vajza fantastike, njërin për sheshin "Skënderbej" dhe tjetrën për "Pazarin e Ri", që janë marrë me këto hapësirat e mëdha. Sot i kemi kthyer të dyja në pedonale.

Këto pulovrat me Krishtlindje nuk i ke blerë vetë?

(Qesh) Jo, nuk i kam blerë vetë, por mendova se do ishte një ide fantastike për të gjithë fëmijët që vijnë

FESTAT

Qyteti është si shtëpia jonë e madhe, është pak si stolisja e shtëpisë dhe pavarësisht vështirësive, njerëzit duan një lajm të mirë, një energji pozitive, e duan diçka që t'u jep shpresë. Unë mendoj që roli i kryetarit të bashkisë nuk është roli i komunales dhe të jetë përgjegjës për gjëra të infrastrukturës, por është edhe tifozin numër një i qytetit.

nen në Shën Gjergji.

Edhe pse është pak herët, ku do t'i kalosh Krishtlindjet apo Vitin e Ri?

Vjet i kaluam me zjarrfikësit në Tiranë dhe këtë vit do zgjedh një nga institucionet, por në fund të ditës, më 31 dhjetor, do jemi në shesh për të hedhur fishekzjarrët. Edhe në datën 1 do shohim bebushat do të lindin atë ditë. Mbjaj mend vjet ishte një debat sepse "Mbretëresha Geraldinë" thoshte lindi tek ne, ndërsa "Kočo Gliozheni" lindi tek ne dhe i thashë stafit a ka mundësi ta nisim pa dramë, do të shkojmë tek të dy. Për sa kohë që ne i ruajmë këto gjëra të vogla apo të gjitha sebept, jemi me këmbë në tokë. Ky tokëzimi na mban pak në kontroll, gjëja e parë që kontrollojmë është vetja jonë, mallkimi më i madh që mund të të japë dikush në këtë detyrë është "Të hiptë vetja në qejf". Për sa kohë që s'më ka rënë ai mallkimi, do vazhdojmë të fokusohemi te puna dhe të ruajmë njerëzillëkun. Kjo s'do të thotë që nuk do të marrim vendime të vështira. Unë them më mirë vendime të vështira, sesa të them "Po, po" gjithë kohën dhe mos të bëhet asgjë. E kemi provuar edhe atë stil, por nuk funksionon kështu që jemi të rreptë për ata që e shkelin bashkëjetesën tonë dhe sigurisht jemi bujar dhe solidar me ata që janë më nevojtarë dhe kjo lloj balance e mban qytetin si një familje e mirë.

Është fundi i 2017-ës, ku mendon se është Tiranë jote në konceptin tënd, i një njeri që e ka jetuar Tiranën në fëmijërinë e tij ka pasur Krishtlindje, Vit të Ri. Tani je "koka" e kësaj Tiranë në kuptim figurativ, ku është Tiranë jote?

Unë e them dhe mendoj se nuk është atje ku duhet, por më mirë, sepse do na kapte një vetëkënaqësi. Të menaxhosh një qytet në Zvicër duhet të jetë gjëja më e mërzitshme në botë dhe pikërisht se është atje ku unë dua që do të thotë që mezi presim të zgjohemi nesër që ta çojmë dhe çikë më lartë dhe çikë më lartë edhe vitin tjetër dhe kështu me radhë. Ama me stafin tim jam shumë i rreptë dhe shumë kërkues. Nuk mendoja që njerëzit do të linin Bankën Botërore apo banka të sektorit privat apo institucione të rëndësishme dhe të paguhen sa 1/3. Pra, njerëzit nuk jetojnë vetëm për rrogën, pra njerëzit jetojnë edhe për një sens misioni edhe për të lënë gjurmë, një emër. Dhe në këtë sens jam shumë krenar për të gjithë ekipin.

Nëse secilin nuk bën të vetën, këputet zinxhiri dhe hallakatet. Tiranë po bëhet më njerëzore dhe nëse vazhdohet në mënyrë të tillë, nuk kam asnjë dyshim që Tiranë do të jetë qyteti më i mirë në Ballkan. Sot unë u kërkoi të gjithëve nëse kanë mundësi ta bëjnë, nëse rrinë në "Facebook" dhe shohin shtetin në ato minuta, mund të shkojnë ta ndihmojnë vetë dikë që është nevojtar. Nëse kjo frymë na përshkon të gjithëve, atëherë do të kemi një Tiranë dhe një Shqipëri më të mirë.

PREMIERA

“YJET E SË ARDHMES”

Filmi me kolosët e ekranit mbërrin në kinema

Dhjetëra artistë dikur të suksesshëm, je tojnë diku të harruar dhe jo rrallë në luftë për ekzistencë. Tranzicioni stërzgatur, lufta midis brezave dhe superioriteti i brezit të ri, bazuar kryesisht në shfrytëzimin e mungesës së rregulave dhe mungesës së sistemit të vlerave ka bërë që artistë cilësorë të mbeten jashtë tregut dhe vëmendjes së shoqërisë. Filmi “Yjet e së ardhmes” ka një kast të jashtëzakonshëm aktorësh, një ansambël harmonik në energji, talent dhe përkushtim, përbërë nga: Gazmend Paja, Elia Zaharia, Tinka Kurti, Reshat Arbana, Margarita Xhepa, Luftar Paja, Ema Andrea, Karafil Shenaj, Sadush Ylli, etj. Ata kanë ndërthurur një ansambël harmonik në energji, talent dhe përkushtim, duke na transmetuar me forcë dramatik, pasionin, brengat dhe ngadhënjimet e një jete të jetuar në dehje – në çdo cast dhe deri në fund... Tri breza artistësh – performojnë së bashku në një sfidë suksesi dhe mundësisë, në një himn dashurie për jetën dhe besnikërinë ndaj ëndrrave të pajetuara...

NË KINEMA
Pas premierës, më 13 dhjetor, në të gjitha kinematë e kryeqytetit do të fillojë të shfaqet filmi “Yjet e së ardhmes” – një komedi romantike muzikore me metrazh të plotë, i prodhuar nga Multi Media Studio NOSITI - Film & TV Production, me regjisor dhe producent Edmond Topin. Skenari i Uli Bree, përshtatur për publikun dhe komunitetin tonë nga vetë regjisorin, vë në fokus moshën e tretë dhe marrëdhëniet e shoqërisë me të, konkretizuar figurativisht dhe në mënyrë përfaqësuese në marrëdhëniet e komunitetit me brezin e tretë të atyre artistëve, që si pasojë e tranzicionit dhe mungesës së kujdesit të shoqërisë për ta pothuajse janë harruar. Shoqëria shqiptare, si një shoqëri e pazhvilluar, ka vuajtur dhe vuan nga sindroma e pamundësisë së realizimit të ëndrrave. Prapambetja shekullore, kodi zakonor, varfëria e më pas sistemi i çmendur autokratik bëri që miliona njerëz të mos kishin mundësinë të realizoheshin në jetë. Ky film u kushtohet edhe të gjithë atyre, që moshë e tretë i gjeti me “ëndrra në sirtar” për shkak të mungesës së mundësive, pavarësisht aftësive. Duke rrahur të transmetojë mesazhin se çdo moshë ka ëndrrat, mundësitë, sukseset dhe zhgënjimet e veta, filmi i vë brezat t’i ndajnë ato me njëri-tjetrin, duke i afruar ata në komunikim intensiv për përjetime, vlera, plane, dështime dhe suksese të përbash-


këta. Filmi tenton të sjellë kështu krejt natyrisht dhe në mënyrë organike argumentin se brezat mund të bashkëjetojnë shumë mirë, nëse komunikojnë dhe njohen midis tyre. Dialogu i munguar në shoqërinë shqiptare dhe paragykimet, që vijnë kryesisht nga mosnjohja do të tentohet që në film të vijnë përmes situatës herë absurde, herë të papërbalueshme, herë tragjike, por jo rrallë edhe optimike. Përmes modelit të një grupi të moshuarish fillimisht në krizë vetmie dhe harrese, të cilët vullneti, këmbëngulja dhe dashuria për jetën i shtyn drejt një suksesi të paëndërruar duke i shndërruar në heronj edhe për të rinjtë, filmi e sfidon komunitetin lidhur

Nga Reshat Arbana, te Tinka Kurti e Margarita Xhepa - aktorët që bashkohen në një histori mbresëlënëse

me qasjen shoqërore ndaj moshës së tretë: suksesi, lumturia e madje edhe dashuria as kanë dhe as njohin moshë – nëse tenton drejt tyre, ato mund t’i bësh tuat deri ditën e fundit të jetës... Mjafton të duash, të kesh vullnet dhe të tentosh drejt tyre... I konceptuar si një komedi muzikore romantike, filmi kombinon karakterin sensibilizues me atë argëtues. Ai është realizuar me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Bashkisë Tiranë.



Skenë nga filmi



Posteri i filmi

Një “artist”, që ka një jetë që bën muzikë pa u bërë dot i njohur, ka më në fund shansin që bashkë me formacionin e tij muzikor, të marrë pjesë në një konkurs kombëtar talentesh. Pas një sherri, i cilit e çon në gjykatë, ai negocion për ta kthyer dënimin në 90 ditë punë në doli të komunitetit. Shtëpia e të Moshuarve, ku do të kryejë dënimin është një vend i qetë dhe me rregulla të forta, ku të moshuarit shtyjne ditët në rutinë dhe amulli. Nën drejtimin pedant të një drejtoreshë simpatike sa edhe të akullt, aty nuk ndodh asgjë, përveç vdekjes... Me natyrën e drejtpërdrejtë, humorin dhe dëshirën për të jetuar, ai u ringjall atyre instinktet e harruara dhe dëshirat e tradhuara. Simpatia që lind mes tyre prodhon idenë e një kori me të moshuarit. Por, kur të gjithë zënë të këndojnë të entuziazmuar, shfaqet drejtoresha dhe gjithçka mbaron. Artisti detyrohet të lërë punën dhe të kryejë dënimin me heqje lirie. Pa grup dhe rrugës për në burg mendon se ëndrra e tij për karrierë artistike mori fund përfundimisht. Por të moshuarit nuk tërhiqen.

Ndërron jetë historiani Kristaq Prifti, anëtar i Akademisë së Shkencave

Ndërroi jetë dje në moshën 85-vjeçare akademik Kristaq Prifti, historian i njohur, specialist i periudhës së Rilindjes Kombëtare, orientalist, me veprimtari drejtuese në institucionet akademike-universitare. I ndjeri Kristaq Prifti u lind në Berat më 21 janar 1932, ku kreu edhe shkollën e mesme. Studimet e larta në fushën e historiografisë i përfundoi në Moskë. Pas kthimit në atdhe, punoi si mësimdhënës në Universitetin e Tiranës. Ishte një prej profesorëve themelues të këtij universiteti, ku kreu disa detyra, si përgjegjës i katedrës së historisë, zëvendësdekan dhe dekan. Që nga viti 1982 ka qenë kërkues shkencor në Institutin e Historisë dhe në vitet 1991-1993, drejtor i tij. Përveç

mësimdhënies në UT, Kristaq Prifti ka mbajtur ligjëratat edhe në Universitetin e Prishtinës. Fushat kryesore të veprimtarisë shkencore të akad. Kristaq Priftit, në kuadër të historisë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare deri në themelimin e shtetit shqiptar, janë: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Shqiptare e Pejës, shqiptarët në periudhën e revolucionit xhonturk, lëvizja politike-kulturore në Shqipëri në prag të Pavarësisë, Kongresi i Manastirit dhe njësimi i alfabetit të shqipes, shpallja e Pavarësisë dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Në dekadat e fundme veprimtaria e Kristaq Priftit u shtri edhe në historinë e Kosovës në shek. XX, sidomos në zhvillimin demografik të saj.




Kristaq Prifti

Kërkimet e tij në këto fusha janë përmbyllur me studime të plota monografike, disa prej të cilave, sipas rendit kronologjik, janë: Kongresi i Manastirit, ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Ko-

mbëtare (bashkautor, 1968, 1978, 2004); Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878-1881 (1978); Lidhja Shqiptare e Pejës; lëvizja Kombëtare 1896-1900 (1984, 2002); Historia e Shqipërisë, vëllimi II (drejtues shkencor, 1984); Dr. Ibrahim Temo: jeta dhe vepra (1987, 1993, 1996); La Ligue Albanaise de Prizren, vol. I (bashkëpërgatitës, 1988); Historia e popullit shqiptar, vëll. II (bashkautor e drejtues shkencor, 2002) dhe vëll. III (bashkautor e drejtues shkencor 2007) dhe Popullsia e Kosovës (2014). Akad. Kristaq Prifti (1932-2017) ka edhe kontribute të tjera të vlerësuara nga bota e dijes si bashkëpërgatitës dhe bashkëredaktor i disa vëllimeve me dokumente e studime, si: Alfabeti i Gjuhës

Shqipe dhe Kongresi i Manastirit (1972); E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi (shqip e anglisht, 1984); Sami Frashëri, vepra (vëll. I-II, 1988); Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual (shqip e anglisht, 1993, 1996); Himara në shekuj (2004). Akad. Kristaq Prifti është autor i shumë artikujve studimorë, të botuar në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ai është dekoruar me Urdhërin “Flamuri i Kuq i Punës” (klasi I) dhe ka marrë Çmimin e Republikës (klasi II). Me vdekjen e tij, Akademia e Shkencave shënon se humbi një anëtar me veprimtari të gjatë dhe cilësore në kërkim dhe një prej drejtuesve që kanë lënë gjurmë progresi në institucionet ku kanë punuar, ndërsa bota shkencore humbi një djetar me përvojë dhe një njeri të suksessit shkencor.

**E DIEL
10 dhjetor
2017**



**Enkas
për "Milosao"**

**NGA PROF.
DR. IRAKLI KOÇOLLARI**

Njeriu, sigurisht, ka pasur nevojë të komunikojë me gojë apo me shkrim, gjerësisht, publikisht, por po aq sa edhe të komunikojë veçmas individualisht. Nevojat e kanë bërë njeriun të flasë me zë të lartë dhe në tribuna të hapura apo përmes mjeteve të komunikimit masiv (medias, shtypit të shkruar, autoporlantëve, megafonëve, ...) por rethanat, nevojat dhe interesat e kanë bërë njeriun të flasë edhe në mënyrë selektive, private, me zë të ulët apo vesh më vesh. Por, jo vetëm të flasë, por edhe të shkruajë në mënyrë selektive, që vetëm dikush të kuptojë ndërsa të tjerët edhe në u rëntë në dorë teksti i shkruar të mos arrijnë të kuptojnë përmbajtjen e tij. *Për të zgjidhur këtë nevojë njeriu shpiku shkrimin e fshehtë: KRIPTOGRAFIA!* (Kripto – i fshehtë, grafo – shkruaj). Shkrim që fsheh tek-

Ali Pasha përdorte kode shifrorë

(dhe sistemin e kriptografisë në këmbimet e informacionit)

stin e vërtetë.)

Ishte një prirje po aq e vjetër sa edhe vetë shkrimi. Askush nuk mund të thotë me siguri se kur janë filluesat e këtij shkrimi të pakuptueshëm, por gjetjet historike na bëjnë me dije metodologjitë që përdornin kinezët e lashtë qysh në shekullin e 6 p. Kr., për të përcjellë mesazhe sekrete (Kinezët rruanin kokën e korjerit të besuar, shkruanin mbi kokën e rruar me tatuazh mesazhin sekret, prisnin të rritej floku dhe e nisnin atë në destinacion, ku pritësit i rruanin kokën koerjerit bartës të mesazheve për të lexuar ç'ishte shkruar nën flokë. Ndërsa Cezari përdori papirusin e spërdredhur në formë rotori. (Parim mbi të cilin u ngritën në kohët modern aparatet rotor të shifrim deshifrimit) Ai shkruante



mbi të informacionin, mandej e zh-dërdhiste papirin dhe automatikisht informacioni ishte shifruar. Edhe në mesjetë mesazhet e krijuara u përdorën privatisht apo individualisht në luftat për fronë dhe pushtet, kurthe, kullisa, pabesi, etj., por asnjëherë ato nuk u institucionalizuan, pra nuk u ngritën struktura të posaçme që do të bashkëshoqëronin jetën e shtetit.

→ **Vijon në faqen 14**

Luljeta Lleshanaku për "Milosao"
**"Më tërheqin historitë e mbijetesës,
 sepse ato e vënë njeriun para sfidave"**

Intervista për "Milosao" është bërë në fillimjavë. Luljeta Lleshanaku është një nga penat më të njohura shqiptare të dekadave të fundit e ndoshta më përcjelljen më prestigjioze ndërkombëtare të këtyre viteve. Ajo rrëfen aspekte teknike të krijimtarisë së saj. Do të kishim dëshirë në të ardhmen, që të kishim një intervistë të stërgjatë me autoren, që i ka dhënë aq shumë letërsisë shqiptare...

Në këtë numër: Luljeta Lleshanaku, Irakli Koçollari, Moikom Zeqo, Majakovskij nën përkthimin e Faslli Halitit, Behrim Jusufi, etj

A

ARGUMENT

Argumenti që po botojmë tek numri i ri i "Milosao"-s përcjell një nga risitë më të mëdha të shekullit XIX, përdorimit të kriptografisë. Në një shtjellim, që duket se është baza e një studimi të ri të profesor Koçollari po evidentohet përdorimi i komunikimit informativ të shifruar nga ana e Ali Pashës, që në pararendje të kësaj disipline komunikimi...

Ali Pasha përdorte kode shifrore

(dhe sistemin e kriptografisë në këmbimet e informacionit)

NGA PROF. DR. IRAKLI KOÇOLLARI

Vijon nga faqja 13

KRIPTOGRAFIA NË KOHËT MODERNE

Ndërsa në fillimin e shekullit të XX për herë të parë puna për hartimin e Shifrës, Kodimit, pra hartimi i teksteve, shkrimeve të krijuara dhe deshifrimi i tyre u kthyen në pjesë të strukturave shtetërore. Institucionet e specializuara për të kryer këto detyra u modernizuan, shpikën mënyra të stërholluara dhe të rafinuara, mjete mekanike dhe elektronike për të fshehur informacionet dhe mesazhet e rëndësishme, por edhe për të parandaluar kurthe që funksiononin përmes mesazheve dhe sinjaleve të pakuptimita, të krijuara.

Në thelbin e saj Kriptografia është një metodologji që nënkupton zëvendësimin e çdo gërme apo fjale në një mesazh të shkruar me të tjera gërma apo numra. Ka dy lloje bazike të shifrës, të emërtuara "Tranzpozicioni" dhe "substitucioni".

Ndryshimi bazik mes Shifrës dhe Kodit qëndron në faktin se një Shifër funksionon mbi bazën e ndërrimit, zëvendësimit të çdo gërme, ndërsa Kodet sekrete ngihen mbi bazën e zëvendësimit të fjalës dhe të frazave.

Shifra e ndërthur mbi bazën e ripozicionimit të gërmave të një fjale në një formë të re, duke krijuar një fjale të pakuptimitë, nënkupton "Tranzpozicionin" si metodë të shifrimit.

Ndërsa zëvendësimi i gërmave të të gjithë fjalës dhe tekstit me të tjera gërma apo numra nënkupton metodologjinë e "Substitucionit" shifror.

KRIPTOGRAFIA, SHIFRA DHE SHKRIMI I KODUAR

NË HISTORINË SHQIPTARE. Ende nuk ka ndonjë studim të thelluar për këtë fushë të veprimitarisë humane në historinë e popullit tonë. Njoftime të shkëputura por ende të paqarta na bëjnë me dije për përdorime sporadike të letrave të krijuara në mesjetë. Megjithatë, asgjë nuk ka të qartë, aq më tepër kërkime të programuara për të verifikuar indicet.

KRIPTOGRAFIA - LETRA DHE INFORMACIONE TË KODUARA NË ARKIVIN E ALI PASHËS

Çuditërisht, askujt nuk i ka tërhequr vëmendjen ekzistenca e një numri letrash dhe informacionesh të koduara në fondin e dokumenteve të "Arkivit të Ali Pashës". Janë gjashtë-shtatë të til-



la. Një pjesë janë informacione të dërguara nga larg, nga Stambolli, ndërsa disa të tjera janë letra të dërguara nga njerëz të besuar, të ngarkuar me misionet të rëndësishme dhe delikate.

Sigurisht, gjithkush do të mendonte se ato janë pak!

Vërtet që ato nuk janë shumë, por nëse do të kemi në konsideratë faktin se dokumentet e gjetura të "Arkivit të Ali Pashës" përbëjnë vetëm një të dhjetën e inventarit të dikurshëm të tij, ai numër do të dhjetëfishohej. Në këto rrethana numri i informacioneve të krijuara që do të kishim në duar do të ishte shumë i madh, aq sa vend zë ai sot në radhën e informacioneve të hapura në jetën e institucioneve të një shteti normal.

(Në Arkivin e Ali Pashës ka edhe dokumente ku letërshtkruesit japin informacione të rëndësishme për veprimtari konspirative të francezëve kundër Ali Pashës, por këto informacione janë të hapura dhe të lexueshme, në rastin e tyre fsihet vetëm identiteti i tij.)

Po a ka pasur dokumente apo informacione të tjera të krijuara në kancelarinë e Ali Pashës?!

Sigurisht që po! Le ti referohemi një informacioni të koduar, dokumentit që mban nr. 343, të "Arkivit të Ali Pashës", Vol. A.

Autori i saj është Dhimitër Razi, një misionar special, i dërguar nga Ali Pasha, për të penetruar në la-

Arkivi i Ali Pashës

Çuditërisht, askujt nuk i ka tërhequr vëmendjen ekzistenca e një numri letrash dhe informacionesh të koduara në fondin e dokumenteve të "Arkivit të Ali Pashës". Janë gjashtë-shtatë të tilla. Një pjesë janë informacione të dërguara nga larg, nga Stambolli, ndërsa disa të tjera janë letra të dërguara nga njerëz të besuar, të ngarkuar me misionet të rëndësishme dhe delikate. Sigurisht, gjithkush do të mendonte se ato janë pak! Vërtet që ato nuk janë shumë, por nëse do të kemi në konsideratë faktin se dokumentet e gjetura të "Arkivit të Ali Pashës" përbëjnë vetëm një të dhjetën e inventarit të dikurshëm të tij, ai numër do të dhjetëfishohej.

birinthe dhe hierarkisë së lartë të Stambolli, dhe për të informuar rreth situatës së brendshme në Portën e Lartë, grupimet, klanet, tendencat politike të hapura dhe të fshehta, kulisat, kurthet, klima favorizuese apo ajo denigruese ndaj Ali Pashës, etj. Dhimitër Razi ka gati dy, tre vite atje dhe ka mundur të krijojë lidhjet dhe miqësitë e tij për të kryer detyrat e ngarkuara nga Ali Pasha.

Përmes informacionit të më-

poshtëm ai i përcjell Ali Pashës njoftimet për përqendrimet e forcave të aleancës anti-angleze në Evropë dhe influencat anti-angleze që shtrihen edhe në politikën e jashtme të Perandorisë Osmane.

Duke folur për qëndrimet e funksionarëve të lartë, në pozicione të ndryshme në hierarkinë osmane, ai veçon Razi Efendiun, i cili dallohet për qëndrimet dashamirëse ndaj Ali Pashës. Letërshtkruesi duke na bërë me dije se Reiz Efendiu është i favorizuar i Sulltanit, insiston pranë Ali Pashës, që ky i fundit "ti shkruajë shpesh dhe ta falënderojë atë për punën e lavdërueshme që ai i bën", fjalë këto që duke i përkthyer nga gjuha e moralit Osman të asaj kohe do të thotë, që - ti dërgojë Reizit shpesh dhurata.

Sekretari i Ali Pashës, Kosta, i cili e ka marrë këtë informacion të dërguar nga Dhimitër Razi, duke pasur që më parë në duart e tij kodin shifror, ka zberthyer informacionin. Fatmirësisht, pasi ka dekoduar letrën e fundit, ai na ka lënë një pjesë të çelësit për dekodimin e informacioneve të mëparshme të krijuara.

INFORMACIONET E KODUARA NË ARKIVIN E ALI PASHËS

Por, cili është konkretisht çelësi, kodit me të cilin Dhimitër Razi ka krijuar informacionet që ai i dërgonte eprorit të tij? Fatmirësisht, një pjesë e grupeve shifrore

që formojnë çelësin e shifrës me të cilin ai ka krijuar informacionet ruhet në fondin dokumentar të Arkivit të Ali Pashës. Sigurisht ky kod shifror ishte në duart e Aliut. Me të sekretari i tij dekodonte informacionet që dërgoheshin nga Stambolli.

Duke pasur atë në duar, nuk është e vështirë që lexuesi i këtij shkrimi të deshifrojë vetë informacionin e krijuar, që ka dërguar misionari për marrëdhëniet me jashtë, (kapoçuhedari) Dhimitër Razi, për Ali Pashën nga Stambolli.

Më poshtë po vendosim grupet shifrore që shërbyen si çelës për dekriptimin e tekstit të dërguar nga Stambolli. Në origjinalin e tij, sikundër do të shihet më poshtë dokumenti ka të shënuar vetëm numra, por duke pasur të ekspozuara grupet shifrore me fjalët analoge bri tyre, nuk është e vështirë të dekriptohet teksti i informacionit.

KODI SHIFROR I DH. RAZIT NË KOMUNIKIMIN ME ALI PASHËN:

- 6
6-14 (nënkuptojnë) Perandori i Francës, Bonoparti
11 - (nënkuptojnë) paqe
23 - (nënkupton) Rusia
1 - (nënkupton) Dovleti, Sulltani
16 - (nënkupton) Duket, Ka të ngjarë, Ka mundësi
22 - (nënkupton) Francezët
21
21-14 - Anglezët, Anglia
3 - (nënkupton) Reiz efendiu
4 - (nënkupton) Shehisلامي
15 - (nënkupton) Thuhet, flitet, ka zëra
33-32- 45-35-48-28-31 - Ambasador; i Ngarkuar me Punë, Konsull

DOKUMENTI ME NR. 343
 Kostandinopoli, 8 Dhjetor 1807

Sekretarit fisnik, zotit Kosta.
 Letra a.

Nga njëshi gjer tek gjashta letrat e mija mbërrijnë me numra që të mos humbasë asnjë. Shpresoj që përpara kësaj more dy letrat e tjera të miat, njëra e pa shifruar dhe tjetra e shifruar, ... përmes të cilave do të bëja me dije haberet e Europës.

Kështu pra meqë fillova tani do të shkruaj me shifër, dua që të më përgjigjeni kur ta merrni, domethënë të më shkruani se - e mora letrën "a", ose - e mora letrën "b" dhe "g", me qëllim që edhe unë të qetësohem. Para së gjithash të kini kujdes sekretarin të mos bëjë të njohura informacionet një ditë pasi të kenë ardhur korrierët dhe



...NGA NUMRI I SHKUAR

"Milosao" e këtij numri kishte një shkrim shumë të këndshëm të Martin Camaj, që na ishte përcjellë prej profesor Bardhyl Demiraj, me skrupulozitetin e tij organik. Shkrimi që profesori i nderuar e kishte marrë prej arkivit personal të Martin Camaj (Lenggries/BRD) ishte në dorëshkrim dhe aty ndër të tjera gjendej edhe një material i lënë në dorëshkrim, si përpunim i shënimeve të dikurshme për një intervistë, dhënë "Zërit të Amerikës" në gjuhë të vet. Materiali i padaturar rezultoi të jetë përfunduar si i tillë pas vizitës së fundit të autorit në Kosovë në gusht të vitit 1990. "Këto shënime përcjellin natyrshëm jo vetëm kandin e stilit të thukët të shkrimtarit tonë të madh në rolin e kritikut letrar të spikatur, por edhe atë angazhim intensiv intelektual e

social në vazhdimësi që karakterizoi mërgatën e tërë politike shqiptare përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Po ia përcjellim lexuesit këtë material me lejen e zonjës Dr. med. Erika Camaj e me dëshirën e mirë që ta ngjrojë këtë perlë të mendimit kritik letrar shqiptar, duke përjetuar natyrshëm forcën e gjykim-it

dhe fuqinë sintetizuese të autorit në përsiatjen e atyre proceseve konvergujes dhe divergujes që përjeton letërsia shqiptare në kohë e hapësirë..., shkroi profesor Demiraj.

Dukej pak si ironi, por në fakt, nuk ishte e tillë vënja përbri e vazhdimet të shkrimit të Çuckës për Dritëro Agollin, një shkrimtar me një qasje krejt tjetër dhe krejt ndryshe nga Camaj, me marrëdhënie shumë të mirë me sistemin. I ndjeri Dritëro, as në të

gjallë, se ka pasur këtë shkrim kilometrik, që po i dedikon një nga adhuruesit e tij Çuça.

Luan Rama, publicisti dhe shkrimtari i njohur, që tashmë jeton në Paris na kish sjellë një tregim të gjatë, ku vihej re trajtesa e tij, që kishte dimensionin kohor të kapërcyellit të dy sistemeve, por gjithnjë të futur në një aspekt disi historik-filozofik, që i shkon shumë ... Redaktori shtoi një shënimin e vet për librin "Letra grues seme të vdekun" të inxhinierit Gjovalin Gjadrit dhe që shkoi se: *në një farë mase, e mendojmë se ky libër shërben edhe si një domazh për intelektualët shqiptarë dhe ndjenjat e tyre, por edhe atë shkallë të lartë emancipimi dhe kultivimi ndjenjash që arritën të kishin paralufte. Inxhinieri i shquar shqiptar ka një prekje të lartë humane dhe*

koncepte mirëfilli estetike dhe filozofike, që i dalin thjesht edhe pa asnjë sforcim nga pena e tij e dhimbur drejtuar të ndjerës bashkëshortes së tij...

Kurse poeti i njohur Faslli Haliti na solli Vladimir Vladimiroviç Majakovskijn me një poemë të tij monumentale, por disi patetike, të kuptueshme për kohën. Poeti i njohur ka të ngjarë ta ketë përkthyer nga italishtja dhe mendojmë se do jetë përballur me vështirësinë e gjuhës së tretë, gjëra që ai i ka kuruar me mjeshtërinë e tij poetike, por do të donim tingullin e vërtetë të poemës...Numri ishte relativisht i mirë, por si pak me sepjen e gjysmës së shekullit të shkuar prej vjetërsisë së tematikës. Layot punoi pak më mirë, por krejt i ndierent me materialin.

kështu mund tu shkruaj vazhdimisht.

Nga posta mësojmë se - 6 - marsi i sigurt në Paris ditën e Krish-tlindjes franceze me qëllim që të organizojë një manifestim të cilën e kishte paramenduar, gjykuar, studiuar, dhe që të përfundojë edhe - 11 - mes - 23 - dhe - 1 - por - 16 - se - 22 - kanë gjëra të tjera në mendjen e tyre, që të vonojnë - 11 - dhe ndërkohë duket se pak duan që të avancojë - 6 - tanimë qëllimi i tyre është ti shpallin luftë - 21 - 14 - Anglisë dhe gjithë mbretëritë të Europës.

[paragrafi a]

Sikundër mësojmë përmes postës Gjermania, Rusia, Zvicra, Danimarka dhe Portugalia i shpallën luftë - 21-14 (Anglezët). Kështu në të gjithë Europën nuk mbeti asnjë port që të pranojë -21-14 (Anglezët) e për pasojë ata nuk kanë më asnjë vend ku mund të shesin mallrat e tyre, dhe nuk mjaftoi vetëm Europa kundër tyre por edhe Amerika tanimë u ka shpallur luftë. Ata që janë duke studiuar këtë situatë tani janë - 23 (rusët) me - 6 - 14 - (Franca dhe Bonoparti).

- 3 (Reiz Efendi) u përballet me shume vështirësi dhe siklete për çështjen tënde.

- 4 (Shehisلامي) nuk - 16 (duket) të jetë shumë mik i yti, të përgafon por - 15 (thuhet se) pak përpiqet dhe pak të shërben.

Saliagai ka shumë miqësi me kajmekanin dhe po organizon të marrë grohët kur të korë grurin aty ku i merr edhe efendiun ynë, nga taksa!, dhe kërkon të marrë edhe muktanë ... për të ardhmen.

[paragrafi b] (Teksti është de-shifruar nga ana e jonë)

33-32- 45-35-48-28-31 - (ambasadori) i - 22 - (Francës) nuk sillet mirë me Portën e Lartë dhe - 16 - (duket) se - 1 - (Sulltani) i ka shkruar - 6 - (Bonoparti) që ta zvendësojë. Por, le ta dijë (Ali Pasha- IK) edhe faktin se -1- (Sulltani) e ka shumë në konsideratë dhe e vlerëson - 3 - (Reiz efendiun) dhe çdo ditë "korispondëri" me të fshehurazi, përmes mjekut të tij. Këtë gjë e dinë shumë miq tanët, si dhe mënyrën që ai përdor për të qenë këshilltar i tij dhe kështu ai nuk hedh asnjë hap pa pyetur atë.

Prandaj i thuaj Efendiut tonë (Ali Pashës- IK) që ti shkruaj shpesh dhe ta falënderoj për lavdërimet që ai i bën efendiut tonë, dhe që jep garanci nga një njeri i sigurt dhe i besuar, pasi ai - 3 - (Sulltani) ka për të qëndruar gjatë në

Komunikimi shifror tek Ali Pasha

Ndonëse organizimi i komunikimit informativ të shifruar, tek Ali Pashës me njerëzit e ngarkuar me misionet të rëndësishme dhe delikate, duket se ishte në fazat e tij të para, ai ka një rëndësi të të veçantë për disa arsye.

Së pari sepse vetë Europa filloi të institucionalizojë këtë mënyrë komunikimi aty nga fillimet e shekullit të XIX. Hartimi i kodeve shifrorë dhe përdorimi i tyre nga ana e Vezirit të Janinës, padyshim e rendit këtë monark në radhën e pionerëve pararendës evropianë në fushën e komunikimeve sekrete, por edhe për historinë e vendit tonë zbulon një traditë të hershme të panjohur gjër më tani.



postin e tij.

Pres përgjigje sa më parë, i njohuri.

Në Dhjetor, Stamboll.

Shpresoj në kërkesën që ju bëra në letërën e kaluar të mos e nxirri jashtë por të mbetet veç mes nesh.


TË TJERA INFORMACIONE TË KRIPTUARA NË ARKIVIN E ALI PASHËS

Sikundër shihet, në krye të kësaj letre, autori, pyet letërmarrësin, Kostën, sekretarin e Ali Pashës, nëse e mori letërën e mëparshme të koduar!

Nënteksti është fare i qartë, misionari special i Ali Pashës ka korresponduar edhe herë të tjera

më përpara dhe më pas me eprorin e tij, përmes kriptografisë. Jo vetëm kaq, por Dhimitri ka dërguar porosi edhe për mënyrën dhe kohën se si dhe kur duhet të konsumohet informacioni, me qëllim që të garantohej siguria e burimit që të dërgonte këto informacione. Fatqegjësisht, koha cikll i Informacioneve të koduara të Dhimitër Razit, në Arkivin e Ali Pashës ruhen vetëm dy dokumente.

Por, po në këtë "Arkiv", gjenden edhe disa informacione të tjera të dërguara Ali Pashës nga njërës të besuar të tij, që kanë pasur një rol të rëndësishëm në ngjarjet e kohës. Mes tyre renditet të paktën një in-



formacion i koduar, dërguar nga Hasan Çapari. Ky njeri me emër dhe influencë, në radhët e parisë dhe fisnikërisë së Çamërisë, biri i së cilit ishte peng në oborrin e Ali Pashës, e informonte Vezirin për zhvillimet politike në ato anë, ndërhyrjet dhe veprimtarinë konspirative të francezëve, rebelimet dhe provokimet e suljotëve, praninë e rusëve dhe intrigat për konflikte kundër pashait, etj.

Duke qenë në situatat e një kontrolli dhe kërcënimi permanent, Çapari ka dërguar informacione të koduara, përmes një kodi shifror mjaft interesant, që ndoshta në një të ardhme do të donte një hulumtim shkencor më të detajuar. Ky kod fatmirësisht ruhet në një nga dokumentet e Arkivit. Përmes tij është zbrëthyer informacioni që mban numrin 294 dhe që e sjellim të tillë për lexuesin.

Informacioni i shkruar nga Hasan Çapari është i gjatë dhe mjaft interesant, por në rendisim më poshtë vetëm një fragment të dekoduar të tij.

Kodi i përdorur për kriptimin e informacionit në komunikimin e Hasan Çaparit me Ali Pashën është si më poshtë:

mbrojnë vendin gjer tek Spianxha dhe Abdyli Qerimi të vijë shpejt me asprat (paratë). S'kam tjetër për të shkruar.

Të puthim dhe Shëndielën që të mos na bëjnë ndonjë rengë para se të mbyllim punët, dhe për sanxhakun tonë të dërgosh edhe forca të tjera që të bjerë në qetësi; dhe skam tjetër.

Hasan Capari

(d.v)

ti dorëzohet duarve të ndershme të Metit, djalit të Hasan Caparit, në Janinë.

SHIFRA DHE KRIPTOGRAFIA: INSTITUCION I NGRITJES DHE MATURIMIT TË NJË SHTETI

Ndonëse organizimi i komunikimit informativ të shifruar, tek Ali Pashës me njerëzit e ngarkuar me misionet të rëndësishme dhe delikate, duket se ishte në fazat e tij të para, ai ka një rëndësi të të veçantë për disa arsye.

Së pari sepse vetë Europa filloi të institucionalizojë këtë mënyrë komunikimi aty nga fillimet e shekullit të XIX. Hartimi i kodeve shifrorë dhe përdorimi i tyre nga ana e Vezirit të Janinës, padyshim e rendit këtë monark në radhën e pionerëve pararendës evropianë në fushën e komunikimeve sekrete, por edhe për historinë e vendit tonë zbulon një traditë të hershme të panjohur gjër më tani.

Së dyti aplikimi i këtij instrumenti, dhe institucioni njëkohësisht, kodeve dhe shifrës në punët me informacionin, vlerësohet si tregues sinjifikativ i pjekurisë së një shteti në konsolidim. Ai është pasqyrë e ndërgjegjësimit për vlerësimin dhe ruajtjen e sekretit, si kusht dhe nevojë për fuqinë, sigurinë dhe independencën e një vendi.

Përdorimi i këtij instrumenti nga strukturat e shtetit të Ali Pashës vjen dhe reflekton pikërisht këtë, përpjekjet e tij drejt shkëputjes definitive nga Porta e Lartë. Kjo ndërmarrje në thelbin e saj është shenjë e pjekurisë dhe e maturimit për shtetformim, që së bashku me përpjekjet për realizimin e një politike të jashtëm independente; zgjerimet e fuqisë territoriale dhe asaj ushtarake pa miratimin e Portës së Lartë; përpjekjeve për të realizuar aleancë të fshehta ushtarake, jashtë synimeve dhe interesave të Perandorisë Osmane; braktisja e detyrimeve fiskale ndaj Stambollit, etj., plotësojnë projektin e një prognoze që Veziri Tepelenas kishte për një shtet të mëvhtësuar dhe Sovran.



T
AUTOR

Pak si e tepruar nga komiteti përzgjedhës i "Ballkanika", që nuk vendosi për poeten tonë Lleshanaku. Megjithatë, larg të gjithë vlerësimeve në Ballkan dhe kudo, ajo po trason një rrugë të gjatë dhe duket me shumë bazament, një të tillë udhë që do t'i shërbejë në të ardhmen dhe autorëve tanë. Për fat, është nga autoret e brezit të saj në Evropën Lindore me më shumë përcjellje në tregun e madh të letërsisë anglo-amerikane...

LULJETA LLESHANAKU

“Më tërheqin historitë e mbijetesës, sepse ato e vënë njeriun para sfidave”

Intervista për "Milosaon" është bërë në fillimjavë. Luljeta Lleshanaku është një nga penat më të njohura shqiptare të dekadave të fundit e ndoshta me përcjelljen më prestigjioze ndërkombëtare të këtyre viteve. Ajo rrëfen aspekte teknike të krijimtarisë së saj. Do të kishim dëshirë në të ardhmen, që të kishim një intervistë të stërgjatë me autoren, që i ka dhënë aq shumë letërsisë shqiptare...

INTERVISTOI BEN ANDONI

Ndjenja më e mirë, kur largohesh nga takimi me një shkrimtar, është që të bëjë të mendosh. Dhe, më e adhurueshmja, që të kesh dëshirë ta ritakosh. Luljeta Lleshanaku t'i jep të dyja këto mundësi. Kuptohet, nëse do të dish të bësh një bisedë pa kurthet e zakonshme për të kapur gjëra sipërfaqësore, që sot bëjnë lajmin; nëse do të dish të kapësh telat dhe mbi të gjitha duke ditur të futesh në thelbesitë e jetës.

Luljeta Lleshanaku ka një formim të mirë, fryt i studimeve në institucione arsimore me reputacion anglo-sakson dhe mbi të gjitha sensin për të bërë sinteza të drejta dhe të qarta të mendimeve. Kjo duket në letërsinë e saj por edhe në artikullimet jo të shpeshta në median shqiptare, tashmë mbushur me lloj-lloj kinsesh.

Autorja jonë asnjëherë nuk i jep të drejtë vetes për të shkruar atje ku nuk di. Ka një postulat krijimtarie, që duket se i përcakton disa vije krijimtarie: "Letërsia është një meditim për jetën, por bazuar mbi përvojën personale; thjesht trego atë që di. Tani, fjala vjen, do të doja shumë të kisha qenë në njërin prej atyre anijeve të eksodit të vitit 1991 në të cilën ndodhej një pjesë e familjes sime, për ta rrëfyer në një roman, por nuk kam qenë, dhe e kam të vështirë të improvizoj me imagjinatë atë që ndodhi aty". Për fat, në këtë intervistë, ajo ka zbardhur edhe disa nga identitetet me të cilat përballet. Një nga këto tema, që zbulohet rrallë në autorët tanë, të cilët u duhet të punojnë duke e modifikuar stilin dhe natyrën, thjesht për t'u bërë të kënaqshëm dhe të asimilueshëm për publikun. Krejt ndryshe, ajo tregon hapur identitete me të cilat përballet në krijimtarinë e saj. Nga ana tjetër, ajo na rrëfen edhe një ekuilibër shumë delikat, që ka lidhje me përpjekjen për të mos rënë në moralizëm dhe në filozofinë boshe. "Nëse ia kam dalë, besoj se ka të bëjë me zgjedhjen e imazhit si mjet shprehës. Mjeshtëria është të dish të zgjedhësh subjektin, detajet, gjestet, të cilat flasin vetë; përndryshe rrezikon të përfundosh në koment ose deklamim. Them se më ka ndihmuar shumë filmi, piktura, fotografia, për abstragimin përmes imazhit", shprehet ajo.

Procesi i mendimit ka të ngjyer formimin, natyrën individuale, subkoshencën dhe trashëgiminë mentale-psikologjike. Si harmonizohen këto të ju në procesin e krijimit?

"Të gjitha këto që ju përmendët më sipër përcaktojnë ndjeshmërinë artistike: për çfarë ia vlen të shkruhet dhe për çfarë jo, nga cili kënd vështrimi, si do të shkruhet dhe si domosdoshmërisht kërkohet të thuashe më. Unë jam shumë e tërhequr nga historia, sepse historia flet vetë. Më

tërheq edhe mikrokozmosi, botët e vogla, njerëzit e zakonshëm, provinca me grimasat e saj të qarta sepse jam rritur në një të tillë. Jam e tërhequr nga tema ekzistenciale, sepse kjo është mënyra më e mirë apo ndoshta e vetmja për të mos ngecur në histori dhe për të dhënë patjetër një kuptim gjithë atij absurditeti që ndodhi në komunizëm, i cili është pjesë e historisë sime po aq sa edhe shumë të tjerëve. Fjala vjen, në librin për të cilin po flasim, ka një poemë të gjatë që quhet "Ujë dhe karbon", e cila është e vetmja në të gjithë krijimtarinë time ku unë flas drejtpërdrejt për dramën e komunizmit, por si një përplasje midis shpjegimit materialist të botës dhe atij idealist. Çfarë është njeriu: një grup qelizash prej uji dhe karboni apo një genie morale? Uria, torturat, presioni psikologjik, denigrimi, si mjete të përdorura në masë në komunizëm për të nënshtruar njeriun, janë eksperimente që vërtetuan njërin apo tjetrin? Pra, kam syn-



Luljeta Lleshanaku

uar të shkoj përtej dëshmisë, për t'i dhënë vetes doemos një shpjegim. Nga ana tjetër, edhe politika më tërheq sepse atje ku jam rritur unë, flitej vetëm për politikë; më pëlqen ta vëzhgoj nga larg si një lojë shahu, por kur bëhet fjalë tamam për politikë.

Letërsia është një meditim për

natë atë që ndodhi aty".

Cilat janë identitetet që përbal Luljeta Lleshanaku, kur krijon?

"I pari është identiteti im si shqiptare, që është edhe dominuesi. Besoj se në shoqëri time projektoret qartë gjithë ai peizazh natyror dhe politiko-social tipik shqiptar. Përvoja personale dhe ajo kolektive bëhen një.

Identiteti i dytë është ai gjinor: Nuk jam e vetëdijshme se sa perceptohet kjo nga jashtë, por besoj se ka poezi si ato të cilat "Vesperat sicilianë" apo poezia "Kusht për t'u mbajtur mend", të cilat nuk mund të shkruhenin nga një këndvështrim mashkullor. Dhe identiteti femëror jo doemos ka të bëjë me feminizmin. Gratë që unë përfshij në librat e mi janë modelle grave në mes të cilave jam rritur: kokëulëta, të mençura, të forta dhe të sakrificës, gra që dinin të përdornin edhe armën po të dilte nevra, gra që mbanin familjen dhe buronë në burg pa u ankuar asnjëherë, gra të cilat megjithëse fati u kishte hyrë në hak aq sa nuk bëhej, i edukonin fëmijët: "Jeto me nder dhe mos i hyj kujt në hak!".

Identiteti tjetër është ai i njeriut që ka qenë viktimë e një sistemi. Është e pamundur të provosh padrejtesinë njerëzore që i vogël, dhe të mos kesh një ndjeshmëri krejt tjetër për botën. Unë nuk po e quaj identitet politik, sepse diktaturat nuk janë punë bindjesh politike, as komunizmi nuk qe i tillë; ai qe një regjim banditesk, abuzimi më i madh i njeriut mbi njeriun, që asnjë bindje politike nuk e justifikon. Ky lloj identiteti, shfaqet më tepër në formën e një qëndrimi emocional ndaj të mirës dhe të keqes, por edhe më nxit pafundësisht drejt kërkimit të thelbit të natyrës njerëzore.

Identiteti tjetër: është ai i krijuar nga njohja dhe përballja me kulturën të tjerë. Ky nuk është asnjëherë i dukshëm; ai përbën një lloj vetëdijshëri mbi atë që je, mbi vendin nga vjen, dhe të ndihmon në qartësimin dhe një këndvështrim më objektiv për gjërat. E thënë ndryshe, ky lloj "uni", të jep një pikë në hapësirë nga mund të shohësh veten dhe gjithçka tjetër që lidhet me ty në një distance më racionale dhe analitike".

Luljeta LLESHANAKU

Luljeta Lleshanaku ka lindur në Elbasan. Ajo studioi në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Departamentin e Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Tiranës dhe më vonë ndoqi Programin e MPJ në Warren Wilson College, SHBA. Pas këtij viti ajo ka ndjekur disa shkallë formimi në Universitetin e Iowa më 1999 dhe pati një bursë nga Instituti Black Mountain në Universitetin e Nevadas, Las Vegas në 2008-2009.

Ajo është autore e tetë vëllimeve me poezi në Shqipëri, që janë Sytë e somnabulës, 1994; Kambanat e së dielës, 1995; Gjysëm-kubizëm, 1997; Antipastorale, 1999; Palca e verdhë, 2002; Fëmijët e natyrës, 2006; Pothuajse dje, 2012; Homo-Antarktikus dhe nëntë librave të tjerë të botuar në gjuhë të huaja, si *Haywire*; *New & Selected Poems* (Bloodaxe Books, London, 2011), *Fresco* (New Di-

rections, USA, 2002), *Child of nature* (New Directions, USA, 2010), *Kinder der Natur* (Edition Korrespondenzen, Austria, 2010), *Dzieci natury* (Stowo / Terytoria, Poland, 2011), *Antipastorale* (LietoColle, Italy 2006), *Ponedjeljak u sedam dana* (Verzopolis edicija, Zagreb, 2015), *Lunes en Siete Dias* (Olifante, Spain, 2017) and *Pondelok v siedmich d-och* (Obèianske zdruenie VLNA, Slovakia, 2017). Negative space, një përmbledhje e re në gjuhën angleze do të botohet në Pranverën 2018 nga dy shtëpi botuese: New Directions in USA dhe Bloodaxe Books in UK. Poezitë e saj janë përkthyer dhe botuar në antologji dhe revista letrare në shumë gjuhë.

Ajo është fituesja e PEN Albania 2016 (nga Qendra Shqiptare Pen), Çmimi Kombëtar "Pena e Argjendë, 2000" për poezi dhe Çmimi Ndërkombëtar Kristal Vilenica (Festivali Ndërkombëtar i Letërsisë, Slloveni 2009). Ajo është një nga fituesit e Panairit të Lib-

rit në Prishtinë, 2013 (Kosovë); fituese e çmimit KULT, 2013 në Shqipëri për librin më të mirë të vitit dhe iu dha çmimi "Autori i vitit" nga Shoqata e Botuesve të Panairit të Librit të Tiranës, 2013.

Përmbledhja e saj e dytë në Amerikë, Fëmija i Natyrës, ishte një nga finalistët e poezisë më të mirë të Translated Book Award të vitit 2011 kurse përmbledhja e saj britanike Haywire: New & Poems Selected u listua për "Çmimin Popesku 2013" (më parë Çmimi Europian i Poezisë) nga shoqata e poetëve të Mbrretërisë së Bashkuar. Në vitin 2012 ajo ishte finaliste në Poloni për çmimin evropian të poezisë "Poeti Evropian i Lirisë".

Prej katër vitesh, ajo drejton serinë e workshop-eve në shkrimin krijues në Shqipëri të quajtur "SABBAT", i cili është një projekt i mbështetur nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë.



A u krijua "Homo Antarciticus" edhe si një thirrje për ta nxjerrë njeriun e kohës së sotme nga ngrirja e madhe që e rrethton?

"Unë jam shumë e tërhequr nga historitë e mbijetesës, sepse flasin për rrethana ekstreme të cilat e vënë njeriun para një prove të jashtëzakonshme morale. Janë pikërisht këto situata që prodhojnë heronj, dhe të nxisin respektin për njeriun. Dhe ne, sidomos në këtë krizë morale që jemi në ditët e sotme, e kemi më të nevojshëm se oksigjenin frymëzimin nga njeriu, besimin tek njeriu, përndryshe çfarë kuptimi ka?"

Një histori e tillë mbijetesë, është edhe ajo e ekspeditës së Shakëlltonit në Polin e Jugut, të cilës i referohem në poemën "Homo Antarciticus". Por nuk merrem me historinë në vetvete, por me atë që ndodhi më pas, duke shtruar çështjen: si është e mundur që pikërisht ata njerëz të cilët ia dolën me sukses t'i mbijetojnë akullit, urisë, dhe depresionit të Antarktidës për dy vjet, kur u kthyen në qytetërim, dështuan? Pra, vetë po ma vë një pikëpyetje të madhe mbi vetë natyrën e civilizimit. "E çfarë di një mbijetuar/ për artin e të jetuarit./ku nevojiten të tjera instikte.?", janë dy nga vargjet e poemës. Sfida e njeriut modern duket shumë herë më e vështirë se sfida e njeriut primitiv. Dhe jo më kot gjedh zgjedh Frenk Uajldin si protagonist të poemës, një burrë i prerë, i zgjuar, enigmatik, fjalëpakë, heroin në hije, krahun e djathtë të Shakëlltonit dhe jo vetë Shakëlltonin. Në shogëri ka edhe njerëz të tillë, që dinë ta luajnë mrekullisht rolin e tyre pa marrë protagonizëm, duke kapërcyer mbi egonin e tyre, në emër të asaj që quhet detyrë ose besnikëri. Megjithatë ra fjala, sa herë na ka ndodhur dekadat e fundit të dëgjojmë të thuhet "burrë i mirë", ose "njeri besnik"? Me sa duket besnikëria, miqësia, nuk janë më një virtut".

Si e përball në vetvete ekuilibrin që të mos blesh në moralizëm apo në filozofi, por të krijosh poezi?

"Pyetje e drejtë; është një ekuilibër shumë delikat. Nëse ia kam dalë, besoj se ka të bëjë me zgjedhjen e imazhit si mjet shprehës. Mjeshtëria është të dish të zgjedhësh subjektin, detajet, gjetet, të cilat flasin vetë; përndryshe rreziqon të përfundosh në koment ose deklamim. Them se më ka ndihmuar shumë filmi, piktura, fotografia, për abstragimin përmes imazhit. Prej tyre, mësova të luaj me pjesën e dukshme të gjërave, me atë që shihet, se siç thotë Oskar Uajldi, misteri qëndron tek gjërat që shihen, dhe jo tek ato që nuk shihen. Ti mund të krijosh një informacion shumë të saktë mbi një person vetëm duke i nisur vetëm nga gjetet e vogla, ato më të parëndësishmet, ose detajet. Ndoshta kjo është edhe arsyeja që të kërkojnë të paraqitesh fizikisht për një intervistë pune.

Futja e dialogut si element, përdorimi i stilit bisedimor, është një mënyrë tjetër për të eliminuar këto që thonë ju por edhe për ta bërë sa më vital e të besueshëm tekstin.

Përveç të tjerash, organizimi i argumentit përmes imazhit krijon më shumë se një mënyrë interpretimi, duke i dhënë shumë më tepër hapësirë lexuesit, ose duke e bërë bashkëkrijues".

P

POEMA

NGA VLADIMIR MAJAKOVSKI*

4.
Eh!
Ju!
Topitni sytë entuziast!
Hiqni nga xhepi barkat e duarve!
Ky është shpërblimi i denjë që u shtrydh nga letra dhe nga boja.

Por përse të më duartroklini?
Unë asgjë s'kam kompozuar.

Mendoni: gënjeni!
Në asnjë vend s'është shpuar.
Nuk ka pse të rregullohet rrahja e tëmthave, nëse rrahin duart për trillin e tij të timpaneve, për trillin e rimuar të mallkimeve të tij.

Zotërinj të shtrenjtë!
E kuptoni?
Ti merr dhimbjen dhe e kultivon, e kultivon: një gjoks i shpuar nga të gjitha shtizat, një fytyrë e kthyer sa andej-ketej nga të gjitha veshtrimet, keshljella e kokës e rrahur nga të gjitha artileritë: është kjo çdo strofë imja.

Nuk u ngrit mbi barriera trupash, që i pikëlluar të pikoja një poshtërsi e përutor: nga pesha e tmerrshme e gjithçkaje të asaj që u bë, pa të gjitha ato «bukur», një poshtërsi.

U vranë: po pak më intereson që unë ose ai t'i kemi vranë, Në varrezën vëllazërore, brenda gropës së zemrës miliona u shtrinë aly: kalben, lëvizin, ngrihen nga krimbat.

Jo!
Jo me vargjet!
Më mirë
Po e bëj një gjuhën sesa të flas.

Kjo nuk mund të thuhet në vargje. A mundet vallë me gjuhën e matur të poetit të lëpish thëngjij inkandeshentë?

Kjo që kam ndër duart Shikonit!
Kjo nuk është lira për jut Shqyter nga pendimi, e shkula zemrën: shkul damarët!

Mos tundni duart në persheshin e duartrokllive!
Jo!
Mos i tundni! Shembu, qetësi e dhomave! Shikoni, nën këmbët një gur. Jam drejt mbi trekëmbësh Me gllënjat e fundit ajrin...

Do të derdhem, i shembur, por me gjak do të brej emrin «vrasës» damkosur mbi njeriun.

Vladimir Vladimiroviç Majakovskij është një nga autorët më të njohur rusë të dekadave të para të shekullit XX. Ai ishte poet, dramaturg, regjisor teatri, aktor, artist e gazetar sovjetik, bardi i Revolucionit të madh Rus. Ai është i përkthyer nga disa poetë shqiptarë dhe madje ka qenë frymëzues për shumë syresh...

LUFTA DHE UNIVERSI

Dëgjoni!
Për mua,
i verbrë Vij,
epoka bërët:
«Ngrini,
Ngrimëni
qepallat e shekujve!»

Universi ende do të lulezohje
i hareshëm,
i ri.
Që prapa të mos ketë gjer dhe një gjenështër
absurde,
rrefej:
unë
vetëm jam fajtor
i çdo kërcëllime në rritje të atij që u thye nga jeta!

Dëgjoni:
dielli shpërndau rrezet e para,
pa e ditur ende,
ku,
me të mbaruar puna, do të ndiqet:
jam unë,
Majakovski,
që piedestali të idolit
i solla
femijën kokëprerë.

Falmëni!
Duke futur
te kristianët dallat e dhembëve,
luanët lëshuan një hungërimë.
Mendoni se Neroni?
Isha unë,
Vladimir
Majakovski
që cirkun mbëshillija me një sy të dehur.

Falmëni!
Krishti u ngjall.
Gërsheuat
në një dashuri të vetme
buzë me buzë, ju:
Majakovski
heretikëve
në nëntoken e Sevillas
me kavalet u përdridhte kokcat.

Më falni,
falmëni!
Ditë!
Zvarrituri jashtë
nga kasollet e viteve!
Si një bisht tymues për shekuj tërheq
kërdinë puçlake prej zjarresh!

Erdhi.
Sot
jo gjermani,
jo rusi,
jo turku:
unë
vetë,
duke rrëpur të gjallin,
gëlltis mishin e botës.
Si skelete mbi bajoneta kontinentet.
Oyletet janë sisa prej argjili.

Gjakt!
Cirko nga lumi yt
qoftë edhe një pike,
per të cilën të mos jem fajtor unë!

Por asgjë!
Ky
i burgosur,
me sytë e nxjerrë,
mban vülen time.
Unë,
që gjunjët kam dërrmuar në kulet,

kam brejtur me uri tokat e Gjermanisë.
Hedh krelat kuqërreme të zjarreve.
Drejtoj qimen si një ujë nga errësira e gropave.
Njerez!
Të dashurit e mi
për Krisht,
për dashurinë e Krishtit
falmëni!

Jo,
nuk do ta ngre
fytyrën e deformuar nga ankthil
Midis të gjithëve me i mallkuari,
ballin do të godas në pendim
deri sa s'do të çahet!

Çohuni,
ju që u mundet nga gjenështër,
zhehanë të gjymtuar
nga luftrat e viteve!
Gëzohuni!
Ndeshkohet vetë
i vetmi kanibal.

Jo,
nuk është trimimi i shkathët i një të dënuarit!
Nëse nga trekëmbëshi nuk do të mbledh pjesët
e shqytera,
aq me ben,
unë kam derdhur krejt veten time,
i vetmi i denjë
për të marrë pjesë në ditët e reja.
Do të shtrihem i mundur,
dhe s'do të jetë kush aty,
asnjë që mund të mudojë njeriun.
Njerezit do të lindin,
si njerëz të vërtetë,
më të mirë e më të mëshirshëm se vetë Zoti.

5.
Por mbase
më mbeten me
ngjyra
në kohën kamaleonase?
Do të përdridhet ende
e do të bjerë pastaj,
pa frymë, e ngathët.
Mbase,
trullorur prej tymit dhe betejave,
toka s'do ta ngrejë më kokën kurrë?

Mbase...
Jo, s'mund të jetë kështu!
Një ditë mbase, shijella e mendimeve do të
bëhet kristal,
Një ditë mbase do të shohë purpurin të shpërthejë
nga trupat.
Mbi flokët e kreshpëruar do të verë duart
Do të ofshaje:
«Çfarë bëra kështu,
Zoti».
Jo,
s'mund të jetë!
Gjoks,
shembe ortekun e dëshpërimet.
Rëmo në lumturinë e ardhme.
Ja,
nëse doni
nga syri i majtë
do të nxjerr
një korije me lule!
Shumoni zogjtë e çuditshëm të mendimeve.
Koke,
shyhu prapa krenare dhe entuziaste.
Truri im,
plot gjallëri dhe inteligjencë konstruktive,
nderto qytete!

Tek të gjithë ato
që dhembet ende
nuk kanë shtrënguar me urrejtje,
shkoj

në agim të syve të mi vetues!
Tokë,
çohu
në mija Liazarë të zbukuruar
me veladonë xixëllues
Dhe gëzim,
lumturil!
Nepërmjet valtrave
unë shoh
fytyra të ndriçura.
Ja,
me tu hapur syri i topitur,
më parë
do të cohët Galicia.
Rrotulloi në bar ijen e shqyer.

Hidhi tej dengjet e topave,
thinjat e përgjakura duke larë në qiell,
u drejtuan gungaçet
Alpe,
Balkani,
Kaukazi,
Karpatat.

Por akoma më të lartë
dy gjigante
u ngritën.
Njëri ngre trupin e artë
dhe lutet:
«Eja me afer!
Tek ty do të vij nga krevati im i shkallmuar nga
bombat».
Është Rini
që lëpin me buzët e njomura
kokën e Danubit lëruar nga torpedinierët.

Gjer në kolonitë, vraponi prapa murit kinez,
gjer në rërat, brenda të cilave Persia
ka humbur çdo qytet
me ulurimë
duke thihur si ajër vdekjen,
tani shkëlqente.

Mërmëritje.
Tërë loka
hapi buzët e zeza.
Më fort.
Me hungurimën e uraganit
zien:
«Bethohuni,
që s'do të do të koslini më asnjë!»
Ja u ngriten nga pirgjet e gurëve të varrit
eshtrat e varrosura që rivishen me mish.

Ndodhi
që kembët e prera
të kërkonin
të zotët,
që kokat e shqitura, me emër t'i thërrisnin?
Ja
krceru mbi kafkën
skalpi i rrëpur,
kembët renden të gjalla,
nën të.

Nga fundi i oqeanëve dhe deteve,
mbi shtizen e flamurit,
u dukën pirgjet të mbyturish të rikthyer në jetë.
Diell!
Ngrohi mbi pellembët e tua,
lëpji sytë e tyre me gjuhën e rrezeve!
Mbi fytyrën tendë të plakur
kohë
qeshim!
Shëndoshë e të pa cënuar do të kthehemi në
familje!
Atëherë,
mbi rusët,
bullgarët,
gjermanët,
hebrenjtë,
mbi të gjithë,
në kupën e quejve,
perskuqur nga zjarret,

P

POEZIA

NGA MOIKOM ZEQU

Sa zogji!
Në duart e ajrit!
Por unë bëj vijat e Fatit
Në pëllemën e Hënës!

Si me lekurë tigri
Eshhtë flutura e brishtë!
Kush i thith këto fillade
Me bronket e zambakeve?

...

Pasvdekja,
Eshhtë si një lojë me lelra,
Të vdekurit s'do të punojnë
Kurrë më!

Nuk e di sekretin
Për t'u bërë statujë mermeri,
Po pse do të më duhet
Një identitet i rreme?

Si t'i gdhend këto çaste
Në filigrane kujtese?
Dita ime e fundit,
Qoftë Post Scriptum për të gjithë ju!

Rrethuar jam në bjeshtë
Me fabula të frikshme guri,
Ca studente antiklobaliste
Më thonë: " - Ke humbur adresën!"

Dhe jam njeri i dyzuar
Me ca metafora në ajër
Si fotografi delikate
Me celuloidin e filmi!

Ç'është ky Mollok, me sytë
Si mijra dritare qorre?
Pse Amëshimi është kaq i habitur
Nga kjo milingonë e vockel?

Te lulekuqet e porsambira
Rri i molshëm malli i Serembes.
Pse mua më grish një subjekt
Si Ziona Mistike?

A ka drurë dhe shkembjenj
Udhëtarë të Qiellit?
Në çastin e Apokaliptit të Dytë
Iliret tani vetevarosen!

Fushat e Parajsës,
Mbjellë me driza dhe ferrat!
Të tërë hyjnitë mblihdën si reze
Në syrin e kaut Apisi!

Tërë sekondat e Kohës
Dalin nga pulsi i duarve të mia.
Sa gomarë të evoluar
Nga raca hyjnore e kaktuesve!

A ka një rufe vemje
Në fshikezen e shtrëngatës?
Dhe a mundet në metamorfozë
Të jetë Flutura Univers?

Një grua indiane Shri Matakrishnjaja
I tha poetit të çmendur, -
Allain Ginsbergut, - të kishte
Poetin e vdekur, Blake, për Gurul!

Ah, Ginsberg, Ginsberg,
Më kot në bibliotekën e Muzeut Britanik
E kerkon një të dytë si Marks!
Për të studuar një Sistem të Ril!

Si të ec në kozmos,
Me këtë oqean si mbi një biçiklete?
Pse tek ky zogji
E kam ndryrë tërë vetedijen?

Kengëzojnë molekullat!
Degët qëndsen nga relet!

Ky cikël i propozuar nga autori na përcjell disi edhe gjendjen e tij të krijimtarisë, ku trishtimi dhe kërkimi në të padukshmen nuk është thjesht mision, por një zakonshmëri e njeriut intelektual me ndjeshmëri të thellë

HITHRAT E ZEZA TË JERUZALEMIT



Mbase si një Magna Mater
Unë lind kryeqendë nga sqetullat!

Ca erëra me shfaqet të avullta
Si arti zarathustrian i gatimit.
Vithet e kuajve shkëlqejnë
Si mobilje ari në një dhomë Perandori.

Propaganda na fut
Një Çernobil nën kafkë!
Po na epsheron hapësira
Si një seks koncentri!

Lëkundja e drurëve
Eshhtë shprehri estetike!
Ç'janë këto vegjime të shprishura
Si të një Ezekielit Ateist?

Në bebëza kam
Tipografinë e erërave!
Pse vjen drejt meje këmbëthyer poeti Ricos,
Mbështetur tek paterica e Hënës?

Ja, ky det i shtrëzon
Dhjetë defline jeshile të Luçiferit!
Ora antike pa akrepa në mur
Eshhtë si anija pa vela!

O, Faunë mëngjesore!
Dallgët shndrohen në luane kripe!
Si thahen keshu dhe kalben
Kopshlet e gjumit?

Këto dele dhe këto dhi
Mbase janë vetë zotat
Për barinjë, që s'dinë asgjë,
Ja, pse Krishti shfaqet si Qingi!

Sa herë vetë Hënë
E kam transkriptuar!
Se idetë e mia të epërme
Janë si enderra për krejt popuj!

Të vdekurit diku larg
Janë të interuarit hyjnorë.
Dhe befasi shoh vellezërit Grim
Në majën e një peme!

Nga porët e fytyrës
Më vërshojnë lumenj malli dhe drite.
Hapësire e therruar,
Si të të ribej sërish?

Fshehja dhe maskimi
Janë zeja e shkrimtarit
Dhe mbase fytyren e Macës Qeshire
Kam orën time të dorës!

Ndoshta i fus rrezet e kesaj dite
Në një shishe, për t'i ruajtur,
Për një doli përjelori
Mbas pesëmbjete vjetësh!

Tek honi i Kohës
Përplasem me përbindëshat
Ndërsa në TV shfaqen
Princërit e citateve të rreme!

Nëse këto mëllenja nuk psallin,
Pse duhen kishat?
Ç'na duhet një përjetësi e ngjuar
Mes akullinjash?
Gjethet të thatat!
Si të çveshura nga çdo energji
Dhe këmbët e mia i përcellojnë
Hithrat e zeza të Jeruzalemit!

Nëse Zoti, Zoti
Dhe nga sendet e bën një engjëll,
Unë i bëj të tërë engjëjt
Nga një trumbë trumcakësh!

Një qytet do ta gjejsh,
Dhe atje, ku asnjëherë s'do të jetët!
Trupat tanë bredhin, sfiliten,
Me këpucë mendimit!

Nëse librat janë fantazmë
Lexuesi për to është Hamleti
Historia përplasat tek muret
E opinioneve si Njeriu i Verbërt!

E Fshehta e qëndis të Dukshmen
Lumi i Drintit eshtë latuazhi im
Dhe rruga e braktisur në rërë
Eshhtë kerubin i shkruambosur në Hiroshimë.

Kaltërsi e trefshite
Formule alkimike e qiejve pagane
Dellinet s'dinë se ç'janë gardërbat
Dhe frakët me papjone!

Apostuj bronxi në një interior,
Plot afreska pornografike,
Me falloset me krahë si pegasët
Dhe vaginat e pyllëzuara si Arkadia!

Përjetësia pikëzohet
Tek kokrrat vezulluese të qershive.
Ujëra gjumash tek këmbët e mia prej princi
Do të vijë Nata e Neteve... por pa Përjetësi!

Gazrat e varreve dalin
Si nga prapnica e Djalit kokëposhhtë,
Dhe shiu vjen nga sipër qiejve

Si pelegrinazh alienësh!

Pse Pikasso i vdekur
Me flet nga një breg i trete?
Në azilet e braktisura
Strehohen blete të egra!

Ah, unë jam Kapiteni,
Që kurrë s'e gjeli Limanin e Endërrave,
Ngaterruar nga një komplot jvësh
Organizuar pabesisht nga një Hy i çakërdisur!

Tek gjerat e largëta
Sa afërsi që ka!
Kjo statujë e thyer ka humbur
Coperat prej endërre!

Si t'ju vjedh kuajve të Seifit
Ide marramendëse?
Ç'janë këto lopë të fjetura
Në purgatorë erërash?

Pse shpesh kujtimet
Janë mekate të rikthyera?
Pse kur ulem për të ngrënë
Shekujt me shërbejnë si kameriere?

Vjen ky melecior
Simbol i të Papriturës.
Stifksi sundon në klanin transgenetik
Plot sirena, kimeria dhe centaure.

Dhe shfaqet Arkitekti Shpirtëror
I universeve të sendëzuara!
Koha dhe kur rri mbi shkëlqetirë
E ka nën vete një oqean të padukshëm!

Nga brofin këto kometa,
Si truproje perandorake,
Në kurorëzimin tim,
Në Konstandinopojen e Pranverës?

Dhe erërat stërviten mbi dete
Në artet e lashta marciale.
Po ata, që s'besojnë tek pleqëria,
Do ta shohin Krishtin 133 vjeç!

Kush ndalet tek Porta e Heshhtës -
Vendlindja e humbur e fjalëve?
Tani heronjë e ljetësuar tradhitojë
Vete qyteterimin e shekujve!

O, botë e paraekzistencës!
Ironia, dimensionimi im i katërt!
Sa fosforeshente është kisha e prillit
Për meshat e mia heretike!

Keshjella e magjepsur,
Ku njerëzit janë shndruar në mace, gola,
Madje dhe si zjarr në oxhakun grotesk
Eshhtë Fjala, që e ngjiz Fantazia!

Kur qajnë dinozaurët ajrorë të stuhisë
Poeti i frikësuar u largohet metaforave.
Dhe gjembi i trëndafilit e helmton kopshtrin
Si dhëmbi i neperkës!

Munxa e tokës më mallkoi përjetë.
Be-be - bën engjëji i Naimit,
T'u mësojë abecene dhe Abetaren
Anallabeleve të rinj të Shqipërisë!

Ka kaq shumë duar,
Për ta shndruar këtë botë
Dhe ka kaq pak sy
Për ta soditur në heshhtë!

Budistët ljetësohen dhe çmendën
U besojnë Nirvanës së Makinave!
Statujave u kalbet trupi prej mermeri,
Dhe kombi pa identitet është hije nomade.

Odiseu në Had
Pa hijen e Herkulit,

Oë gjuante hije luanësh, -
Ja, shpikja me e madhe se Hollivudi.

Vjeshla, mburojë bronxi,
Ku eshtë vizatuar një kokë tigril!
Dhe kozmosi me të qeshurën
E një Guinpleni!

Ornamentika e zigzageve
Na mbështjell me rrembim,
Dhe zogjtë veç të qëndisur janë
Motive misterit prej Zodiaku!

Dhe shpesh i sfilltur qajn në gjumë,
(Oan shpirti im, jo trupil!)
Dhe vërtitet një hulim jeshil
I dehur në orgjilë e erës!

Do të bëj skandale të mëdha,
Duke ndezur fshëkzjarrë të pafund,
Mbi varrezat e terrta
Dhe Mbretërinë e Hadit!

Ajri është Bisha Blu,
Që më ndjek tek shpella më e thellë!
Po unë lekundem i dehur me raki
Si një Khajam i elektronikës!

Breshëri më rrefën në mjegull,
Për dele të epërme dhe të ngrirë,
Pra për Zotat arktikë, pa pamje,
Por brenda lotëve serafinet digjen!

Dhe pemët renkojnë
Si kryqtarë të plagosur,
Çajniku fërfëllin në kuzhinë
Si avullorja e parë në oqean!

Deti skulptor në Currila,
Bën performanca me relet!
Une krahët e prerë të lkarit
I palos si kapakët e librit më të ri.

Më mbulon rëra e dunave
Si hiri nga urna e Zotit, Zotil!
Dhe briltat përhapen
Si lëshit i shkullur nga Ariu i Jyve!

Dhe vijnë zebrat me pentagrame në trup
Si të kompozuar nga muzikanti Scriabin,
Për hir të kujt o Jehova
Kanë çetur këto qershi?

Në sa bregdetë pa njerëz
Kam lenë dorëshkrime apokrifë
Po dallgët m'i kanë redaktuar
Me sensin eliptik, të pazakontë!

Shtrihen rënjoja tempulli, -
Coperat të trupit të Budës,
Që s'është më,
Në një unilet forme!

Vetmi e pazë! Ja dy drurë,
Po ecin, po ecin, po ecin buzë pllajës.
Dhe shkëmbjeja pa linguistikë,
Lexojnë fytyrat tonat!

Mijra Erosë kapin fundin
E fustanit të mëndafshhtë të Vjeshhtës
Dhe tek zymbylet hënezon
Kuptimi i mistifikimit!

Ç'është fati leatorit i shesheve plot trafik?
Disa imazhe milësh mobilojnë vdekjen time,
Trandafilat vikalin sa mundin
Por shtrëngata hesht si kristall!

Melankolia lind ferrat
Me erën e athët të Çmendurisë!
Pse valle Njeriu i Padukshëm
Fëmijë të Dukshëm ka lindur?

Brenda alsbergut
Princërit e Luleve mbijetojnë!
Vec mbiemrat i krijuan
Estetikat e Kota!

Përherë gjej në tokë bronx
Të shkrire nga fonderia e Hënës
Dhe Mozarti e kerkon më kot një yllësi
Si partiturën, që e pati grisur!

Nga këto pyje ende të virgjër
Pse na mësyn Utopia?
Dhe Hëna është kaq e papeshtë,
Megjithatë e shfaqshme si Artit!

...
Dhe ritmi primitiv i orës
Eshhtë si i thundrakëve prehistorikë.
Orfeu e prekle lulen gentiana
Dhe dritë nga voltazhi elektrik!

Dhe muzgu bëhe kristal
Tek balli i pjerrët i kuajve.
Dhe poetet muroseshin
Brenda përfytyrimeve të tyre!

Dhe deflinët ënderrojnë
Të bëhen kafshë qjellore
Dhe drita bjen
Si shkaterimi i një keshjtjellet!

Dhe emocionet i përplas
Mbi zenitet e kopshleve
Dhe Ylli Polar thinjet
Si një patriark!

...
Çdo metaforë është trup i gjallë,
Por me gjak ireal!
Dhe djajle janë gardianë të Parajsës,
Dhe lulekuqet t'shehin falle të nëntokës!

Se Krishti s'e n'johu,
Asnjëherë martesën
Dhe mbeti veç Bir
Dhe jo At!

Tjegullat e shtëpisë së vjetër
Thyhen si amfora antike.
Dhe ngrihen të vdekurit me tëmthat plot myshk
Mbi delat luleçel!

Ka veç Kengë të Fillimit
Pa asnjë Epilog!
Dhe trandafilat e egër në brigje
Si kaloresit e Hajavathes janë!

...
Duart i ve tek Paskajshmeria
Veritetet Akili me pazmore të tremë,
Dhe purpuronjë frutat e pemëve
Si figurat e poetëve të lashtë kinezë!

Pse zëmrat e të dashuruarve
Janë anije të mbylura në kozmos?
Dhe serafinet vjeshtakë ënderrojnë
Reshje të amshuara deboret!

...
E mbush studion me violina antike
Si me ca mobilie mozaikane.
Këmbanat e katedraleve shndrohen
Në vile gjigande qershish!

Dhe deti, ah deti epikurian,
Pi dollite e lumenjve me eks!
Ekranet e TV-e zëvendësojnë
Sytë apokaliptikë të Tetramorfit!

...
Zjarri halucinant kërkon shndrimin e vet
Në një univers abstrakt!
Po dhe ca shtojzovallë të kreshlave
Kthehen në pasqyra në studiol!

Zolat fytyrëmbular,
S'duan të na shohin me!
Dhe ninullat! I lenë pas -
Gjinkalla të ngordhura!

...
Velë grifonit terheqin plujt,
Në fushat e Shkrimeve të Shenjta!
Një i vdekur mori formë zogu
Dhe më qëndroi mbi sup!

Vdekja purifikohet në zjarr,
Njeriu dhe Poezia përplasen si hark elektrik,
Në Pyllin e të varurve të Fransua Vjionit
Njëqind silueta të mia tund era!

...
E Përdhosura ka veshur rrobën e të Shenjtës,
Stilet vërtisin kaledoisokopet e tyre,
Aroma e Kryeengjellit përhapet si tërmet,
Dhe pikat e shiut janë fara lulekuqesh!

Kohë lebetish!
Ku i ke mëllenjat e pafajshme?
Unë jam Atleti i Çmendur,
Oë konkurrën në Vdekjen, në të njëjtin vrapim?

...
Këlo mjellma,
Pantonima të vjeshtave hënoret!
Dhe shekujt mbas njeri tjetrit ikin
Si mbretër në ekzili!

Pse lindim në ide,
Për të vdekur jashtë tyre?
Era i servis Vdekjes time
Dhurata zogjsh si thesarë të Solomoni!

Plazhi i Durrësit, 28 qershor 2005

A

ARGUMENT

NGA SHPËTIM ÇUÇKA

Vijon

Dashuria e poetit për mëmëdhënë është dashuria për gratë shqiptare, për ato gra që dikur "vdësin sikur s'kishin jetuar kurrë", sikurse është edhe neveria për "hamësit e pangopur të bukës së fëmijëve" dhe për poetët "që bëjten u zienin me mall në tiganin e zi poetik dhe zgjasnin duart t'ua jepnin t'i hanin!"

Dashuria e poetit për mëmëdhënë shpërthen me tërë fuqinë e zjarrit në vargjet:

Ku ka më bukur sesa të jesh zot në tokën tënde,

Të marrësh frymë me gjithë mushkëritë,

Të thuash: Janë të miat këto hapësira e vende!

Dhe kokën të ngresh nga jashtë ku pa ankth e pa frikë!

Ku ka më bukur se kur s'të ndrydhin as mendjen, as shpirtin

Gogolët gri të së ardhmes!

Ku ka më bukur se të rrihsh para maleve

I barabartë me malet, stoik dhe i ndjeshëm;

Njeri i dalë nga valët e detit të halleve,

Njeri i mençëm, i madh, i plot-pushtetshëm,

Njeri që hije të kanë lufta dhe puna dhe prehja

Dhe hapi që hedh dhe kënga dhe brenja dhe malli,

Njeri që hije të kanë dhe veshja dhe krehja

Dhe brazdat që merr fytyra e balli...

Njeri, të gjitha këto i kishe, por flinin

Nën mbretërinë e akujve të vdekur.

Njeri, duhej më parë akujt të shkrinin

Me zjarr, tërmet e hekur,

Pastaj trëndafili yt të shpërthente

Mbi kraterin e vullkanit të gjoksit që ziente!

Dhe pikërisht kjo dashuri për mëmëdhënë, kjo ndjenjë e thellë dhe e gjithanshme, e mburjtur në shekuj në gjirin e njerëzve të punës, në gjirin e popullit, kjo dashuri aspak naive dhe aspak foshnjare qëndron në fillësën e të tilla vargjeve:

Le të jetë kushdo e le të ketë dhjetra diploma me vlerë,

Po tok me diplomat nderin me vete ta marrë,

Që sytë pa u skuqur nga trarët e lashtë t'i ngrerë,

Që fjalën pa drojtje ta thotë: "Njatjeta, o trarë!"

Le të jenë ç'të duan!

Ka njerëz që njohin përmendsh gjeografinë dhe racat e gjindjes

Te poema "Nënë Shqipëri" D. Agolli ka parë, kuptuar dhe pohuar një të vërtetë të thjeshtë në dukje, të thjeshtë si një pjesë e madhe të vërtetash, dhe njëkohësisht të madhe, më të madhen të vërtetë në jetë: Kuptimi i jetës njerëzore është puna. Puna e paskllavëruar në një atdhe të paskllavëruar!

Dritëroi, kuptimi i jetës është vetëm puna

Dhe tekste hartojnë për një ishull të vogël sa pjata,

Po lumin që rrjedh i kaltër në strehët e lindjes

E lënë pa parë me vite të tëra e dekada.

Pastaj, kur ndodh që zbresin nga postet e gradat,

Kthehen ngadalë te strehëz e vogël mbi lumë:

"Gabuam, moj strehëz, gabuam, të ngratët".

E bien për lotur në gjunjë...

Cilat janë mësimet e mëdha të jetës së poetit, mësimet që ka nxjerrë ai, mësimet që ai, Dritëro Agolli, besoi se ishin të vlefshme edhe për bashkatdhetarët e tij, ndaj edhe i hodhi në vargjet e poemës "Nënë Shqipëri"?

Dhe unë mësoj; tërë jetën mësoj në hapësirat e tua,

Mësoj punën e luftën - dy mjesh-tëritë e mia të hershme;

Mësojnë me mua fëmijë e grua

Dhe derdhin djersën e ndershme.

Poeti, pra, ka mësuar punën dhe luftën, ka mësuar ta jetojë jetën me djersën e ndershme. Ç'tingëllim kanë këto mësimet të tij në kohën tonë? Sa janë të gatshme mendja dhe zemra e brezit të sotëm ta dëgjojnë këtë tingëllim, ta përvetësojnë këtë mësim?..

Mirëpo mësimet merren e përvetësohen atëherë, kur në shkollën e jetës ka rregull, kur në klasat e jetës jepen gjëra të provuara nga jeta dhe të peshuara me mendjen dhe zemrën e popullit punonjës dhe jo gjithfarë vjeturina- sh e xhinglash mashtruese. Mësimet e jetës merren e përvetësohen atëherë, kur ato kalojnë nga brezi në brez, kur jo vetëm brezi paraardhës jep atë që ka më të mirë, përvojën, por edhe brezi pasardhës rritet me vetëdijën se ai e ka për detyrë ta marrë dhe ta çojë më përpara këtë përvojë të vyer, ndryshe është i pazoti për luftën e jetës, pra, është i humbur.

Shkruan një mendimtar gjerman i shek. XIX:

"Një *genie* e quan veten të parvarur sapo qëndron mbi këmbët e veta dhe qëndron mbi këmbët e veta sapo i detyrohet vetes për *jetën* e vet. Një njeri, i cili jeton në sajë të një tjetri, e quan veten një *genie* të varur. Mirëpo unë jetoj tërësisht në sajë të një tjetri, kur jo vetëm i detyrohem atij për mbajtjen e jetës sime, por edhe kur pikërisht ai e ka *krijuar jetën* time, kur ai është *burimi* i jetës sime; dhe jeta ime ka detyrimisht një të tillë mbështetje jashtë vetes, kur ajo nuk është krijuar prej meje. Prandaj edhe është e vështirë të shkulet *ideja e krijimit* nga vetëdi-



ja e popullit. Të ekzistuarit e natyrës dhe të njeriut falë vetes është diçka e pakconceptueshme për të, pasi vjen ndesh me të gjitha *provat* e jetës praktike."

Dhe ja si tingëllon dashuria dhe përkushtimi i poetit, si përfaqësues i shqiptarëve të thjeshtë, ndaj mëmëdheut:

Nënë Shqipëri!
Kemi dashur të jesh e bukur,

moderne, e pasur;

U bëmë copë, na ranë në gurë e në baltë thonjtë,

U robëtuan në luftira e në punë me buzë të plasur,

Veç ty të të shihnim zonjë!

S'kërkuam në dorën e askujt krunde-tagji,

Në dorë veç pulat për krunde zgjatin ssepin,...

Oh, ç'kemi dashur!

Të kishe qytete gjigante e fshatra me dritë,

Të kishe uzina me oxhakë e kupola,

Të kishe fusha pa gjerdhe mbushur me dritë,

Të kishe njerëz të lirë

Me mendje të ndritur e shkolla!

Dashuria për mëmëdhenë poeti D. Agolli e shpreh edhe me vargje të tilla:

Nënë,

S'jam gëzuar veç me paqen e thjeshtë të maleve,

S'jam gëzuar veç me luftën që zboti të huajt e sollli lirinë;

Gëzohem për shembjen e botës së halleve,

Gëzohem për shembjen e shjtypjes së njeriut mbi njerinë.

.....
Këndoju e lajkës e smirës s'u kam as drojtje, as frikë,

Askush s'më shtyn të mburr këtë a atë,

Të gjitha janë të miat: shkollë, tokë, fabrikë,

Dhe unë këndoju, gëzohem e

mburr me gjithë zë.

Dhe dashuria e poetit për mëmëdhenë shprehet, në fund të fundit, në marrëdhënien e poetit me lexuesin. Ne do të duhej të ishim krenarë që në Shqipërinë tonë një poet ka shkruar të tilla vargje:

Vëllai im i dashur, i urtë e i rreptë,

Lexues i menduar me rrudha në ballë,

Që njihemi bashkë me vite në jetë,

Me ty e kam mbajtur poemën të gjallë,

Me ty i kam hapur dhe portat e reja

Në oborret e mi poetikë,

Me ty kam djersirë në punë e beteja,

Të dy kemi pasur një politikë...

Poema "Nënë Shqipëri" është poema e dashurisë për vendin amtari, e dashurisë për popullin punëtor, e dashurisë për lexuesin e mençur, për jetën dhe punën krijuese, për të mirën e përgjithshme, për begatinë me kuptim dhe jo për bollëkun absurd. Poema "Nënë Shqipëri" është poema e njerëzve që nuk detyrohen të largohen nga atdheu, që nuk detyrohen të ndërrojnë mënyrën e jetesës dhe vetë shpirtin.

Sikur njerëzit të mos i kishin përjetuar vetë këto gjëra, do të kishin të drejtën të thoshin: "Përralla!". Sikur njerëzit të ishin të ngarkuar me gjykime të cekëta dhe me paragjykime, do të kishin të drejtë të pohonin: "Përralla!".

Po! Nuk është e lehtë ta zbulosh të vërtetën. Nuk është e lehtë ta kuptosh të vërtetën. Nuk është e lehtë ta pranosh të vërtetën. Te poema "Nënë Shqipëri" D. Agolli ka parë, kuptuar dhe pohuar një të vërtetë të thjeshtë në dukje, të thjeshtë si një pjesë e madhe të vërtetash, dhe njëkohësisht të madhe, më të madhen të vërtetë në jetë: Kuptimi i jetës njerëzore është puna. Puna e paskllavëruar në një atdhe të paskllavëruar!

A do të pajtohen brezat e shqiptarëve me këtë të vërtetë të thjeshtë dhe njëkohësisht të madhe? A do ta bëjnë atë të tyre? Kjo është çështje e vetë atyre. Detyra e njeriut me mend e me zemër, detyra e poetit të vërtetë, është ta pohojë të vërtetën që ai ka kuptuar edhe atëherë e nëse ai vetë nuk e ka zbuluar këtë të vërtetë.

Dritëro Agolli të vërtetën e thjeshtë dhe të madhe na e ka dhënë. Na e ka dhënë me art, me ngrohtësi, me zemër.

Detyrën e tij ai e ka kryer. Ne kemi për detyrë ta nderojmë, nëse e kemi kuptuar thellë këtë zbulues poetike të bërë prej tij.

ESSE

NGA BEHRIM JUSUFI

Ç' janë këto fjalë që buçasin, ngado që njerëzit kuvendojnë e flasin, përse të qetë mes vete s'diskutojnë, por njëri-tjetrit zërin ia çojnë? Sot, kur themi se bota është qytetëruar, ku arti dhe kultura janë zhvilluar, kur këmba e njeriut planetët tjera ka shkelë e eksploruar, por planetin mëmë pas dore e paska lënë. Mbase mund të themi se kemi përparuar, por mos vallë përparuan gjërat që nga dora e njeriut u bënë, kurse njeriu mbeti i harruar. Kulturë, ku njerëzit shahen duke polemizuar, kur në foltore dalin e thonë fjalë më të ndyra, fare pa hezituar. Ka kohë që njeriu e paska lënë në harresë kulturën, artin, mirësjelljen e bujarin, prej se u bë rob i asaj që ai me dorën e vetë e bëri, i anashkaloi dhuntitë të cilat i ka në vete dhe jashtë tij. E harroi gjuhën me të cilën dallohet qenia e tij.

Gjuha është, sikurse veç e dimë, sistem (shenjash), kurse të folurit është realizim individual i atij sistemi. (Sipka, M., 2005:71). Në të folur të përditshëm, "ligjërimi" shënon thjesht aftësinë që kanë njerëzit për t'u marrë vesh midis tyre me anë shenjash tingullore. (Martinët, A., 2002:28). Meqë gjuha dhe të folurit si dhunti i janë dhënë njeriut, ai duhet ta dëshmojë këtë në jetën e tij si pjesë e komunitetit në të cilin jeton: për të menduar, logjikuar, komunikuar e vepruar

Komunikimi i padhunshëm na dërgon në transformim të mënyrës në të cilën shprehemi dhe i dëgjojmë të tjerët. Fjalët tona në vend të reagimeve të zakonshme automatike bëhen përgjigje të vetëdijshme të bazuara fuqishëm në vetëdijen rreth asaj çfarë vërejmë, ndjejmë dhe dëshirojmë.

Gjuha si kulturë e komunikimit të padhunshëm

"Të ndryshuarit e mënyrës se si bota funksionon tingëllon frikshëm, por komunikimi i pa dhunshëm na ndihmon të çlirohemi prej formave të vjetra të dhunës." (L. Francis).

Pa më thuaj një fjalë, që këndshëm tingëllon, që rrjedh qetë si uji, kur nga përroskat gurgullon, një fjalë që shpirtin ma qetëson, e nga veshi në zemër, këndshëm depërton.

me normat dhe parimet humane, me mirësjellje dhe etikë të lartë. Nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për diskursin e rëndom, atij politik, ligjërimin në fakultet dhe të ngjashëm, kudo që individit dëshiron të shpreh mendimin e tij, ai duhet përdorur regjistrin që i përkon me-sazhit çfarë ai synon të bart tek tjetri, duke treguar nivelin më të lartë të kulturës së të folurit.

Kultura e të folurit është manifestim i kulturës shpirtërore të njeriut. Ajo është shkallë e përsosmërisë vetjake të njeriut në të folur, zotërimin i aftësisë së shprehjes së drejtë, të saktë dhe të rrjedhshme të mendimeve dhe ndjenjave personale dhe komunikimit të suksesshëm me pjesëtarë tjerë të bashkësisë folëse. Përkufizimi i kësaj të kulturës së të folurit, është i njëjtë sikurse arsimimi, në kuptimin më të gjerë. (Sipka, M., 2005:88). Meqë



është manifestim shpirtëror, kultura e të folurit duhet të kultivohet, zhvillohet, gdhendet dhe ngulitet në shpirtin, zemrën dhe mendjen e individit si koncept, përmes të cilit ai

do ta zbukurojë të jashtmen dhe brendësinë, materialen dhe shpirtëroren e tij, etikën e sjelljes dhe të ndërveprimit me të tjerët nga njëra anë, kurse nga ana tjetër do ta zbut shpirtin e zemrën. Një gjë e tillë do ta shpie në begatimin e gjuhës së folur me fraza mirësjelljeje në komunikimin e tij me masën e gjerë.

Mirëpo, jo gjithmonë njeriu vepron me vetëdije, ose shpreh një mendim përmes të folurit duke qenë i vetëdijshëm. Shpeshherë ndodh që individit të mos jetë në gjendje t'i kontrollojë situatat gjatë procesit të ligjërimin, përkatësisht të të folurit, një gjë e tillë atë e shpie në sjellje dhe në të folurit të pavetëdijshëm.

Është i rëndësishëm fakti që në të pavetëdijshmen nuk është e përfshirë vetëm ajo që është e lindur. Pikërisht, njohja e pavetëdijshme nuk duhet të jetë e lindur dhe uni-

versale, duke pasur parasysh në rrjedhën e të pavetëdijshmit me vetëdijen, që nënkupton shtypjen e dijes së caktuar prej vetëdijes në pavetëdije. Sipas të kuptuarit të Edward Sapirit, modelet e sjelljes gjuhësore dhe kulturore, varen prej mënyrës së të kuptuarit që krijohen me traditën në një popullatë të caktuar, d.m.th., bashkësi socio-kulturore. Edhe pse nuk është fjala për trashëgimi biologjike, ato modele mbillen thellë dhe formohen në të pavetëdijshmen e kolektivit. (Periaz, A., 2014:166).

Komunikimi i pa dhunshëm na dërgon në transformim të mënyrës në të cilën shprehemi dhe i dëgjojmë të tjerët. Fjalët tona në vend të reagimeve të zakonshme automatike bëhen përgjigje të vetëdijshme të bazuara fuqishëm në vetëdijen rreth asaj çfarë vërejmë, ndjejmë dhe dëshirojmë. Na orienton në të shprehurit e singertë dhe të qartë, e në të njëjtën kohë përqendrim të vëmendjes tek tjetri me respekt dhe ndjeshmëri. (Rosenberg, M., 2006:25). E njerëzishmja është sërish në modë, por jo me naivitet dhe me lule në flokë, por sepse është dëshmuar që është më efikase! Ekzistimi i të drejtave të njeriut dhe luftimi për të janë të vjetra sa vetë njeriu. Një prej të drejtave të patjetërsueshme, të pakushtëzuara dhe të fituara me lindje të tij është të jetë i trajtuar si genie njerëzore me dinjitet. (Mandiae, T., 2003:10).

Bukuria e gjuhës qëndron në dashurinë ndaj saj, e dashuria ndaj saj shprehet përmes të folurit me, së së fundmi margaritari i gjuhës së folur është fjala e bukur dhe e këndshme, e shprehur me plot dashuri, mirëkuptim, respekt e ndjeshmëri.

→ Vizion nga faqja 17

rresht pas rreshti, shlatë mije ngjyra do të shkelqejnë nga mijera yllberë të ndryshëm. Mbi zhelet e popujve, mbi turmen e shpeëndarë u përhap nga jehona një «ahl... i zhdukur...» Dila, lashmë, ishte e tillë që përrallat e Andersenit iu zvarriten këmbeve si këlysha.

Tani nuk besohet që unë të kem shkuar në muzg të rrugicave të zyta duke rëmuar. Sot, në thoin e gishitit të vogël të një vajze të imcake, ka më shumë diell se më në gjithë globin tokësor.

Njeriu me sytë të mëdhenj përqaqon tokën. Rritet, ka prekur malet me kokë. Djali në kostumin e ri, - në lirinë e tij- është i rëndë, madje qesharak, prej krenarisë.

Si priftërinjë që për të kujtuar dramën e shpengimit, shkojnë përpara me naforen, çdo vend i vjen njeriut me dhuratat e tij:

«Merr!»

«Nga Amerika e paanë të çoj forcen forcen e makinave!»

«Unë, Italia,

LUFTA DHE UNIVERSI

netët e mia të Napolit të dhuroj. Dhe ti, e ridjeur, Lëviz erashkat e pëllëmbëve.

«Për ty, i ngjirë në flohtin e veriut, dielli i Afrikës!»

«Për ty, o i përvëluri nga dielli i Afrikës, për ty, me deborërat e vela, zbrit nga malet Tibet!».

«Franca, e para ndër të gjitha gratë, sjell të kuqin e buzeve».

«Dhe Greqia të rinjtë e saj, përsosjen e tupave të tyre lakuriq».

«Të kujt janë zërat e fuqishëm që më kumbos ndërthuren në një këngë? Rusia zemrën e saj ka çelur në një himn zjarr!»

«Njerëz, mendimin ju sjell Gjermania, skalitur nga shekuj!».

«E gjithëka gjer në thellësi zhytur në ar, Hindia dhuratat e saj ju sjell!».

«Lavdi njeriut, në shekuj të shekujve jetë dhe lavdi cilido që jeton mbi tokë lavdi, lavdi, lavdi,

lavdi!»

Do të mbyllesh! Por këtu jam ende unë Arrj i matur, gjigant, i ngalhet.

Oh, sa madhështor jam unë në më të ndrillshmin e shpirtitave të mi të panumërt!

Nuk do të kujdesem për atë që unë dhe as për atë që sot feston. I mallkuar, mios qëllor kaq! Ja, ajo është këtu.

«Mirëdila, dashurit!».

Çdo fije floku do ta dend me përkëdheli, kaçurrelin e artë. Oh, ç' erëra, të cilat jug të vendit, kryen mrekullinë e zemrës së varrosur? Lulezohje sytë e tu, dy livadhe! Bie brenda këtu femija i hareshem.

Dhe gjithëka përreth qesh. Flamuj. Njëqind ngjyra. Përpara. Iu dolën puplat. Turmë. Eci. Me vrap. Në çdo të ri pluhuri i Marinellit,

mençuria e Hugoit në çdo plak.

Kryeqyteti nuk ka buzë për të qeshur. Gjithëka, Jash të shtëpive në shesh, jash të! Si topa argjendi nga kryeqyteti në kryeqytet do të flakim argjellimin të terin, të qeshuren, zërin!

Nuk kuplohet nëse është ajri, një lule, një zog! Dhe këndon, dhe parfumon, dhe është me mijera ngjyra në një kohë: por për këtë ndizet flakadani i fytyrave, dhe nga vera shumë e ëmbël dehet arsyjeja. Por jo vetem njerëzit nga gëzimi kanë lulezuar në fytyre, kafshët kanë dredhur me elegancë flokët, dhe detet pasi janë lërbuar, duke gërbhur, u shtinë të këmbët tona.

Nuk do të besohet që lundronin, duke vjellur vdekjen: në stiva të harruara përgjithmonë nga pluhuri, tanket transportojnë në portet e qeta grumbuj rëshqitës gjërash të kota.

Kujti i kallon frikën bandat e topave? Po si, këta, kaq fisnike

do mund t'ju bënin copë e çike?

Ata, para shlepisë, mbi livadh, paqësisht kullosin bar.

Shikoni, nuk është një farsë, nuk është e qeshura e satirës: në kulm të mesditës, të qete, në çift, caret grindavecë shetisin të pergjaur nga dadot.

Tokë, nga vjen gjithë kjo dashuri? Përfytyro që alje nën një pemë kanë parë Krishtin të luajë damë me Kainin. Nuk e sheh, e dashur? hap paksa sytë, kërkon? Sytë e tu janë dy plasa. Hapi! Shiko, Sytë e mi: Janë portale të një katedraleje, të hapura së kaltrash. Njerëz! Të dashur, jo të dashur, të njohur, të panjohur, në procesion të gjere hyni nëpër atë portë. Dhe ai, njeriu, i lire, që unë e thërras, do të vijë, besomëni, besomëni!

*Përktheu: Faslli Haliti

Opinioni *i* Ditës

Nga dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... i Këshillit, Tusk, i Komisionit Juncker, i Parlamentit Evropian Tajani, Shefja e Politikës së Jashtme Mogherini dhe zyrtarë të tjerë të lartë të BE-së vlerësuan njëzëri hapat dhe arritjet tona të deritanishme në të gjitha fushat. I njëjti vlerësim u shpreh dhe në dy veprimtari të gjera publike në Bruksel që do të thënë se ishin vlerë e shtuar e kësaj vizite. Ndërkohë, ku më shumë e ku më pak, herë hapur e herë midis rreshtave u tërhoq vëmendja dhe ndaj mangësive dhe sfidave jo të pakta. Vetëkuptohet me qasje pozitive dhe inkurajuese, sepse qeveria "Rama 2" sapo ka marrë mandatin e ri.

Natyrisht, për arsye që janë shpjeguar dhe në shkëmbimin tonë të datës 12 nëntor «Prapë Hapa, pastaj Data», nuk pritej që Brukseli të jepte datë konkrete për çeljen e negociatave të anëtarësimit. Gjithsesi, këto takime dëshmuar se Shqipëria është shumë pranë këtij objekti historik. Madje, sipas procedurave të BE-së dhe në pritje të tre aktiviteteve madhore të saj që do të përmenden më poshtë, janë të gjitha gjasat që kjo datë të caktohet qysh në gjysmën e parë të vitit 2018.

Kjo vizitë tregoi përgjegjësinë politike dhe qytetare të kësaj mazhorance për të mbajtur një premtim të kahershëm duke përshpejtuar ritmin e procesit integruar të vendit tonë. E gjitha kjo në një periudhë kur në kontinent dhe në institucionet e BE-së, krahas dukurisë së lodhjes nga zgjerimi, po fryjnë edhe erëra antievropiane, krahas krizave tashmë të njohura.

Gjithashtu, BE-ja është e angazhuar në tratativa intensive me Britaninë e Madhe për realizimin sa më parë të BREXIT. Ndërkohë që Gjermania, Austria, dhe Holanda janë ende në procesin e mundimshëm të krijimit të qeverive funksionale.

Po ashtu, politika dhe diplomacia jonë po shfrytëzojnë më lëvizje proaktive disa veprimtari me rëndësi të BE-së për të ardhmen e rajonit dhe vendit tonë.

Kështu, në janar do të marrë Presidencën e radhës të BE-së Bullgaria, vend fqinj ka kaluar shumë prej problemeve dhe shqetësimeve të vendit tonë e me predispozicion pozitiv ndaj nesh.

Në shkurt 2018, BE-ja do të shpallë strategjinë e saj të re mbi zgjerimin e Ballkanit Perëndimor, dhe në muajin prill Komisioni Evropian do të bëjë vlerësimin e progresit të vendeve tona; ndërsa në mes të muajit maj, në Sofie do të zhvillohet Samiti i Posaçëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor. Në përfundim, samiti i radhës i BE-së në qershor pritet të «vulosë» vendimet e Forumit të lartpërmendur, duke përfshirë dhe çeljen e negociatave me vendin tonë, por gjithnjë në rast se do të plotësohen kushtet dhe kërkesat tashmë të njohura.

Ky moment madhor bëhet më urgjent dhe merr rëndësi të veçantë për vendin tonë, sepse në muajin qershor 2019 do të zhvillohen zgjedhjet e reja për në Parla-



mentin Evropian në të 27 vendet anëtare të BE-së. Por, procesi i rikonstituimit të tij dhe të institucioneve të BE-së do të përfundojë nga fundi i vitit 2019. Në këto kushte, mosçelja e këtyre negociatave brenda vitit 2018, do të shkaktojë shtyrjen e tyre për në vitin 2020 apo dhe më tej, çka do të ishte dështim historik i gjithë politikës sonë!

Mirëpo, caktimi i kësaj date nga Brukseli, pavarësisht nga vlerësimet pozitive të shprehura edhe gjatë vizitës së lartpërmendur, kërkon nga Tirana zyrtarë intensifikimin e ritmit të reformave, bashkë me rezultate të prekshme dhe të matshme në pesë prioritetet e njohura dhe veçanërisht në fushën e vetingut gjatë muajve të ardhshëm deri në maj 2018.

Është përmendur dhe më parë se në përgjithësi, pa përjashtuar ndonjë mangësi, diplomacia jonë e sidomos stafi i vogël, por profesionist i Misionit tonë pranë BE-së në Bruksel i ka kryer më së miri

detyrat e veta gjatë gjithë këtyre viteve të fundit. Të vjen vërtet mirë kur dëgjon në kancelaritë evropiane dhe ato belge në Bruksel fjalë dhe vlerësime aq pozitive për përkushtimin dhe kapacitetet profesionale të tij dhe të zonjës Suela Janina, ambasadores kompetente, energjike dhe të kudondodhur, sa në kancelaritë e BE-së aq dhe në veprimtaritë publike. Kush e njeh ose dhe ka punuar në diplomaci e di mirë se sa e vështirë është që të organizosh në Bruksel dhe në një muaj si dhjetori vizita me plot 10 takime e aktivitetet të kësaj natyre, me një cilësi, nivel dhe format të tillë të lakmuarshëm!

Por si dhe më parë, aq më tepër tani, gjithçka gjatë muajve të ardhshëm, kur do të jemi në një vëzhgim dhe më të madh nga BE-ja për ato çështje që janë bërë të ditura me shqetësimet përkatëse, përshpejtimi i këtij procesi historik është plotësisht në dorë të politikës sonë, në radhë të parë të

mazhorancës, por dhe opozitës, si dhe aktorëve/faktorëve të tjerë. Sepse le ta përsërisim, në BE nuk do të hyjë vetëm mazhoranca dhe diplomacia, por gjithë Shqipëria.

Për këtë qëllim, brenda vendit është jetik rinovimi i konsensusit të plotë politik të mazhorancës me të dy partitë e opozitës, PD dhe LSI. Këto të fundit do të tregonin shenja të emancipimit politik dhe vizion real që krahas oponencës së fuqishme, të ofronin dhe bashkëpunimin e tyre konstruktiv.

Por, dhe mazhoranca nga ana e saj ka vend për të dhënë më shumë hapësirë dhe terren për opozitën, nëpërmjet një qasjeje më dashamirëse dhe tolerante. Aq më tepër që krahas PD, me kusuret, por dhe meritat e veta, tashmë në opozitë është dhe LSI, ish-aleatja që ka kontribuar jo pak në këtë fushë.

Opozita mund të japë argumentet e saj lidhur me mungesat dhe mangësitë e rastit, por jo deri aty sa të kërkojë moshapjen e negociatave. Aq më tepër kur përvoja tregon se sa herë BE na ka hapur dritën jeshile në këtë proces, ka pasur hope cilësore dhe zhvillime pozitive. Veç kësaj, qëndrimet frenuese dhe kundërshtuese, lidhur me këtë aspekt madhor, jo vetëm nuk do të ndihmonin, por përkundrazi do të dëmtonin seriozisht reformimin dhe mbi të gjitha besueshmërinë politike të vetë opozitës.

U ndalëm pak gjatë në këtë pikë, sepse mungesa e dialogut të duhur politik gjatë muajve të ardhshëm mund të kompromen-

tojë procesin dhe të bëhet shkas për vonesa të tjera të pafalshme lidhur me çeljen e negociatave. Me siguri Presidenti i Republikës do të luajë rol në realizimin e këtij dialogu. Për më tepër si student i dhjetorit evropian, është ndër «pionierët» dhe tashmë protagonist i nivelit më të lartë të integritimit evropian të vendit tonë.

Lidhur me lobimin përkatës, politika dhe diplomacia jonë, me përvojën e ndjeshme që ka grumbulluar, krahas institucioneve të BE-së, bëjnë mirë që po kujdesen posaçërisht dhe për marrëdhëniet me secilin prej 27 vendeve anëtare të saj. Vërtet që deri tani, siç thuhet, pothuajse asnjë vend anëtar nuk ka shprehur rezerva ndaj nesh, por kjo nuk ka pse të na verë në gjumë. Sepse askush në Tiranë apo dhe në Bruksel nuk mund «të verë dorën në zjarr» lidhur me qëndrimet e tyre të ardhshme; për më tepër kur vendet anëtare do të shprehin zyrtarisht vetëm pasi Komisioni Evropian të dalë me vlerësime dhe propozime një datë konkrete, gjë që shpresohet të ndodhë në gjysmën e parë të vitit 2018.

Në këtë vështrim, krahas politikës së moderuar dhe konstruktive rajonale, bien në sy për mirë dhe disa demarsh të kohëve të fundit me disa vende anëtare të BE-së; veçojmë këtu takimin e nevojshëm të dobishëm të Kretës; me frymën e re pozitive që ka krijuar, vijimi i tij në Tiranë është me ndikim të dukshëm pozitiv në trajtimin e problematikës së njohur me atë vend e për rrjedhojë dhe të integritimit tonë evropian.

Po kështu dhe vizita zyrtare që Kryeministri Rama bëri fill pas takimeve të lartpërmendura në Poloni; vend me një peshë të konsiderueshme, edhe si pjesëtar i madh i Grupit të Visegradit.

Pjesë përbërëse e lobimit është dhe takti dhe etika gjatë argumentimit të domosdoshmërisë së çeljes së negociatave sidomos me vendet anëtare. Kjo kërkon që në komunikimet me partnerët të përqendrohemi tërësisht në punën dhe arritjet tona, në dinamikën e pesë përparësive të njohura, duke shmangur sidomos në publik referimet/krahasimet me vende të tjera të rajonit; ca më pak duke pretenduar se po na bëhet padrejtësi. Natyrisht ndonjë rezervë dhe mund ta shprehim, por me kujdes dhe në formatin e drejtëpërdrejtë dypalësh. Po ashtu, BE-ja, që e njeh shumë më mirë gjendjen e sigurisë rreth saj dhe lëvizjet e aktorëve të tjerë me peshë në rajon, nuk impresionohet e ca më pak të ndikohet nga këto referime si dhe nga përmendja e alternativave të tjera jashtë BE-së nga ana jonë.

Ja pse, sërish «topi është në fushën tonë»; sa më mirë e më shpejt të luajmë atë në Tiranë, me vazhdimin e hapave dhe veprimeve konkrete të deritanishme, aq më të lehtë do ta ketë Brukseli caktimin e datës së shumëpritur për çeljen e negociatave të anëtarësimit në BE.

Kjo vizitë tregoi përgjegjësinë politike dhe qytetare të kësaj mazhorance për të mbajtur një premtim të kahershëm duke përshpejtuar ritmin e procesit integruar të vendit tonë. E gjitha kjo në një periudhë kur në kontinent dhe në institucionet e BE-së, krahas dukurisë së lodhjes nga zgjerimi, po fryjnë edhe erëra antievropiane, krahas krizave tashmë të njohura.

Dje në "Deutsche Welle"

A do ta nxjerrë Moraviecki Poloninë nga izolimi?

Nga Paul Flückiger

... por në fund ajo nuk i rezistoi dot presionit. Ky presion që mbledhur për shumë javë, pasi Szydlo pati shpallur në fund të tetorit një reformë të gjerë të kabinetit qeveritar.

MORAVIECKI DO TA NXJERRË POLONINË NGA IZOLIMI

Pas spekulimeve të gjata, të entjën (07.12) në mbremje u mor vendimi: Szydlo do të zëvendësohet nga ministri i fuqishëm i Ekonomisë dhe zëvendëskryeministri Mateusz Moraviecki. Ky ndryshim është thuar një sensacion. Vërtet që për ish-bankierin ka kohë që thuhet se ka aftësi të mëdha drejtuese, ministria e tij u zgjerua gjithnjë e më shumë. Por Moraviecki, jo krejt i panjohur në qarqet ndërkombëtare, konsiderohet si mendimtar mjaft i pavarur, i cili mund të bëhet padyshim i rrezikshëm për burrin e fortë të Polonisë, shefin e partisë "E drejta dhe drejtësia" (PiS), Jaroslav Kaczynski. Kjo nuk mund të thuhet për Szydlon. Shpesh dukej se posti i kalonte aftësitë e saj intelektuale, gjë që dilte në pah sidomos në takimet e nivelit të lartë të BE. Por për të thuhet se ishte tepër besnike ndaj kryetarit të partisë. Kaczynski mundet që të shpresojë nga pasardhësi i saj një çarje të izolimit gjithnjë e më të madh ndërkombëtar të Polonisë. Sepse Moraviecki konsiderohet edhe si "fytyra miqësore e PiS" - gjë që nuk mund ta pohoje për Szydlon, që buzëqeshte rrallë dhe vepron

Dorëheqja e Kryeministres së Polonisë, Szydlo erdhi papritur. Tani, ai që do ta çojë përpara Poloninë do të jetë ministri i Ekonomisë, Moraviecki.



te po kaq ashpër: DEBAT PËR REFORMËN NË DREJTËSI

Megjithatë, thuhet se zgjedhësit e domin në një kohë kur një në pesë polakë nuk ka dëgjuar kurrë për Moravieckin. Por kjo tani do të ndryshojë. Që të martën e ardhshme do ta marrë postin ekspert i ekonomisë. Kurse kabinetin ai do ta reformojë pas

Vitet të Ri. Ndryshimi i papritur në kreun e qeverisë polake vjen në mes të reformës së drejtësisë, e cila ka ngjallur debate. Si ligji për reformën e Gjykatës më të Lartë, ashtu edhe ligji për gjykatësit e vendit parashikojnë një ndikim më të madh të partisë në pushtet si dhe të Ministrisë së Drejtësisë në ligjëvënienë në të gjitha nivelet. Sipas opozitës liberale dhe Komi-

sionit Evropian, ato eliminojnë në një masë të madhe pavarësinë e drejtësisë. Të dyja ligjet i bllokojnë verë me një veto, pas protestave më të mëdha të deritashme në rrugë, Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda. Që atëherë partia është e përçarë. Disa flasin edhe për një parti të presidentit, që mund të themelohet. Duda deri tani nuk deklarohet për këtë.

HOROSKOPI

DASHI

Çifti Merkur-Neptun në shenjën tuaj ju dhuron intuitë të jashtëzakonshme. I perceptoni dëshirat e njerëzve dhe u dilni përpara me entuziazëm. Në negociata dhe komunikim vazhdoni të keni mbarësi, kontakti me publikun stimulon ide të reja.

DEMI

Në kontakt me publikun jeni gjithmonë të preferuar, buzëqeshja juaj lehtëson barrën dhe shkrin pakënaqësitë e atyre që janë në pritje. Do të kaloni një mbremje shumë të bukur dhe argëtuese në shtëpinë e miqve tuaj.

BINJAKET

Pavarësisht se është ditë pushimi, Hëna ju flet për të punuar. Për fat të mirë, çifti Merkur-Neptun ju mbështet me një përzierje të mrekullueshme të arsyes dhe intuitës. Një bisedë e këndshme, ku ndjenjat shprehën hapur, ndihmon në marrëdhëniet në çift.

GAFORJA

Nuk do të jeni në jeni në humor të mirë nga ndikimi i Hënës. Çifti Merkur-Neptun do të jetë armiqësor, ndërsa perceptimet dhe fantazitë ju nxjerrin jashtë rrugës së qëllimit kryesor. Rreziku në dashuri është të synosh për shumë lartë, sidomos nëse jeni ende beqarë.

LUANI

Do të keni krijimtari të rafinuar. Arti, fotografia dhe muzika nuk janë thjesht hobi, por mund të kthehen mundësi profesioni. Çifti Merkur-Neptun ju mbështet. Do të keni shumë energji, pasion dhe besim në aftësitë tuaja krijuese.

VIrgjeresha

Udhëtime dhe lëvizje të shumta ju gjallërojnë ditën. Mund të jeni në tren, aeroplan ose thjesht në makinë, ndoshta për të shkuar të takoni miq të largët. Partneri është kokëfortë dhe tekanjox, tregoni diplomaci duke u treguar dakovrdësi dhe pastaj bëni si të keni dëshirë.

PESHORJA

Do të jetë një ditë e ndërlikuar, nën tërheqjen e Hënës. Edhe çiftin Merkur-Neptun e keni kundra, duke krijuar zënka në marrëdhënie. Bëni kujdes nga ata që duan t'u mbushin mendjen, duke ju premtuar qëllin dhe tokën, sepse nga pas ka një këllëkë.

AKREPI

Nëse kërkoni për persona idealë, nuk duhet të shikoni shumë larg, ndoshta e keni në krah ose jeni në rrugë për ta takuar. Jepini hapësirë argëtimit dhe lëvizjes së mbremjes së sotme, duke pranuar ftesë e miqve që ju kërkojnë.

SHIGJETARI

Ana e mirë e Merkurit dhe Neptunit garanton frymëzim krijues dhe udhëtime në intimitetin e shpirtit. Do t'ju vijë mesazhe romantike nga larg. Do të keni harmoni në vendin e punës. Nuk do të keni rivalitet me kolegët. Shpirti i skuadrës është në interes të grupit.

BRICJAPI

Do të jeni shumë të frymëzuar. Instinkti do t'ju japë udhëzimet e duhura për të arritur pa shumë përpjekje drejt suksesit. Do të përjetoni gjallërinë e miqësisë dhe dashurisë dhe puna do të ecë. Më në fund po filloni të fitoni.

UJORI

Do të mbizotërojë shpirti i skuadrës me kolegët, kur njëri nuk ia del, e ndihmon tjetri, pa zili dhe kritika, për të arritur objektivin. Investimet do të duhet të monitorohen, konsultohuni me një ekspert të kësaj fushe. Do të bëni blerje interesante në librarë.

PESHQIT

Do të përshkoheni nga ndjenja e të qenit zotërues dhe do të keni dëshirë të komandoni gjithçka. Do t'i pëshpëritni në vesh partnerit gjëra konfidenciale. Fliet më bukur për dashurinë në intimitetin e shtëpisë suaj.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.


MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- U shkrua nga Zweig.
- Fillojnë aksionin.
- Janë për t'u krenrtuar.
- Sejdini i tinarierëve.
- Ai i Don Kishotit ishte Sanço Pança.
- Ekstreme në tunel.
- I ka tek vrapi.
- Fillojnë andej.
- Nuk tregohet nga i pasigurti.
- Luftojnë me pagesë.
- Inicialet e Gere aktor.
- Sirena që i dha emrin Napolit.
- Gjysmë fejesë.
- E ka simbolin Co një i tillë.
- Inicialet e Kazan, regjisor.
- Tuner aktore.
- Në radhë të parë.
- As unë as ti.
- Janë galeri në rrugë.
- Gibson aktor.

VERTIKAL

- Eshhtë edhe ajo epizootike.
- Një është edhe Korabi.
- I këni në dorë.
- Eshhtë mbulesë mbi... hambar.
- Kufijtë e kujtesës.
- Janë tek në faqe.
- Kështu përfundon Loreley.
- Një vend nisjeje.
- Në këtë moment.
- Në krye të artistëve.
- Robbins aktor.
- Ai i Hekurt ishte Bismarck.
- Qërohen me... llogari.
- U shkrua nga Kundera.
- Eshhtë dhuna me fjalë.
- Yoko e John Lennon.
- Një vepër... taumaturgu.
- Ente Ekonomike Autonomie.
- Një mund të jetë cirku.
- Janë indigjenë neozelandezë.
- Eshhtë edhe ajo gjeografike.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishin formacionet e famshme maqedonase.
- Eshhtë e zakonshme për pushime
- Emil piktor.
- Një planet i Kuq.
- Një garë në hipodrom.
- Me të nxjerrin një litër.
- Qorre pa qe.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Eshhtë trofe sportiv.
- U hahen... të martuarve.
- Kufizojnë një truk.
- Kërcimi i Zorba Grekut.
- Mund të jenë kohore.
- Kardashian, aktore dhe modele.
- Janë përmasa.
- Eshhtë pjesë e gjuhës.
- Nafta e Shell.
- Një i dhjetë në vit.
- Letra pa zë.
- Janë qederet, dëmet.
- Ishin kundërshtarë të babilonasve.
- Eshhtë ilon papagalli.
- Tregon çmimin me... mirësjellje.
- Fillojnë ndeshjet.
- Të parat në stadium.

VERTIKAL


- Në krye të kryesisë.
- Eshhtë shfaqje e parë.
- Ross këngëtare.
- Kërkojnë talent të tilla.
- Të parat në stadium.
- Një pjesë e makinacioneve.
- Vrau Hektorin.
- Roth aktor
- Qe piktor i famshëm italian.
- Janë vjedhës.
- Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë
- Një çiklist në velodrom.
- Eshhtë e ardhur nga firmat piramidale.
- Pak diktaturë.
- Një mund të jetë me... ku-ku.
- Nota e diapazonit.
- Masin lëngje të tilla.
- Janë forma.
- I vidhet ustait.
- Eshhtë pjesë telefilmi.
- Pikas pa ekstreme.
- Eshhtë ëmbërsirë me qiri.
- Umberto poet italian.
- Dy asa.
- Kollet por jo kot.
- Radiotelevizioni i Kosovës.
- Inicialet e Delon.
- Fillojnë afërsisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4		8		5			3		2
	1	6					8	7	
	4		8		7			3	
		7				9			
	5		9		2			8	
	9	2				4	1		
5		1		8		7		3	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	4	5	8	7	3	2	1	9
2	3	9	6	5	1	4	8	7
8	7	1	4	2	9	3	6	5
9	2	7	5	1	8	6	3	4
3	5	6	9	4	2	1	7	8
1	8	4	3	6	7	5	9	2
4	1	3	7	9	5	8	2	6
7	6	8	2	3	4	9	5	1
5	9	2	1	8	6	7	4	3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

MJESHTRI MAGJIK, DA VINÇI

- Kam vënë re se njerëzit rrallë përipiqen të arrijnë diçka. Ata më tepër rehatohen dhe i lënë gjërat t'u ndodhin. Në fakt, ata i dolën përpara rastësisë dhe u ndodhën të gjërat.
- Arti nuk mbaron kurrë, vetëm braktiset.
- Lotët vijnë nga zemra dhe jo nga truri.
- Ku ka të bërtitura, nuk ka dije të vërtetë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	5	4	11		4		19	13	4	16			
12	H	1	5	6	3	10	9	3		11	4	13	6
E	13		7	11		4		19	4	7			2
16	S	11	1	5	4	14	15	6	5	3	4		
15	1	7	1	13	7	3	19	3		1	13	16	
4	14	1		17	4	14		9	4	7	3	1	
9	6			5	5	3	11	3			9	19	
4	5	5		3	1		4	12		3	5		
5	1	4	2		16	1	2	2	1	5	16		
1		18	1	5		4	9	4	14	1	7	3	
7	5	4	13	7	3		4	4	10	3	2		

E	K	S	P	E	R	I	M	E	N	T	F	
L	U	G	F	O	R	C	A	E	P	L		
I	T	R	A						S	I	A	
A	F	A	R	M	A	C	I	S	T	E	T	
F	A	C	S	I	M	I	L	E		R		
M	A	R	I	A	N	A	P	I	N	E	D	A
I	R	I	S	G	R	A	S	O	T			
K	A	S	T	A	P	O	E	T	O	R	T	A
D	E	E	P	E	T	O	R	T	A			
U	J	T	G	T	M	R	E	A	L			
F	A	T	U	J	E	S	E	D	R	A		
O	D	E	K	U	R	I	M	I	A	N		

- Gëlltite zemërimin, sepse, sa i përket përfundimit, nuk ka asgjë më të ëmbël dhe më të lezetshëm sesa ky vepër.
- Kur ti je i suksesshëm dashamirët e tu të vërtetë e dinë se kush je, por kur je i pasuksesshëm ti din cilët janë dashamirët e tu.
- Një njeri s'mund të ndihet realisht mirë, në rast se nuk aprovon vetveten.
- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbacov)

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

T A P E T T A R I A N E
 A R R A T E T O R R E S
 R T M A R S D E R E K
 T G J U R M I M E T V A
 N A R T E M I O D O M
 N O M T A T I M G Z I
 T I P A R E T A R T E L
 B E H I J E E L F E T L
 U R A T A T L E T E O
 K E L T A B J A A R A
 A T T E R A P I A S A M
 F R E N I A R M A N I

FJALËKRYQI (2)

B A L E T I F A S T O R E
 U R I A A T A D E R E K
 S T A M P E N H R I N I
 I E N A M A D E U S E P
 E R E R E T I N A P
 R I K A I R O R B E L A
 K A N D I N I R R A P
 E A M O S I M A S K A
 A N I K E T B M O R
 T O A S M O D U N O T
 O R L E A P S U L A R A
 N A N A N I V E A L U I S

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

